JETA E RE

2426



REXHEP QOSJA

EPIZODE LETRARE

REXHEP QOSJA

Episode letrare

BIBLIOTEKA E „JETËS SË RE"
Nr. 4/1967

Boton dhe shtyp / SGB „RILINDJA — PRISHTINË

REXHEP QOSJA

Epizode letrare

ESEJE

„JETA E RE" / PRISHTINË, 1967

NJI KUPTIM I TË BUKURËS DHE DASHUNISË

Çdo epokë ka pulset dhe idealet e veta. Dhe çdo epokë krijon mitet dhe fetishet e veta. Ndër mitet e romantizmit ishte femna dhe dashunija e lidhun për te. Tue iu përmbajtë konceptit të tyne të shkëputjes nga realiteti romantikët mistifikuen në shum raste gruen dhe ndjenjat e zgjueme nën ndikimin e prezencës o pamjes së saj. Porse, mjaft dendun portretet e dashunisë së tyne i përshkuen edhe me at fluidumin e imagjinatës së rebelueme. Paradokset ishin në gjakun e tyne.

Ndonëse me vonesë, edhe në letërsinë shqipe janë reflektue dukshëm, pothuej të gjitha karakteristikat dhe veçoritë e romantizmit, tue marrë pastaj edhe ngjyrën e kohës dhe t'atmosferës së vendit. E misteriozitetin dhe botën e zanavet, me çka shquhet veçmas romantizmi gjerman, sikur i përfill edhe Naim Frashëri në poemthin e tij erotik-estetik Bukurija. Për ta njohtë mirë poetin ma të madh të Rilindjes sonë, duhet ditë se koncepti i tij filosofik, e veçmas motivi universal i dashunisë, janë të mbrujtun me elementet e pikëpamjeve panteiste, me të cilat asht frymëzue gjatë kontaktit me letërsinë klasike greke dhe persiane. Por qëndrimi i tij ndaj dashunisë dhe të bukurës, në radhë të parë, asht rezultat i afinitetit të cilësuem që t'i veshë me velin e mistikës andërrimet dhe lektisjet e shpirtit të tij sensibil.

Bukurija asht personifikim i femnës; ajo asht shprehje dhe emanacion i saj. Në xixën e kontemplacioneve mistike të poetit ndaj hyjnisë dhe grues

shkrepi ideja për njazimin e saj me bukurinë. Grueja asht inkarnacion i bukurisë, e bukurija asht inkarnacion i grues. Distinkcion në këtë mes nuk ka. Ndërkaq, poemthi Bukurija asht rropatje racionale dhe emocionale për ta vu në gjendje statike karakterin tranzitor të nji ndjenje ma fisnike në jetën e njeriut, për ta pru atë në situatë që t'i rezistojë tehut të kohës dhe shpejtësisë së ndryshimit. Bukurija dhe femna për Naimin janë nji — ndoshta hyjni në kuptimin panteistik. Poemthi në fjalë sublimon të gjitha pikëpamjet, persitjet, lektisjet dhe emocionet e poetit-filosof, romantik, ekzotik dhe melankolik. Aty gjindet qenësija e tij shpirtnore, sepse poemthi përmban vibracionet e natyrës së tij humane. Me nji fjalë: aty e gjejmë të kompletuem mendimtarin, moralistin, estetin dhe poetin skofiar.

Nji pendë me zulmë botnore thot se sa ma i madh të jetë njeriu shpirtnisht, aq ma i naltë dhe njerëzor asht edhe kuptimi i tij për gruen në përgjithësi. Në këtë pikëpamje Naimi do të qëndronte n'Olimpin e humanistëvet, por larg perëndive për hirin e të cilëvet Grekët i therorizojshin bijat e tyne ma të bukura, për të shue etjen e atyne gjakpirësve, por tue plotësue edhe dëshirat e veta pushtuese.

Bukurija i asht kushtue femnës dhe bukurisë që rrjedh, gufon, fosforoscencon nga pamja dhe krijesa e saj. Së këndejmi askush s'mund të thotë premas se cila asht këtu epiqendra e persiatjeve të poetit: femna si krijesë me të cilën njeriu kompletohet dhe ngrihet në sferat e lumtunisë hyjnore, apo bukurija, që duket se Naimit nuk i bahej si kategori e vetëdijes, por ma parë e trajtonte si përmbajtje objektive, e cila shquhet vecmas tek grueja. Tue u nisë nga postulatet e tij etike dhe estetike, Naimi s'mund të merendohet në nji sistem të caktuem filosofik, porse kv moment s'mund të mirret si ndonji normë e valorizimit kualitativ të pikëpamjeve të tij. Tekembramja, njerëzit e mëdhej s'janë të lindun për kallupe filosofike. Asht e kuptueshme që, tue marrë parasysh elementin social, rrethanat e jetës, imperativin e kohës si dhe afinitetin personal, u njazuen në te ndikime nga burime të ndryshme: panteizmi persian, neoplatonizmi e plotinizmi, mandej ndikimi nga Dekarti, Spinoza, Ruso e Volteri. Së këndejmi, Naimi asht njikohësisht iluminist dhe romantik i letërsisë shqipe.

Simbas Naimit, bukurija nuk mvaret nga subjektiviteti i vrojtësit, meqë ajo pikaset tek guri e druni, lulet e yjt, bari e gjethi, toka e qielli. Ajo çfaqet pamvarësisht prej tij tek dukunitë dhe objektet e ndryshme natyrore, porse në formë të veçantë nëpërmjet të grues, e cila ka veti hyjnije. Kësisoji, nëpërmjet të ndërrimit të formës, do të thotë metamorfozës, si do të shprehej Gëte, arrihej identifikimi i gjasendevet. Për Naimin bukurija përëndija — grueja janë nji dhe meqenëse plotësohen reciprokisht, kjo nënkupton se nëpërmjet të femnës, bie fjala, vijnë në shprehje edhe bukurija e hyjnija. Kështu, pra, erdhëm tek koncepti naimian se grueja në njifarë mënyre asht personifikim i bukurisë dhe hyjnisë. Kjo krijesë qenka e divinizueme tanësisht nga romantiku. Tue u nisë nga kjo doktrinë e tij nuk asht për t'u çuditë pse ai s'ia del të japë fare portretin e të dashtunës së vet, respektivisht nuk cakton elementet portretiste të saj. Ajo nuk mund të përfytyrohet, nuk dihet ç'pamje ka, cilat janë tiparet e fytyrës së saj, cila asht ngjyra e zanit të saj, çfarë kualitetesh morale e shoqnore ka. Nuk mund të deshifrohet natyra e kësaj krijese, e as të caktohen vijat e përgjithshme të reliefit të saj. Aq ma pak jep mundësi të depërtojmë në psiqikën e saj, apo të kuptojmë shkaqet përse e refuzoi dashuninë e tij. Ajo asht mjegull, fluid, krijesë astrale dhe eterike. Megjithë përpjekjet e imagjinatës njeriu nuk mund ta zbresë para vetes at fantazmë të çuditshme, e cila asht në gjendje të nxisë dashuninë e poetit të pafajshëm, e të reshtet pastaj si farë zane hije-hije para baticës së ndjenjave dhe rënkimeve të tij të heshtuna. Sidoqoftë, pranija e saj në fantazi nuk asht prani e krijesës prej mishi e gjaku, por e përfytyrimit që fanitet në formë femne bukurije të pashoqe. Imagjinata si faktori dominant në krijimtarinë e romantikëve dhe mistifikimi i dukunive të zakonshme janë ndër veçoritë e poemthit Bukurija. Ato sikur bahen shkak i vetëvetes. Edhe kur duket se tipizon, edhe kur duket se na i sjell vijat e natyrën e të dashtunës së tij, poeti në të vërtetë ban përgjithësime të pakrahasueshme dhe pareshtun asht ezoterik.

Bukurija, respektivisht grueja të cilën e dashunon ai përmbledh shkëlqimin farfuritës të diellit, dritën e ditës, madje jo mbrenda nji kohe të shkurtë, por gjatë tanë jetës, sepse e tillë i bahet kur ia sodit: „Gush' e krahruar,/ Faqez' e ballë./ Dhe pulp' e llërë,/ Sy e

qepallë,/ Dhe kamb' e duar!" Në fund të nji akcentimi të tillë të bukurisë së saj, ai don, me anën e kontrasteve dhe antitezave, të na uli nga qielli i ekzaltimit të tij dhe të na vejë në nji bazë si ma reale. Kur pohon ngulmueshëm se joshet nga bukurija magjike e fytyrës së saj, kur thot se në pamjen e saj zbuloi bukurinë në të vërtetë, tue e përqasë këtë përjetim të vetin me ate që përjeton katarzë në maje të malit, kur në çastin e faljes ma intensive i bahet se gjeti perëndinë, — kjo nuk na premton se përqasja mund të kuptohet nga e para, jo; perëndija i tij asht imanencë, ndërsa bukurija emanacion i hyjnisë dhe grues posaçërisht; kjo do të thotë se me të zbuluem të bukurisë në fytyrën e saj ai përjeton njifarë ekstaze shpirtnore, „Si ajy që gjeti në malt Perëndinë", pra nji katarzë shëmbëllyese. N'anën tjetër, kur pohon se përpara lules së majit vetëm mund t'i vijë ndohtje, kjo do të thotë se lulja qëndron në tokë, ku i ka rranjët, prandej në nji dorë asht e shëmtuet në krahasim me bukurinë fluide të grues s'imagjinueme. Në këtë mes ai nis e shtron elementet e të dashtunës së tij, por, megjithate, asaj s'mund t'i zihen vijat as me imagjinatën ma të bujshme të lexuesit. Sepse, ato janë elemente të nji krijese impersonale, fare të pamaterializueme. Pareshtun na bahet se kemi përpara hijen e nji grueje të pacaktueme. Në të vërtetë, e tanë vjersha e tretë e poemthit përbahet nga kontrastet që synojnë shtimin e efektit emocional dhe njikohësisht artistik — syni i saj i shkruem ngjall asociacione në lidhje me hanën dhe yjt, anipse edhe këta trupa qiellorë, që metaforizojnë shkëlqimin dhe bukurinë, i duken „si të shëmëtuar" në përqasje me bukurinë e saj.

Naimi asht romantik dhe vuen nga të gjitha sëmundjet e romantikëve, porse vuen edhe nga sëmundjet e tij intime shpirtnore dhe fizike, së këndejmi edhe dashunija e tij jehon me tinguj tragjikë për Unin e tij. Meqenëse i dëshpruemi kënaqet me pakëz (kur shuhet optimizmi shuhen edhe dëshirat), edhe ai do të ndihej i lumtun dhe do të vdiste plot hare e gaz, sikur t'ishte i siguртë se mbas vdekjes ajo do të thonte: „Vdiq për mua pastë ndjesë!" I pushtuem ditë e natë nga pamja, nga bukurija që fluoroscencon nga krijesa e saj, atij edhe bimët e ndryshme ia kujtojnë pjesët e ndryshme të trupit të saj. Kur i sheh pjeshkët, atij i mejtohet gjiri i saj, së këndejmi edhe ky asociacion ia kujton përjetë objektin e vërtetë, sepse asht prore i

lidhun në kujtesë me qenien e lektisjes së tij të pashoqe. N'anën tjetër, kur e sheh jaseminin, i cili shquhet me lule të bardha si bora dhe kundërmon erë shum të kandshme, ai nuk nguron që ta personifikojë dhe t'i drejtohet si ndonji krijese të vetëdijshme: „Pse më djek zëmrën, i thashë, E më ngjanë me atë dorë?"

Edhepse me anën e ketyne përqasjeve të mrekullueshme, poeti shkoqet nga përgjithësimi karakteristik i kësaj poezije, as me këto rropatje të konkretizimit ne nuk nxjerrim përfytyrimin e caktuem të dashunisë së tij, veç e imagjinojmë edhe tutje at fluid ezoterik e të paprekshëm. Asociacionet e tilla, që i ngjallin ndjenja të flakta në shpirt e që bahen emnesë në jetën e tij, asht e natyrshme të përcillen me shpërthimin e dufit të mbrendshëm. As Naimi me at aftësinë e pashoqe të zotnimit të vetëvetes, me ato cilësitë e tij të stoikut, me butësinë që karakterizon budistët, në këtë rast nuk mund t'i rezistojë imperativit të zemrës. Prandej s'gjen tjetër objekt me të cilin do të përqasej përpos me qiriun, me këtë simbol të pavdekshëm të klasikëvet persianë. Thot se qiriu, të cilin poashtu e personifikon sikundër parandej jaseminin, prej tij ka mësue që të shkrihet përvëlueshëm, që të tretet ngadalë, anipse me nxehtësi vullkanike, veçse tue u shkri ndien kënaqsi të veçantë shi nga tretja e vetëvetes, meqë në ndërkohë lëshon zjarr e flakë, dritë e shkëlqim.

Qiriri meje ka mësuar
Të digjet, të përvëlohet
Edhe duke përvëluar,
Të qeshnjë e të gëzohet,
Të bënetë zjar e flakë,
Të tretet pak' e nga pakë.

Si lirizmi i theksuem i vargjeve, ashtu edhe asociacionet që ngjallin ato janë ma tepër se të çuditshme në e parë. Tue u djegë qiriu „të qeshnjë e të gëzohet"! ? Çudi e madhe, apo jo! ? Edhepse qiriu asht poeti, prapseprap duket vështirë nga vuejtjet e dashunisë të shkrihet në gaz. Ja ku janë ato paradokset e çuditshme të romantikëvet. Por poezija ç'nuk ban. Sa na ngrit në qiell, po aq vetimthi na zbret në tokë. Këtu asht bukurija dhe madhështija e vargjeve — margaritarë të Naimit në këtë poezi. E këtu asht edhe bukurija e tanë poezisë. Të pamundshmen të na e bajë të mund-

shme. Jo rrugës s'aksiomave filosofike, por rrugës së krijimit t'atmosferës së flakërueme, që ta imponon të vërtetën e vet. Në poezinë e Naimit zjarri dhe flaka për te janë në të vërtetë zjarri dhe drita plotiniane nga të cilat ndriçojnë krijesat materiale — ato janë atribute të hyjnisë.

Bukurija që në kuptimin e Naimit identifikohet me femnën asht ajo që cyt lulet, në rastin konkret drandofillen, që të çelin, të zbukurohen, të stolisen me dekorin që ua ka dhurue natyra, të qeshin e të gëzohen, sepse ashtu ma lehtë ia përvëlojnë zemrën edhe ashtu të zharitun poetit skofiar. Por drandofillja vetë mund t'identifikohet me gruen, me objektin e dashunisë së tij, ndërsa ai tash asht me të po n'at relacion, në çfarë janë edhe bylbyli e drandofillja. Në këtë kontekst drandofillja nuk i flet bylbylit, porse tue e shikue se si përpëlitet nga vuejtjet e zjarrit të mbrendshëm, ndien kënaqsi të madhe dhe vjen tue u zbukurue përherë e ma tepër. Me kohë intensiteti i vuejtjeve të tij vjen tue u shtue, kështuqë dikur nis e çon edhe natën pa gjumë. Edhe nëse gjindet dot njeri t'i thotë se e dashtuna e tij ka zemër si guri, ai njiherëpërnjiherë s'do t'i besojë, por kur tevona kupton se kjo qenka e vërtetë e idhët, ai e konstaton këte pa pësue kurrfarë ndryshimi sa i përket përkushtimit emocional. Tue e krahasue pamjen e të dashtunës me hurmën, e zemrën e saj me bërthamën, ai njikohësisht jep me fuqi të jashtëzakonshme situatën në të cilën gjindet vetë. Dhe, a mund të shprehet ma bukur pozita e nji personi që gjindet ndërmjet dy zjarresh: lektisjes së hatashme të nxitun nga fuqija magjike e bukurisë, nga nji anë, dhe indiferencës së pakuptueshme t'objektit të dashunisë, nga ana tjetër.

Femna së cilës i këndon Naimi asht ma tepër perëndeshë se sa grue dhe në këtë drejtim ka diçka të përbashkët me Beatriçën. Nuk i shëmbëllen idealit romantik të femnës aq sa atij të Mesjetës. Mund të çuditemi se ç'dashunon poeti në të. Ndoshta asht i robnuem nga ideja që ia ngulit vetes në kokë, e ndoshta dëshiron që tue ia kushtue mendimet dhe ndjenjat nji krijese eterike të largohet nga vetja dhe realiteti — larg. Nji kuptim kësisoji i Naimit mbi gruen dhe bukurinë përkon me jetën, shpirtin dhe formimin e tij. Racionalisti dhe moralisti Naim nuk e sheh t'udhës të shfryjë me tinguj sensualizëm plot, kurse Naimit shëndetlig, të tërhequn në qetësinë e

jetës shtëpiake dhe të mbyllun n'Unin e vet ma mirë i përgjigjet hieja se sa krijesa e gjallë. Megjithate, ai diçka dashunon, sepse ndjenjat e tij të çiltërta dhe humane i grish bukurija e cila reflektohet nga objekti i imagjinatës së tij. Së këndejmi ajo, të cilën e adhuron, për te asht ma reale se sa të gjitha krijesat e tjera të kësaj bote, prandej edhe i përcjell me vigjilencën ma të madhe t'imagjinatës s'errësueme lëvizjet e saj, kurse vijat e trupit dhe të fytyrës ia sublimon me ndonji metaforë të fuqishme. Femna për të cilën flet Naimi s'ka origjinë as moshë të caktueme, s'ka lindë as nuk do të vdesë — ajo asht fanitje e imagjinatës së stuhishme. Ajo asht si feniksi që vdes dhe krijohet nga hini i vetëvetes. Poeti ka zgjedhë materien poetike që ta krijojë ashtu sikundër i përgjigjet natyrës dhe konceptit të tij filosofik, porse piktori do të ngelte duerkryq përpara saj ose, tekembramja, do të bante hijen e idealit të vet. Grueja që e imagjinon ai nuk mund të përfytyrohet në kohë as hapsinë, ajo s'ka kurrfarë dimenzionesh konkrete, ajo asht ide abstrakte. Të gjitha epitetet që ia vesh, virtytet dhe tiparet e saj s'përkojnë me sensibilitetin e kohës e as me temperamentin e mentalitetin e njerëzve të trevës shqiptare. Së këndejmi, bukurija e Naimit asht bukuri filosofike, grueja e imagjinatës së tij asht grue e imagjinatës ekzotike. Ideali estetik i Naim Frashërit asht ideal i krijuem nga kontaktet me literaturën persiane.[1]) Çajupi, bie fjala, i cili ishte në kontakt me rrymat moderne të të menduemit europian, e që kishte ruejtë at frymën e shëndoshë të filosofisë popullore, ka pikëpamje krejtësisht të tjera për dashuninë dhe bukurinë. Mara e tij asht e buhishme, lozonjare, senzuale. Ajo di të bahet mitare, por edhe e merdostë, çfarë e shohim kohëmbaskohe edhe vetë poetin. Grueja e imagjinatës së Naimit s'ka asnji tipar o vijë të grues jose vashës shqiptare. Nëqoftëse ndokush do ta ndehte sadopak imagjinatën e vet për ta sendërtue përpara

1) Megjithë pohimet se disa nga simbolet karakteristike të Naimit siç janë drandofillja, qiriu e bylbyli, janë të poezisë popullore shqipe, në këtë pikëpamje duhet pranue të vërtetën që s'përkon me të tilla mendime. Poeti s'humb nga madhështija e ve edhe n'thaçim: janë të Persianëve. Ja ç'thot Gete që aq shum i çmoi dhe deshti klasikët e Letërsisë persiane, saqë nën influencën aksiomatike të tyne shkroi edhe nji përmbledhje të tanë poezishë :„ . . . të gjithë poetët persianë janë të palodhshëm në përshkrimin e llambës dhe qiriut të ndezun. S'andejmi vjen edhe monotonija që ua zanë për të madhe: por nëse shikojmë mirë, pikasim se gjasendet e natyrës te ta bahen surogate të mitologjisë, drandofillja dhe bylbyli u zanë vendin Apolonit dhe Dafnës. . ."

bile nji hije dosido të qartë të pamjes së saj, do të shihte fundifundit se asht nga ato bukuroshet apokaliptike që fluturojnë reve dhe qiellit të përrallave dhe poezisë orientale. Nga shtati i saj si florini (Shqiptarët e krahasojnë femnën me selvinë, drenushen, apo ndonji gjasend o krijesë tjetër nga jeta e tyne baritore, e jo me florinin që s'e kishin), nga prehni i saj, reflektohet nji bukuri që të merr me vete dhe „gjithë jetën e zbukuron". Kjo „gjithë jetën" nuk do të thotë jetën e matun me ditë, muej e vjetë, porse amshimin dhe tërësej rruzullin toksor. Ajo asht femën që ecën me nji graciozitet të rrallë dhe n'ecje e sipër vetëm ia hudh ndonji shikim poetit të gjorë, me të cilin e zharit njiherë e përgjithmonë zemrën e tij, që lektiset pas saj. Për të dalë sa ma eterike kjo krijesë e andërrimeve poetike të Naimit, ai i vesh edhe epitete, që n'esencën e vet prap janë afër kuptimit të ndonji materie fluide. Kësisoji, ajo ka „leshrat si tërtërë", kurse „qepallën si gjilpërë". Në këto mënyrë edhe forma e përmbajtja janë shkri në nji kuptim, respektivisht përmbajtja ka diktue formën.

Tamam nga gjysma e poemthit, kur veç asht fitue përfytyrimi mbi atmosferën e përgjithëshme që mbretnon ndërmjet poetit dhe të dashtunës së tij, zen e shtohet tensioni poetik i tij dhe nisin të ndryshojnë formën edhe marrëdhaniet midis tyne. Ai që deritani vetëm e përshkruente dhe stoliste, tue i veshë epitetet ma të bukura dashunisë së tij, ndonëse tue shtrue edhe ndonji element të rrallë. nga i cili mund të kuptohet se ajo s'ishte aq e goditun nga çfilitjet e tij shpirtnore, këtu e tutje ban nji f o r t i s s i m o në paraqitjen e situatës ndërmjet tyne.

Zëmra jote në krahror tënt
Është hekur brënda n'ergjent

i thot ai asaj dhe kështu i ban gati vetes terenin për t'drejtue me lutje e përgjërime që ta shikojë. ta përfillë, të ketë ndjesë ndaj tii. Kësaj vazhde edhe parabola e intensitetit të përshkrimit romantik. që prej fillimit zu të ngrihet ngadalë nga hapsitë e paskajshme të gjithësisë, ku gjinden të njazuem ideali dhe bukuria. tani nis e bie teposhtë. porse hëpërhë me pierrtësi fare të butë. Nga prezenti, në të cilin me anë antitezash dha atmosferën e saj spirituale. del tani në futur për të shprehë me nji ritëm e muzikalitet

të rrallë atmosferën personale shpirtnore dhe për të tregue gatshmëninë që të sakrifikohet, që të tretet e venitet, ngadalë, por tragjikisht, njashtu siç ban „kandili kur s'ka vaj", vetëm e vetëm që të fitojë nji fije simpatije prej saj. Përqasja që i ban vetes me kandilin, i cili vjen tue u shterrë meqi i mungon vaji, ndonëse shprehje konvencionale, e trashëgueme nga mësuesit e tij shpirtnorë, mund të thuhet lirisht se nuk e dobëson fuqinë artistike të vjershës së dhetë, që përkah intonacioni, ritmi, muzika asht bukuri e vërtetë, por përkundrazi lidhet mrekullueshëm me kuptimin e vargut final: „Haj, e zeza jetë, haj!" që asht shkalla e parë e gradacionit pesimist të tanësisë. Në këtë mes Naimi koncentrohet dhe ia del të gjejë si figurat me të cilat shtron gjendjen e vet emocionale, ashtu edhe ritmin e shpejtë të tetërrokshit të thyem e të shqetsuem, nëpërmjet të të cilit derdh disonancat e shpirtit të brengosun. Pikërisht vargjet e alternueme nga të cilët i pari ndahet në dy vargje katërrrokëshe, që shtojnë shpejtësinë e ritmit dhe nervozitetin e tij, sikur sugjerojnë lektisjen e poetit për bashkimin me te, në nji anë dhe vejnë në spikamë se sa e shkurtë dhe e padiktueshme asht gjatësija e jetës, n'anën tjetër. Në kontekstin e kësaj bie në sy se si dy vjershat e fundit, në të cilat poashtu shprehet lëvizja, ecja e shpejtë, kalimi, gati rendja e kohës, kanë poashtu ritmin e gulshuem të shpejtësisë dhe i rezistojnë çdo kuptimi statik.

Fluturimi i romantikut në sferat e imagjinatës mjegullore dhe sensibiliteti i tij i hollë, i shkaktuem nga nji vizion ireal poetik, tani nis e marrin kontura si ma të caktueme materiale, jo pse mund të thuhet që ai e gjallëson portretin e grues, por pse rropatet t'u këthehet burimeve ma reale poetike. Nder pak huazimet e poetit nga poezija popullore, edhe në Bukurinë janë disa figura të trashëgimit të popullit. Vizionin e dashunisë së tij poetike e metaforizon me „sorkadhenë qafëgjatë" dhe e quen „bukuroshe! symyshqerrë!" tue e konkretizue kështu për nji nyancë ma tepër pamjen e saj engjëllore, ndonëse temperamenti i tij i qetë dhe inklinacioni nga botëkuptimet panteiste s'i lejojnë t'i qaset edhe ma idealit dhe thesarit burimor. Së këndejmi edhe këtu përdor të njajtat mjete me të cilat shkroi tanë poezinë e vet. Këtu vetëm përkohësisht kthehet në votrën e lindjes së tij, për t'u braktisë rishtazi në largësitë e paskaj-

shme, atje ku i këndojnë qiriut, bylbylit dhe drandofilles, atje ku janë mendimet dhe persiatjet e tij, por jo edhe zemra. Prandej konkretizimin dhe demistifikimin momental i zavendëson rishtazi ajo kërkesë e romantizmit simbas së cilës „poezija ban që gjanat e rëndomta të mos duken të rëndomta" (Sheli).

Tutje ai e përgjëron të dashtunën që të mos i derdhë ato flokët e bukura dhe të bujshme n'erë, që të mos e shgjetojë përsëri me ata sytë e saj prej pëllumbeshe, që të mos ecën aq bukur sikundër di vetëm ajo, sepse nga të gjitha këto, nga pamja dhe lëvizjet e trupit të saj derdhet nji zjarr vullkanik në shpirtin e tij dhe ia copton zemrën. Kështu edhe muzikaliteti i paralajmuem i vargut në vjershën e dhetë, në të vërtetë efekti vertikal i saj, këtu tani vjen tue u shue, tue iu adaptue përbetimeve të prridhuna, respektivisht tue u shtri me efekt horizontal. Edhe parabola emocionale e poetit merr tatëpjetën, kurse hovin vetëm pakëz ia ndal edhe nji orvatje e njohtjes së botës me anën e poezisë, ku në të vërtetë koncentrohet vuejtja e tij dhe pret që të lëshohet me ngjyra sentimentale në vjershën pasonjëse. Hera e fundit kur atij i përhihet grueja, të cilën e adhuron, asht nji reminiscencë që puqet me materialin poetik në fillim të Bukurisë, vetëmse këtu qëndrimi i saj ndaj tij vihet në plan të parë dhe tregon se ajo, ndonëse nuk e përfill lumëmadhin, prapseprap s'e mohon plotësisht simpatinë e tij, e cila për subjektin asht nji zjarr përvëlues. Shikimi të cilin ia drejton ajo e ban të mendojë se në te janë koncentrue dritë e diell dhe me pandehjen se këqyrja do të thotë nji rreze dashunije, çel mundësinë e persiatjeve rreth rinisë së perëndueme. Kështu indi i dashunisë përshkohet ngadalë-ngadalë nëpër të gjitha vjershat e poemthit, tue krijue, nën pluhnizëm e mistikës, skeletin e motivit të tij. E kështu edhe mbresa e fragmentaritetit zbutet dhe, n'u marrtë parasysh karakteri mistifikues i panteizmit naimian, me të cilin ai brumos të gjitha sajimet e veta refleksive, mund të thuhet se tanësija e Bukurisë asht ma pak e cënueme se ç'pandehnin kritikët e saj.

Çasti i takimit të shikimeve n'imagjinatën e poetit krijon iluzionin e nji dashunije të përjetëshme, të pafikun kurrë, jo pse mund të jetë ashtu, por pse ai dëshiron dhe don të jetë ashtu.

„Pse s'ka fjalë të dëftenjë
Dashurin' e Bukurinë,
Nuk' e them dot atë ndjenjë,
Nuk' e them dot Perëndinë!
Mos u mundo kot,
Nukë thuhet dot".

Në këtë mes poeti sikur pushon s'ekzistuemi si subjekt dhe identifikohet me bukurinë, me të cilën kaherë asht shkri dashunija e tij, kurse shkalla ma e naltë e kësaj substance asht vetë perëndija, që „nuk thuhet dot", sepse nuk ekziston si krijesë absolute, si pjellë e imagjinatës kristiane e muhamedane, porse asht e inkarnueme në çdogja të natyrës. Dashunija dhe bukurija për Naimin janë identifikue në hyjninë. Derisa Shileri i ndikuem nga Spinoza pandeh se dashunija „e ngre njeriun deri në nji shëmbëllesë me Perëndinë", poeti ynë këtij njazimi ia shton edhe Bukurinë.

As Naimi, sikundër as pjesa dërmuese e romantikëvet, nuk i shpëtoi notës melankolike që karakterizohet nga „vuejtja e shekullit". Përçamja që ekziston ndërmjet Unit të tij dhe realitetit objektiv, do të thotë humnera që ndan aspiratat e shpirtit të poetit dhe mundësive që ia ofron ambienti dhe atmosfera e kohës, sjell pezmatimin e qenies së tij shoqnore, nga i cili lirohet me shpërthimin e vargjevet: o revolucionare, sikundër bani Hygo, o sentimentale e imagjinative, sikundër bani Klajst, e në rastin e letërsisë shqipe Naimi me nji varg shkrimtarësh të tjerë. Mirëpo, toni sentimental i poezisë së Naimit nuk asht notë dominante e koncenptit të tij jetësor. Vetë fakti që ai nuk mohoi iluminizmin, gja që e banë ca nga romantikët e spikatun si Shatobrian, Shlegel, Kolrixh, flet se ai ishte vitalisht i lidhun me idealet dhe synimet e vendit të vet dhe i ndiente ma mirë se askush tjetër pulset e tij. Pasojisht me këte, edhe vuejtja e tij, që asht e nji forme ma të butë se e nji duzine romantikësh, asht deridiku pasojë e shkëputjes së poetit, natyrisht nën presionin e rrethanave, nga rrymimet dhe atmosfera e vendit, aq sa asht pasojë e vetë motivit delikat rreth të cilit janë thurë vargjet ma mitare të shekullit. Duket se Naimi ishte plotësisht i përgatitun shpirtnisht të bahet mësues i madh, të jetë nji pishtar i përhapjes së dijes e njohunivet, së këndejmi edhe toni patetik i shprehun me nji stil lapidar i tregohet si

mënyra ma e mirë që ta arrijë qëllimin e vet t'iluministit. Ndërkaq, fluturimi i imagjinatës së tij të lektisun për nji harmoni univerzale çfarë i karakterizon yjt — ku do t'i kërkojë frymzimet Lasgushi — mbas nji lumtunije t'andërrueme magjike, e cila realizohet vetëm ndër përralla e fantazi, i hap mundësinë zhgënjimit total kur takohet mendja e shëndoshë me realitetin e kurdisun të nji absurdi. Frika nga humbja e objektit të dëshiravet ma të flakta vigjilohet me keqardhje, pezm dhe derdhje mllefi.

Naimin e cilëson aftësija e të menduemit dialektik, së këndejmi shihet sheshit se si preokupimet e shpirtit të tij ndryshojnë mvarësisht nga mosha dhe koha. Meqenëse identifikon b u k u r i n ë — d a s h u n i n ë — p e r ë n d i n ë dhe si mishnim të kësaj triade nxjerr femnën, asht e natyrshme të pandeh në pajtim me konceptin e vet filosofik panteist, se elementet e asaj dashunije, e cila përshkon çdogja të natyrës, të përshkojnë edhe qenien e tij. Vetë b e s o j m ë e tij i sjell satisfakcion shpirtnor të njazimit me bukurinë e dashuninë, e shi kjo ban që ai të mos kredhet në shpërthime vrushkujsh të nostalgjisë a pesimizmit. Madje-madje ai shquhet me matininë dhe racionalizmin e klasicizmit, tek-tuk të bashkueme me ekzaltime romantike-sentimentale.

Pse plaket, pse e len rinija dhe tok me te edhe të gjitha mirësitë e jetës së pabrenga, ai duket se nuk lodhet aq shum; së paku në nji mënyrë të tillë mitare tingëllojnë vargjet e tij. Ndonëse thot se do të qajë pareshtun për shkak se jeta s'asht ma për te, meqenëse nga pleqërija s'mund ta shijojë ma, Naimi i krijon nji antitezë këtij disponimi pakashum të zymtë dhe, ashtu siç ia marrin fuqinë natës rrezet e para t'agut, ashtu edhe bekimi që i ban të dashtunës s'imagjinueme:

Ti, o bukuroshja ime,
Të ritë ma paç për jetë,
Kurrë mos pafsh hidhërime!
Të dashtë Zot' i vërtetë!
Syri yt mos u venitë,
Si hena u përtëritë!

ven ekuilibrin ndërmjet dy kontrastevet, tue krijue nji kuptim qëllimi të durueshëm jetësor. Do të thotë, vetë asht plakë e molisë, por s'vuen për këtë shkak,

veç pse Ajo nuk do ta dashunojë. Ajo që shquhet në këtë mes dhe ve në spikamë natyrën fisnike të poetit asht humanizmi dhe altruizmi i tij, zemërmirësija dhe gatshmënija që as mohimin mos ta shpërblejë me mohim. Nji qenie e bukur, pamja e së cilës ngjall asociacione të lidhuna për krijesat ma të hieshme të natyrës, e nëpërmjet të të cilës vijnë në shprehje të gjitha atributet e hyjnisë, do të thotë me të cilën njazohet ajo, e të cilën tekembramja e dashunon, s'ka kurrfarë kuptimi të mallkohet, sikundër di të veprojë nji Mysse, kur vihet në lojë nga Zhorzh Sand. Shkaku tjetër i cili ban që ai ta bekojë me loçkë të zemrës ate dhe t'i dëshirojë freski e risi të pamortshme asht se nëpërmjet të saj bekon hyjninë. E kështu poeti vepron në pajtim me zemrën dhe trunin e vet; më zemrën: sepse ashtu plotëson hirin e saj, mbasi bekon ate që dashunon; me trunin: sepse ashtu vepron në pajtim me pikëpamjet e veta filosofike dhe idealin estetik.

Me të kaluem të rinisë asht e kuptueshme të çfaqet brengosje për arsye të humbjes së nji kualiteti të pazavendësueshëm jetësor, por tek Naimi kjo në radhë të parë asht brengosje për shkak të humbjes s'objektit të dashunisë. Për të shprehë karakterin tranzitor të rinisë, dashunisë, e madje edhe të jetës vetë, ai merr nji vjershë të tanë, si simbolikë të gjithë asaj me ç'asht përshkue jeta e tij e parandejshme. Vjersha të sugjeron imponueshëm të pandehish se vera — rinija, bilbili — poeti, lulja — e dashtunja si materie poetike po vihen tani në kundërshtim me dimnin — pleqërinë dhe zbemjen e asaj kohe. Ma në fund edhe vetë ritmi i saj sikur shpreh harbimin e djalërisë, e që asht në përputhje të qartë me vjershën e dhetë, ku shquhet gatshmënija e tij të bajë çmos vetëm e vetëm që ta shijojë at bukuri hyjnore, sepse jeta asht e shkurtë dhe kalon fluturimthi. Edhepse vjersha e fundit duket sikur del nga kontinuiteti i tanësisë së poemthit, prapseprap asociacionet që nxit ajo nuk bajnë përjashtim nga intonacioni i përgjithshëm i tij. Kështu në fund rishtazi hapet horizonti i depërtimit të gazmendit e dritës në zemrën e poetit, kurse tana kacafytjet e tij me vetëveten dalin përpjekje për të vendosë nji lumtuni e harmoni zemrash të bashkueme.

Sa i përket formës së Bukurisë nuk mund të pohohet premazi se Naimi ia ka dalë ta plotësojë me perpikëni at kërkesën e romantikëvet që „poezija të zhvillohet si bimë e jo të ndërtohet si godinë". Kjo

asht pasojë e së vërtetës se poezija nuk asht shkrue nën presionin e nji inspirimi të fuqishëm, por gjatë periodave të ndryshme të jetës, e ndoshta bukur vonë,[1]) për ç'shkak ndihet njifarë inkoherence në te, e përshkueme prej ramjeve e ngritjeve të ngjashme me valët që shqasin malamal sipërfaqes së detit. Femnën e dashunisë së tij s'kemi përse ta kërkojmë. Ajo nuk ekziston. Ajo asht andërr e rinisë, siluetë, që paraqitet e zhduket sa çel e mëshel sytë. Ajo asht persiatje rreth diçkafjes që e dëshirojnë vakuumet e qenies psikologjike dhe shoqnore të njeriut, persiatje për diçka që duhet t'i plotësojë hiret e zemrës dhe të shërojë plagët e jetës. Edhepse fluidum dëshirash andërrtare, ajo mjafton që prej saj të këllehet mendja. Dashunija e Naimit s'asht e lidhun për nji femën të caktueme, jo; ajo i asht kushtue kuptimit të përgjithshëm të femnës, bukurisë së saj dhe ndjenjavet të pashueme që zgjon ajo tek njeriu. Grueja së cilës i këndon aq bukur ai s'mund të gjindet gjetiu, përpos n'andërra, prandej edhe vetë ajo asht andërr. E ja për ç'shak, ju lutem, mos e profanosni idealin e poetit! Tekembramja, ai do ta emnonte, do ta quente: Ervehe, Violë o Alkinoje, porse ajo asht çdo grue dhe s'asht asnji: ajo asht ideja e poetit për femnën — ide e thellë romantike dhe njerëzore. Idhnimi i tij asht i nji forme ma të butë, gëzimi dhe hareja kanë shkallën e caktueme deri ku mund t'arrijnë; dëshprimin nuk e lëshon në thellësi si të mëdha — çdo formë e gjendjes së tij shpirtnore ka masën e vet — nuk del asnjiherë në skaj. Pse? Për arsye se poeti s'ka prej kujt të kredhet në gazmend as dëshprim të tepruem. Ndjenjat që i kushtohen hijes nuk mund të maten përkah intensiteti i vet me ndjenjat që i kushtohen grues. S'andejmi edhe vargjet e tij janë strukturë e mrekullueshme dhe kapin figura prej toke e në qiell, por, megjithate, nuk cysin asociacione të lidhuna për nji erotizëm aq të fuqishëm. Por, ky s'asht as qëllimi i poetit.

Bukurija përbahet prej strofash të ndryshme dhe vargjesh të llojllojshme: dymbëdhjetërrokshe, tetërrokshe, gjashtërrokshe dhe pesërrokshe, kështuqë s'mund të ndihet monotonija e vargut të njitrajtshëm. Përsa i përket ritmit të pasun, melodisë dhe tonalitetit, kjo asht vërtetë nji bukuri. Aliteracioni, antitezat,

1) Tetërrokshin e thyem, si në vjershën e dhetë, e gjejmë në përmbledhjen e Vaso Pashës „Rose e spine", 1873, Konstantinopoli.

simboli, rima e zgjedhun dhe kumbuese dhe mbarë mjetet e kullandrisuna poetike e fusin poemthin në fjalë ndër sajimet ma të bukura të lirikës shqipe. Asht për t'u habitë se me ç'përgjegjësi të naltë i respekton Naimi ligjet e metrikës. Fjalët e rimueme nuk janë të parat që i sillen ndërmend, ato janë të qëmtueme e të zgjedhuna me kujdesin e nazeqarit ma të madh të poezisë; janë të puthituna aq bukur, ashtu sikundër asht e gëdhendun dhe e përsosun edhe e tanë struktura e vargut të tij. Fjalën që dëshiron ta theksojë, sepse përmban esencën e kuptimit të tij, ai e ven në pozitën e rimimit ose t'akcentimit ritmik, porse aq mjeshtrisht sa ia del të ruejë të gjitha veçoritë strukturale të vargut e strofës. Nëpërmjet të vargjeve të ndryshme ai shpreh përbukuri edhe shkallët e ndryshme t'intensitetit të botës së vet të mbrendshme. Me vargun e shkurtë shtron rrshimin e ndjenjavet, tue krijue njikohësisht edhe mbresën e karakterit të tyne të përkohshëm, kurse me vargun e gjatë fiton volinë t'i japë dimensione ma të gjana mendore e spirituale botës intime. Porse, gjithëseku ndihet prezenca e tij, meqë çdo varg e strofë e njomëson me ngjyrën e temperamentit dhe natyrës së tij lirike. Bukurinë e cilësojnë antitezat e shumta, porse edhe vetë poemthi në tanësi përmban entitezën fundamentale që ndihet n'antinomitë kuptimore: dashunija — indiferenca, rinija — pleqërija. Ajo emfaza karakteristike e romantikëvet këtu mungon, pikërisht pse nuk i këndohet krijesës konkrete, por t'imagjinueme. Forma e poemthit asht lakue mvarësisht nga përmbajtja dhe situatat që konkretizohen. Qëllimi dhe mjetet janë plotësue në mënyrë reciproke. Engjulli i poezisë së Naimit i reshtet imagjinatës së lexuesit, por ai vetë e pason me suptilitetin dhe koloritin poetik. Engjullin e andërrimeve të tij nuk mund ta përfytyrojmë, porse ndiejmë fuqinë e poetit tonë të madh.

Emni i Fan Nolit e përkujton Prometheun e mbërthyer, jo pse e përktheu këtë vepër t'Eskilit, por pse i shëmbëllen disi me fatin e vet. Prometheun e dënuen perënditë që i lidhun për shkamb t'u ekspozohet torturave tantalike për shkak të zjarrit që u solli njerëzve, ndërkaq Nolin e dënuen njerëzit për shkak se drita që solli ai vetimthi ua lëbyri sytë e mësuem n'errësinë.

Noli e provoi nji kohë, edhepse shum shkurt, rolin e korifejt të popullit dhe vendit, at rol magjepës dhe fatal njikohësisht. Por, sikundër çdo pris i madh, i cili asht i bindun thellë se ideali i tij asht i drejtë dhe nuk mbështetet n'interesa individualiste, por synon të mirën dhe progresin e turmës së gjanë, edhe ai tanë jetën e vet prej stoiku s'pushoi së qenuni mbrojtës i ideve demokratike-revolucionare, për të cilat u rropat njiherë edhe praktikisht.

Ka shkrimtarë që krijojnë për hir të kënaqsisë që ndiejnë vetë, ka të tjerë që krijojnë për hir të kënaqsisë që i sjellin lexuesit, e ma së shumti ka të tillë që punojnë për hir të dy këtyne kënaqsive; porse, ata ma të mëdhejt, që rëndom iu thonë titaj të letërsisë, fjalën e vet artistike ia dedikojnë nji qëllimi të caktuem. Të tillë janë: Gëte dhe Balzak, Manconi dhe Tolstoji, Gorki dhe Breht. I tillë ishte edhe Fan Noli. Përveç poezisë, prozës e përkthimeve edhe introduktat e tij provojnë se gjatë tanë jetës qe i lidhun me mish e shpirt me idenë për të cilën bani orvatje prometheike në çastet vendimtare të vendit.

Noli asht poet, prozator, historian, dramaturg, kompozitor, kritik, e në të gjitha këto fusha krijimtarije vuni veten, pikëpamjet dhe kredon e vet. Shum krijimeve ua vuni vulën e politikanit, pra. Si estet ia paguen borxhin deridiku kësaj, por si tribun qëndron lart për kohën e vet pikërisht me pikëpamjet revolucionare. Veprimtarija e tij letrare asht e angazhueme për nji ide të caktueme.

Introduktat e Nolit e ndriçojnë autorin në shum pikëpamje: ato flasin sheshit për bindjet e tij, e tregojnë natyrën dhe temperamentin e tij, vejnë në dukje intuitën, erudicionin, kulturën e gjithanshme — kompletimin dhe rrugën e drejtë të kritikut. Tue analizue përfundimet që nxjerr ai pikaset kandi i tij i shikimit dhe metoda se si i qasej veprës letrare; introduktat e Nolit na mësojnë se krijimet artistike letrare, mu për arsye të vlerës së tyne, t'asaj katarze dhe „filtrimi të ndjenjave", si do të shprehej Aristoteli, kryejnë prore edhe nji funkcion të naltë shoqnor-social. Mënyra se si e zbërthen, tfillon, interpreton, ose ma në fund se si e rikrijon ai shkurtimisht nji vepër letrare shquen të vërtetën e pamohueshme se krijuesit e mëdhej janë ngahera aktualë, janë bashkëkohanikë tanë, jo vetëm për shkak të harmonisë e persosmënisë formale, por kryesisht për shkak të funkcionit shoqnor që sjell esenca e kuptimit të krijimtarisë së tyne dhe totaliteti estetik. Kritika noliane e afirmon këtë komponente kuptimore të veprës s'analizueme, tue e shque në radhë të parë besimin e vet se veprat e pamortshme janë të tilla pikërisht pse sjellin me vete domethanie kuptimplote dhe ushtrojnë ndikimin e naltë shoqnor-emociolna. Tue analizue mënyrën se si i qasej veprës letrare, do të thotë tue analizue metodën e tij simbas së cilës i shkroi introduktat, kuptohet edhe nji element me randësi i kredos së tij: çdo sajim artistik, tue fillue prej poezisë, nëpërmjet të dramës e romanit, dhe deri tek muzika, mund të zbërthehet e riprodukohet nga aspekte të ndryshme, tue marrë ngjyrën e kohës dhe momentit historik të studjuesit, respektivisht kritikut të vet. Kritika e tij, në qenësinë e vet realiste, i hap perspektiva të shumta veprës dhe tue vu në spikamë kuptimin e saj fundamental, i nxjerr edhe kuptimin që ka në momentin përkatës historik. Kështu veproi prore kritika ma progresive e shekujve, e kështu veproi edhe Noli. Përpos se ua gjen kuintesencën e tyne ideore-estetike, përpos se ua gjen elementet

bashkëkohore kuptimore, Noli në veprat të cilavet iu shkroi introdukta zbulon edhe vlerat e veçanta për të cilat ka afinitet të posaçëm individualiteti i tij; tue zbulue ato ai zbulon edhe epokën e vet, sepse me intuitë të pakufizueme sheh që një Shekspir, bie fjala, nuk flet vetëm n'emnin e vet, por n'emnin e mbarë njerëzimit, nuk flet vetëm për një periodë të caktueme të historisë njerëzore, por, tue folë për te, flet për të gjitha kohët. Pse disa veprave të përimtueme ua zbuloi ekuivalentin përkatës në vendin e vet, kjo e provon aftësinë e tij të shohë përtej të tjerëvet, madje edhe të merendohet në rreshtat e parë t'atyne mija studjuesve të Shekspirit dhe Servantesit.

Tue përcjellë temporalisht krijimin e kritikave të Nolit mund të vërehet edhe njifarë evolucioni kualitativ dhe deri diku kuptimor i tij ndaj letërsisë. Introdukta që i bani Othellos në vjetin 1915 e që shënon fazën e parë të krijimtarisë së tij si kritik, dallon sadokudo nga introduktat e mavonshme edhe për arsye se ai vjen tue zgjanue horizontin e vet, tue forcue bindjet, tue përsosë shijen dhe tue krijue orientimin e tij të përgjithshëm në lamën letrare. Porse edhe këtu shihen gjurmat e Nolit të pastajshëm, Nolit të mbas njizetekatërshit. Ndonëse askund, gjatë interpretimit të ndonji vepre, nuk ia nënshtroi të vërtetën qëllimit, këtu ma pak se gjetiu e cilëson qëllimin.

Më sa dihet deri sot, Noli nuk dha farë mendimesh të shkoquna, të kristalizueme, due të them, të drejtpërdrejta, për letërsinë ose artet përgjithësisht, së këndejmi ato mund të përfytyrohen nga metoda, shija, vetë përkthimi, simpatitë për këte apo at fytyrë letrare, për këte apo at koncept jetësor-filozofik dhe social-shoqnor. Nëqoftëse n'introdukta nuk mund të gjinden mendime ekskluzive për anën formale-strukturale të veprës, s'do pandehë se ai nuk i kushton vëmendjen edhe kësaj: aty janë mënyra e analizës e sintezës, aty janë konstatimet që nxjerr ai, aty janë persiatjet, ndjenjat, pikëpamjet e tij rreth nji të kalueme, rreth nji jete autonome, por edhe kolektive të veprës a individit — e nga këto shihet se ai e përfshin veprën nga të gjitha shtresat artistike. Mirëpo, edhe sikur të mungojshin këto — aty kemi qëllimin e tij që synon haptazi ta vejë në dukje. Në fillim të krijimtarisë si kritik letrar, ai asht nji vigjilues plotësisht objektiv (i tillë asht prore, por në fillim pa nishanin e caktuem), pa oscilime ndjenjash, prandej aty edhe i mun-

gon zjarri i analizuesit që e fut në punën e pastajshme. Sepse, në fillim ai spiegon kryesisht motivin e shtjelluem, flet për ngjarjen, konfliktin, pasojat, rrugët e çfaqjes së tyne dhe shkaqet që i nxitën; flet edhe për karakteret. Njikohësisht asht i prirun të bajë paralelizme, të kërkojë elemente historike-shoqnore dhe të depërtojë ashtu edhe në gjenezën e së vërtetës. Këto metodë analize, metodë induktive, me anën e së cilës futet edhe në strukturën e veprës, ai do ta vazhdojë e përsosi edhe matutje. Në këtë fillim spikatet edhe prirja e tij që, ndonëse e rrallë, të nxjerrë konstatime të sintetizueme.

N'introduktën e parë Noli provon të lëshohet në çfletime e zbërthime të karaktereve, të filosofisë dhe etikës së tyne. Porse, mendimet e kristalta, të shprehuna me at stilin e tij rrëmbyes, këtu akoma nuk mund të vijnë në shprehje sa duhet. I mungon baza e pikëpamjevet në saje të së cilës do të shtie aq shum zjarr në punën e mavonëshme. Kësisoji mund të thuhet se nuk ka ambicje ma të mëdha se sa t'i prijë lexuesit në të kuptuemit e subjektit dhe elementeve themelore të veprës. Këtu ai kryesisht vihet në shërbim të lexuesit dhe ia rrëfen rrugën e vështirë të depërtimit në materien letrare. Por vneri dhe mjalti i tij shpirtnor n'analizimin e karaktereve të diferencueme t'O t h e l l o s dalin në shesh edhe në këtë mes. Ai pikas se motivet që e shtyjnë Dezdemonën të dashunojë aq verbët Othellon e zi janë tri: krajatat dhe cfilitjet e tij — si hap i parë; trimnija e pakrahasueshme e tij — si hap i dytë; virtytet e nalta morale para të cilavet zbeheshin të gjithë mashkujt e tjerë — si hap i tretë dhe i fundit i dashunisë. Me bashkimin e këtyne tri vetive të nalta ai bahet objekt i andërrimeve të ngahershme të saj. Në tanësinë e tragjedisë Noli synon përbukuri „fuqinë motorike" e cila gatit brumin e saj. Tue analizue karakteret kryesore të dramës dhe tue shtrue dialektikën e sjelljeve ndërmjet tyne, ai i afrohet idesë esenciale të saj. Othellon e spiegon si njeri të lartë moralisht e shpirtnisht, njeri pa sherr e hile, njeri të cilit s'i flejnë në zemër intrigat, hipokrizija e as djallëzija. Si të tillë e nxjerr naiv para Iagos pshikatar, intrigant e demon në kuptimin e plotë të fjalës. Othello asht zemërbardhë, bujar, bamirës, njeri i lartë, përkundër Iagos së lik, faqezi dhe miniatural shpirtnisht. Tue e brimue qëllimin themelore të krijuesit që të bajë polarizimin e këtyne dy karaktereve ai mejton

se pikërisht ky polarizim, i cili potencohet me dashuninë e flaktë ndaj Dezdemonës, respektivisht me xhelozinë që shkaktohet në zemrën e Othellos, përmban boshtin rreth të cilit thuret tragjedija. Në të vërtetë, tue akcentue mëninë katastrofale dhe xhelozinë demonike t'Iagos ndaj zezakut, kritiku pandeh se dashunija e tij ndaj Dezdemonës përmban lajtmotivin e tragjedisë. Por s'duhet mendue se fillikat Noli gënjehet në këtë pikëpamje — jo. Ashtu mendojshin edhe shum e shum studjues-shekspirologë. Po u përmenden emnat e tyne do të shihej se kësi mendimi kishin disa mendimtarë të njoftun botnorë. Ndërkaq, simbas studimeve ma të reja të kësaj tragjedije, që me H a m l e t i n dhe M b r e t in L i r përmban at bjeshkën trimajëshe të botës shekspiriane, konfliktin ndërmjet Iagos e Othellos e spiegon nji motiv ma i thellë që ngërthen në vete edhe xhelozinë erotike. Kjo asht „xhelozija e mendjes shterpe ndaj fuqisë krijuese naive..." thot Vidmar *n'Improvizimet* e veta mbi Shekspirin, dhe shton ma tutje: „Kjo asht fuqija që e ve në lëvizje, ky asht shkaku i vërtetë i smirës së tij, që në monologjet e veta e fsheh nën pretekste të ndryshme siç janë xhelozija ndaj Cassit, urrejtja ndaj Othellos, të cilin e akuzon se „dikur paska hypë në shalën e tij", dhe dashunija ndaj Dezdemonës, për të cilën thot se nuk e dashunon „vetëm për hir të kandjes". Asnjana prej këtyne xhelozive nuk do ta shtynte n'at lojë të tij të llahtarishme në të cilën e shtyn kryekëput xhelozija e mendjes së tij, që sheh çdogja, porse asht e pafrytshme, ndaj personalitetit të verbët dhe krijues t'Othellos. Në konfliktin e këtyne dy parimeve jetësore qëndron edhe konflikti themelor i kësaj drame e cila, megjithate, asht dramë xhelozije, por jo erotike, veç e nji xhelozije ma të naltë, shpirtnore".

Noli pikas të gjitha vetitë që i diferencojnë karakteret e tragjedisë dhe at fluidumin që përshkon mendimet e tyne. Nëqoftëse qëndrimi i tij ndaj qenësisë aktive dramatike nuk mund të mbahet, intuita e tij s'ngeli pa dhanë rezultate në nji drejtim tjetër. Në të vërtetë, ai thot se, për të ruejtë nderin e vet, Othello paska vra Dezdemonën dhe veten. Për hir të nderit ai paska ba edhe nji sakrificë qysh përpara. Veç këtij fakti, kritiku ven në dukje edhe dashuninë e zjarrtë ndërmjet zezakut e bukuroshes së bardhë. Do të thotë se i akcenton këto dy momente, çka nuk e bajshin ashtu kritikët e tjerë. Nga këto mendime mund

të nxirret përfundimi: tragjedija Othello len të mendojmë se njerëzit janë të barabartë dhe se jeta ka vlera ma të nalta se qëllimin e vetëvetes. Për kuptimin nolian ky asht nderi — etika. E nderi përfshin edhe qëndrimin njerëzor ndaj gjithkujt. Nderi asht kategori shoqnore që s'duhet përlye. Noli, pra, thekson efektin moral. Mendimet e tij bajnë të ndiejmë se tragjedija e bashkëshortëve i dedikohet nji qëllimi ma të naltë. Gati pesëdhetë vjetë mbas botimit të kësaj introdukte nji mendim pakashum shëmbëllyes me këte mbi porosinë e Othellos e formulon me nyanca të reja edhe Hugo Klajn, për të cilin kjo asht tragjedi e burrnisë. Tue provue se Othello e vret Dezdemonën si ithtar i humanitetit dhe progresit, ai thot: „Prandej Othello asht tragjedi thellë optimiste. Othello dhe Dezdemona vdesin, por ajo që solli dashuninë e tyne të madhe, ajo për të cilën tekembramja dhanë jetën: dashunija ndaj njeriut, besimi në t'ardhmën, lufta për realizimin e idealit njerëzor — kjo mbeti ngadhnjimtare dhe e papërlyeme, ata s'e tradhëtuen këte..."

Sidodoftë, në këtë hymje të parë nuk shihet akoma qartë Noli i zjarrtë dhe erudit që, kur shkruen për Qesarin, Brutin, Kasin, Hamletin, Stokmanin e të tjerë, të bahen se çohet furtunë e ushtimë kundër të gjithë tiranëve, plutokratëve, borgjezëve e shtypësve të tjerë të lirisë së mejtimit, ku luftarët e së drejtës së përgjithëshme bahen objekt i simpatisë së tij të thellë. Këtu akoma s'del në shprehje të plotë ironija me sarkazmën e tij të pamëshirshme, porse shihet që asht i prirun të zbulojë e theksojë karakterin historik dhe shoqnor-social të veprës. Veçse, aty pikasen fillet e stilit nolian, stilit lapidar, kumbonjës e vetues njikohësisht, pikasen xixat që shkrepin nga kontakti i nji intuite dhe mendje të fuqishme me kryeveprat botnore të letërsisë dhe muzikës. Pa nji kredo estetike, ai shkruen tue u mbështetë në shijen dhe kulturën e gjanë letrare, njohjen e mirë të teknikës së dramaturgjisë dhe të përjetimit personal të sajimit letrar. Stilit të tij tash njiherë i mungon ai pathosi emocional dhe ideor që përmban indin themelor të shkrimeve të mavonëshme. Porse dallohet metoda e tij e mbarështrimit të mendimeve e landës dhe forma simbas së cilës i shpreh ato mendime. Edhe këtu elementi biografik-historik ze rreshtat e parë dhe plotësohet tevona me ekspozimin e mendimeve mbi shtresat e mbrendshme

të vetë veprës. Që nga kritika e parë shihet se Noli asht realist në spiegimin e letërsisë. Metoda e tij analitike ngërthen pothuej të gjitha aspektet e shikimit të veprës, që kanë të bajnë në radhë të parë me domethanien dhe funkcionin e saj. Edhepse hovehove mbështetet në reflekset e veta emocionale dhe u jep mundësi impresioneve personale që të shquhen, prap duhet thanë se Noli asht kritik racionalist. Më bahet se introduktat e tij janë mostër se si kritika nuk mund të jetë vetëm analizë e thatë, por duhet pasë diçka edhe nga suptiliteti artistik. Ato janë simbiozë e mendimeve racionale, por edhe ekspresive. Për hatër të shprehjeve impresive ai nuk e sakrifikon kurrë të vërtetën, por as nuk bie viktimë e kanuneve të pathyeshme. Individualiteti i tij i fuqishëm zgjedh rrugën e trajtimit origjinal.

Tue shkrue për disa nga romantikët ma të dalluem anglezë, Marksi thot se Bajroni, po të jetonte edhe ma, sigurisht do të bahej nji borgjez reakcionar, prandej asht ma mirë që vdiq tridhetegjashtëvjeçar, ndërkaq, Sheli ishte i lindun revolucionar, prandej asht fatkeqsi që vdiq njizetenandëvjeçar. Aq ma lehtë njeriu mund të thotë për Fan Nolin se ishte revolucionar i lindun, pa u frigue se do t'i vishet etiketa e fatalistit. Revolucionaritetin e vet ai e tregoi shumfish: si burrë shteti, si historian, si poet dhe si kritik. Si burrë shteti: përmbysi tiraninë. vuni në plan të parë të progresit punëtorin dhe fshatarin, njohti shtetin e parë socialist në botë: si historian: rolin e individit ia nënshtroi rolit të masës në krijimin e historisë dhe u tregue avangardist në ndryshimin e saj; si poet: edhe përkah përmbajtja, edhe përkah forma poezitë e tij janë revolucionare — vetëm tonika e tyne ngjall asociacione në lidhje me orkestrimet ma revolucionare të muzikës; si kritik: u shkroi introdukta disave nga veprat ma të bukura të letërsisë së përbotshme, në të cilat cek dhe akcenton vlerat e tyne progresive.

Introdukta e Othellos shënon fazën e parë të veprimtarisë së tij kritike. Në fazën e dytë hyjnë introduktat që u shkroi vepravet, të cilat i përktheu mbasi ra nga pushteti. Për të pa këtë zhvillim të tij si kritik letrar gjatë fazës së dytë doemos duhet të kihet parasysh hymja që i bani Jul Qesarit, si kulm i krijimtarisë së tij në këtë lamë.

Drama historike-politike mbi diktatorin e Romës i dha mundësi Nolit të kredhet në persiatje edhe rreth

ngjarjeve politike të Shqipnisë, në të cilat edhe vetë luejti nji nga rolet kryesore. Kjo tragjedi qe medij i përshtatshëm që të shtrojë paralelizëm ndërmjet historisë së vjetër dhe historisë së re, ndërmjet dy fazave kalimtare në historinë e dy popujve, mu pse në qenësinë historike gjeti diçka të përbashkët. Së këndejmi interpretimi i tij i kësaj tragjedije asht aq „subjektiv", aq patetik, saqë këtë kritikë e ban nji ndër introduktat e tij ma të zjarrta. Tue folë për protagonistët e saj, tue spiegue shkaqet e largimit shum të pakët të Shekspirit nga materia historike, por, prapseprap, tue e nxjerrë këte si nji nga veprat e tij ma historike, tue vu në spikamë objektivitetin e autorit në formimin e karaktereve dhe në shtruemjen e koncepteve morale të dy sistemeve shoqnore: perandorisë dhe republikës, Noli potencon vlerën shoqnore të saj e përbri edhe arkitekturën e dendun të Jul Qesarit. Kjo do të thotë se tue u nisë nga analiza historike-shoqnore ai vetëvetiu del tek përimtimet strukturale-estetike. Këtu kritiku asht i kompletuem. Esencën e tragjedisë në fjalë dhe konfliktin si skelet të saj e përbajnë dy koncepte anmiqsore.

Të shohim nga anon subjekti i kritikut dhe nga janë të drejtueme simpatitë e tij.

Mund të supozohet se, tue analizue dy sistemet e dy fytyrave të tragjedisë, ai kërkon edhe shkaqet e dështimit të sistemit personal, kurse tue lejue shpërthimin e simpative për njanin prej tyne, ai çfaq edhe pendimin pse nuk përdori diçka edhe nga sistemi i tjetrit. Sido që të jetë, sistemi i parë, do të thotë prisi i tij, Bruti, asht përgëdheltari i Nolit, përpos të tjerash, edhe për arsye se në konceptin e tij filosofik e moral gjen nyanca të natyrës humane personale. Noli e arsyeton etikën e Brutit, porse asht mjaft vigjilent të konstatojë shkaqet e disfatës së tij. Nga pjesa ma e madhe e studjuesve të kësaj drame, demokrati shqiptar gëzon përparsi bukur të madhe, mbasi jo me rastisje fataliste, por në saje të natyrës revolucionare, u gjet njiherë në ballë të nji shteti. Prandej nga piedestali i prisit mund të shihte ma shum dhe ma larg se sa ata. Kur thot se Bruti e Kasi, ndonëse ithtarë të të dy sistemeve të ndryshme revolucionare, sa i përket hapit të parë për sendërtimin e lirisë, janë të nji mendimi — kjo do të thotë se në përgjithësimet dramaturgjike ai konstaton nji element me randësi — pushteti tiranik ekzistues duhet të rrëzohet me forcë. Ky

asht qëndrim revolucionar mbi detronizimin e nji tiranije. Kështu, ndoshta, pikas edhe mendimet latente të dramaturgut të madh në lidhje me sistemet shoqnore dhe mundësinë e përmbysjes s'atyne reakcionare. Mandej, konstaton se mbas hapit të parë dhe vendimtar nis e shpërthejnë divergjencat, çka nënkupton konkretizimin e pikëpamjeve mbi shoqninë në nji moment historik si dhe të përvojës vetiake. Dhe n'ato çaste vendimtare, kur njeriu qëndron shum pak larg stihisë, asht vështirë të zgjedhet rruga ma e drejtë jo vetëm moralisht, por edhe historikisht. Ja në çfarë ekuilibri i ven Noli këta dy republikanë — ithtarë metodash të ndryshme: Bruti asht njeri me skofi dhe skrupulla morale, prandej edhe koncentron mendjen të zgjedhë shokët, mjetet, rrugët për t'arrijtë në liri. Ky nuk njeh formulën simbas së cilës qëllimi arsyeton mjetet. Jo — thot Noli. Në thelbin e etikës së tij qëndron nderi, burrnija, fisnikërija. Fjalët i ka të matuna, gati mitare. Beson thellë se sikur të përdoreshin mjetet që predikon Kasi, e që bazohen në gjakderdhje të pakursyeshme, nuk do të dalloheshin nga tirani të cilit i fusin thikën në shpinë. Noli e simpatizon edhe për mendimin e tij se shokët e populli duhen ba për vete me sqarimin e drejtë t'idealit të lartë që vejnë përpara, e jo me pare, ryshfet e gënjeshtra. Ata që hiqen mbas interesit vetiak janë njerëz të liq e paskrupulla dhe nuk mund të bahen kurrë shokë besnikë, kurse metoda e tyne e përvehtësimit të tillë të njerëzve dhe ithtarëve asht imorale. Kësisoji Bruti i pëlqen kritikut edhe pse predikon kujdesin ndaj shtresave të vorfuna, të cilat s'duhet të sillen në situatë që të katandisin. I pëlqen edhe pse mendon se njerëzit e padisiplinuem dhe të paskofi, si dhe të gjithë ata që s'prihen nga ideali, por nga levërdija, duhen largue prej taborrit të republikanëvet, në mënyrë që të shihet se veç qëllimit, ndryshojnë edhe mjetet e tyne. „Shkurt, ashtu si ndryshon qëllimi i liberatorëve nga ay i tiranëve, ashtu duhet të ndryshojnë dhe shokët, mjetet dhe punët e tyne, që kështu populli t'a shohë menjëherë ndryshimin e njerëzve e të sistemit, t'u japë besim liberatorëve dhe t'i ndihmonjë me gjithë zemër për t'arrirë qëllimin me sukses". Bruti i krijuem me realizëm dhe objektivitet nga ana e Shekspirit e josh Nolin dhe jep mendime zemërmadhësije e simpatije për te pa ngurue t'i shquejë as të metat e sistemit. Njohës i shkëlqyeshëm i literaturës mbi dra-

maturgun e famshëm, ai prej andej vetëm faktet historike dhe biografike i shfrytzon dhe fut në fillimin e introduktës së vet, kurse brumin e tragjedisë e merr si medij jo vetëm t'analizës kritike-shkencore, por edhe të të shtruemjes së pikëpamjeve të veta revolucionare.

Noli ka nji afinitet të posaçëm ta gjallësojë portretin psikologjik të karakterit që analizon dhe ze në thelb edhe mendimet latente t'autorit. Ai rekonstrukton me imagjinatë të fuqishme pikëpamjet e fytyrave që trajton në bazë të sjelljeve dhe veprimeve të tyne. Kështu, në bazë të qëndrimeve dhe pikëpamjeve të përgjithshme të Brutit konstaton se veprimet e tij janë në pajtim me edukatën e tij, e cila mbështetet në parime stoike. Ky asht shkaku i dytë pse i pëlqen natyra e tij. I guximshëm, mendjehollë, i disiplinuem, i zoti t'i frenojë epshet, ai di t'i mëshehë edhe mendimet, vuejtjet e gëzimet, por kur asht në pyetje vetëvrasja, i ban lak bindjes stoike. Ma parë „preferon të vrasë veten se sa të zvarrniset i mundur pas qeres triumfale të tiranëve nëpër rrugët e Romës". Nuk di ta ketë spiegue tamam të tillë edhe ndokush tjetër Brutin: stoik, por kur asht në pyetje akti i vetëvrasjes, ia fal dreqit tanë stoicizmin e vet. Po përse? Për hir të dinjitetit — do të përgjigjej Noli. Ndoshta edhe ky asht njifarë stoicizmi në mënyrën e vet. Sikundër do të shohim ma vonë, Noli në veprimtaritë e tij si krijues letrar ka të bajë kryesisht me njerëz stoikë, për shkak se i don dhe pse në natyrën e tyne sheh veti revolucionare dhe ateiste. E nëse spikat gatshmëninë e Brutit të bajë vetëvrasje, kjo s'do të thotë se qorton stoikun, por i shpreh admirim edhe nji vetije të tij revolucionare dhe edukonjëse. Sepse, me vetëvrasje nuk vritet edhe ideja progresive, përkundrazi shembulli u shërbeu breznive të mavonëshme. Bruti, siç e spiegon Noli, asht shembull i nji prijsi revolucionar dhe në bazë të vetive që konstaton ky në karakterin e tij — vetive morale — do të mund të quhej revolucionar socialist. Moralisht Brutin e nxjerr të përsosun, porse me aftësinë e trajtimit të njeriut nga të gjitha anët, ai sheh edhe të metat e tij që shprehen në sistemin e tij. Kështu, tue qitë në dritë totalitetin e republikanit të parë, kritiku na shpie tek i dyti, Kasi, si antipod i tij. Këtu tani, veçse shquen ndryshimet e botëkuptimeve të tyne jetësore, ven në dukje edhe dallimet e sistemeve të tyne politike.

Kasi shquhet me cilësi që s'i ka Bruti. Tue i vu në dy pole të kundërta qëndrimet e tyne politike, madje me nji theks ma të dalluem se tek autori i tragjedisë, Noli çel mundësinë e trajtimit të të dy rrugëve revolucionare. „Kasi — thot ai — s'ka fenë absollute, gjak-ftohtësinë, durimin, vetë-kontrollimin, vetë-bqsimin, lakonizmën, bujarësinë dhe ëmbëlsin' e Brutit, po e kapërcen nga zotësia organizatore, nga mjeshtëria propagandiste revolucionare, nga sqojtësia politike, nga eksperienca e jetës praktike dhe nga njohja e thellë e njerësve (...) I urren tiranët me tërë forcën e shpirtit, s'ka skrupulla, drejtësi a mëshirë për ta, është gati të bëhet dy herë më tiranik se ta në methudat gjer sa t'i shtypë e t'i shuanjë nga faq' e dheut. Mjeshtëria dhe argmentat e tij për të ndezur kundër tiranit ata që kanë gjak prej burri të lirë janë të pakapërcyershme dhe munt të shërbejnë si një katekizmë për çdo agiator dhe propagandist revolucionar të çdo kohe. Di të zgjedhë njerëzit, mjetet dhe kohën për të mbaruar punën, di cilët prej kundërshtarëve janë të rrezikshëm dhe duan qëruar". Mbas të gjitha këtyne, Noli ban pyetje: përse Kasi, megjithë prioritetin e tij organizativ dhe mobilizues, i nënshtrohet sistemit të Brutit? Përgjegja e tij asht përafërsisht kjo: Sistemi me baza ma të forta morale e ka rrugën ma të sigurtë nga fitorja. Tekefundit t'i japim fjalën vetë Nolit edhe njiherë:" ... sikundër na mëson historia, suksesi i sistemit të Kasit, m'i shpejtmë dhe m'i lehtë në krye, është' i pashigurtë dhe rrallë qëndron më këmbë pastaj, kur suksesi i sistemit të Brutit, m'i ngadalmë dhe m'i rëndë në krye, ka baza prej çeliku dhe rrallë tundet a rrëzohet pastaj..." Nëse mendojmë se Marksi dhe Engelsi shquejshin metodat humane edhe gjatë ndryshimeve historike, s'do pasë dyshim se Noli asht në vazhdën e rrymimeve ma progresive të të menduemit njerëzor.

Si kritik realist dhe analatik i fakteve të veprës, Noli ven në dukje se Shekspiri, ma tepër se në ndonji prej veprave të tjera me subjekt historik, asht objektiv, por jo edhe i paanëshëm, në sajimin e karaktereve të kësaj tragjedije. Por, a mund të thuhet kjo në këtë mes edhe për vetë kritikun tonë? ! Tue e trajtue Jul Qesarin si „veprën më të fortë theatrale të botës", ai në të vërtetë i shkruen panegjirik idesë revolucionare që pleks esencën e mendimeve dhe veprimeve të dy bartësve të saj: Brutit dhe Kasit. Ngazëllimi i tij

nuk i nënshtrohet bukurisë së materies së dendun dramaturgjike sa idesë së saj. S'ka fije dyshimi se kur thot që Kasi ishte kredhë në pesimizëm dhe kishte humbë besimin në popullin dhe rininë e Romës, për të cilët mejtonte se „duhen shtyrë me hosten e hequr me kapistall në udhën e përparimit", i gjen kësaj ekuivalentin përkatës të rastisjes edhe në vendin e vet; e kur e spikat vetëdijen e Kasit për cenet e tij dhe për mungesat e sistemit të tij dhe këtu gjen bukurinë e këtij „idealisti revolucionar", në të vërtetë i thur panegjirik sinqeritetit njerëzor.

Nga ç'u tha sipër do të mundë të kuptohej se Noli i kushton randësi vetëm shtresës shoqnore dhe ideologjike të veprës, kurse iu reshtet shtresave të tjera. Nji përfundim i tillë do t'ishte lajthitje, sepse, me kritikën e tij ai prek të gjitha shtresat e veprës letrare: shtresat historike, shoqnore, strukturale e, tekembramja, edhe formale. Tue ba analizën e karaktereve, tue i shikue nga shum kande marrëdhaniet ndërmjet tyne dhe tue i shoshitë mirë e bukur faktet, ai vetëvetiu i qaset edhe strukturës së saj. Ai e ban lexuesin të pakset me argumentet që sjell për konkretizimin e mendimit të dhanun, kështuqë edhe kritika e tij nuk u takon atyne interpretimeve që janë permeabile sa u përket pohimeve të konkretizueme. Nolit nuk i mungojnë argumentet, meqë ai pa ta as nuk di të flasë, së këndejmi edhe fjalitë e tij janë të drejtpërdrejta dhe zhgjetuese. Si të tilla ato janë ngahera sugjestive.

Nëqoftëse nëpërmjet të vargjeve të poetit a rreshtave të prozatorit orvatemi të zbulojmë elemente të ndërdijes s'autorit, atbotë shum ma lehtë asht të hetohen elementet e tilla në punën e nji kritiku, të cilit metafora mund t'i hyjë, porse jo aq shpesh, në përdorim. Megjithate, edhe kritiku asht artist dhe nji pjesë të qenies së vet ua dhuron rreshtave që i shkruen. Aluzionet e tij mund të jenë ma të fuqishme se të ndonji artisti tjetër. Noli asht kritik që nuk i reshtet shprehjes figurative e as analogjisë. Tanë introdukta e kushtueme Jul Qesarit asht e shkrueme në trajtë tezash e antitezash, me komparacione të shumta. Ajo asht nji paralelizëm historik ndërmjet fatit të Romës së dikurshme dhe Shqipnisë në kohën e tij. Pse edhe këtu nuk vepron sikundër n'introduktën që i shkruen Don Kishotit motivi asht i qartë: materia e tragjedisë mbi diktatorin Qesar jep mundësi persiatjesh parimore. Indi i introduktës shpie të për-

fundohet se ai pandehte me të drejtë që boshti i kurrizit të dramës nuk janë karakteret e diferencueme të Brutit dhe Kasit, në nji anë dhe Mark Antonit, n'anën tjetër, por, sikundër e thonë studimet ma të denja të saj, konflikti i ideve të tyne. Ata në realitet janë aktorë të lajmotivit mbi ballafaqimin e botëkuptimit autokratik dhe atij republikan. Qesari asht i vdekun, porse dy republikanët luftojnë kundër „hijes" së tij, derisa në fund bien viktima krenare të saj. E Noli, me prirjen e tij të pashoqe që ta shikojë veprën artistike dhe idenë e saj me sytë e momentit të vet historik, ndonëse i „verbët" nga simpatija ndaj republikanëve, prap sheh si shkabë dhe s'i shpëtojnë elementet ma thelbore të tragjedisë.

Introduktat mbi *Qesarin* dhe *Rubairat* janë kritikat ma të gjata të Nolit. Në të parën bie në sy pathosi dhe intensiteti emocional që pleks mendimet e shprehuna rreth karaktereve, natyrës, temperaturamentit, bindjeve dhe moralit të tyne. Në planin e përgjithshëm estetiko-letrar ai pranon bukurinë e të tri fytyrave kryesore: Brutit, Kasit dhe Mark Antonit; ndërsa në planin etik, edhepse u njeh aftësitë dyve të fundit, ai flak metodat dhe moralin e tyne. Si kritik i rri besnik idesë s'autorit dhe ban orvatje t'ua përcjellë esencën lexuesve, anipse nuk e mësheh as admirimin e vet konkret. Tue analizue kryeprotagonistët kërkon totalitetin e njeriut, kurse tue analizue shkaqet e konfliktit të dy botëkuptimeve kërkon edhe shkaqet e dështimit të nji ideje progresive në nji moment historik. Përgjegja që jep provon se analiza e tij kap nji bazë të gjanë kulture e potenciali shpirtnor. Prej shum kritikëve që kanë shkrue në kohën e tij, pjesa dërmuese janë harrue shi për shkak të njianshmënisë në trajtimin e letërsisë, kurse Noli hyn ndër pakicën që edhe sot mund të quhen bashkëkohanikë. Kritika e tij asht prore aktuale ngaqë i qaset letërsisë prej aspektesh të ndryshme dhe nuk e thjeshtëson sikundër bajnë sot kritikët strukturalistë, formalistë, ose ata që shohin sall shtresën sociale në te. Në saje të platformës së vet progresive ideologjike Noli ia del të vigjilojë thelbin e tanësisë artistike të veprës s'analizueme. Mirëpo, sikundër në punën e çdo njeriu, as në punën e tij si kritik letrar, nuk përjashtohen gabimet, qofshin të vetëdijshme apo jo. E ai ishte aq i madh sa për gabime të pavetëdijshme nuk mund të flitet kur asht fjala për te. E kur asht në pyetje kritika e tij, atbotë duhet

dijtë se Nolit s'mund t'i thuhet tjetër fjalë përpos n'e shikofshim me kriterin e kësaj thanie t'Anatol Fransit: „Tue folë për Hamletin, iu flas për vetëveten". Sepse, shpesh ai flet me përvojën e vet, e jo të materies që analizon. S'jam plotësisht i sigurtë, por me njifarë droje marr guximin të pohoj se në Jul Qesarin Noli kërkon katarzë personale. Dhe, kur pohon se mosvrasja e Mark Antonit, si gabim i parë dhe leja që të mbajë fjalën funerale, e si gabim i dytë që bani Bruti, nuk mjaftojnë për t'u kuptue shkaqet e disfatës, shihet se orvatet t'i gjejë arsyet e njimendta të një dështimi me randësi historike. Ndoshta kur pason mendimet e Plutarkut dhe Shekspirit përkitazi me disfatën e republikanëve, nuk e bind veten se e thonë tamam të vërtetën, por mbasi nuk mund ta abstrahojë veten tumir nji zgjidhje të tillë. Noli shquhet me njohuni të thella historike, s'andejmi nuk ia kap mendja se si mund të ngjasë regres në zhvillimin historik shoqnor. Ngadhnjimi i tiranisë asht i pakuptueshëm për te, ashtu siç qe i pakuptueshëm edhe dështimi i qeverisë së tij. Me kaq nuk kënaqet, meqë përgjegja s'i plotëson kërkesat e mendimit dialektik. Prandej, kur në fund thot se shkaku kryesor i disfatës nuk janë dy gabimet e sipërpërmenduna të Brutit, e sigurisht as ato tri elementet e tjera fataliste (fati, rasjet dhe perënditë), por „atituda e ushtrisë, e parësisë dhe popullit", ai tregon nji kuptim apodiktik për zbërthimin e shkaqeve dhe pasojave në histori. Dhe tue dallue se ç'asht teknika dramaturgjike e Shekspirit, respektivisht, tue vigjilue se ç'bante krejt ai për hir t'efektit në skenë, Noli mohon se Mark Antoni e hipnotizon popullin me fjalët e tij magjike (këte e pohon Shekspiri me nji duzinë kritikësh të tij). E shkaku i nji stagnacioni të historisë në këtë rast, simbas mendimit të tij, janë rrethanat dhe kushtet objektive e subjektive, që u bashkuen. Populli dhe rinija për kuptimin e Nolit janë prore progresivë. Mirëpo, Roma u gjet edhe njiherë nën zgjedhën tiranike jo për shkak të tradhëtisë së popullit a elementit tjetër përparimtar, por pse: populli u frikësue nëpërmjet t'agitatorëve, ushtrija u gënjye, teksa parija ndejti indiferente.

Noli përktheu nji numër bukur të mirë kryeveprash botnore dhe disave prej tyne iu shkroi introdukta. Ekzistojnë mendime se në përkthimet e veta ai kërkon edhe njifarë ekuivalenti shoqnor e moral edhe në vendin e vet. Nuk mund të përfillet nji mendim aq i

ngushtë. Ai përktheu Don Kishotin e Armikun e popullit pikërisht pse me përmbajtjen e tyne synonte nji efekt të caktuem dhe pse aty gjente përkrahjen e ideve të veta për stigmatizimin e regjimit të vendit. Por Hamletin e përktheu jo pse mund të ketë kërkue vetëveten në hamletizëm, por pse bukurija e kësaj tragjedije fascinante magjepste qenien e tij. Dikush tha njiherë se Hamleti asht Mona Liza e letërsisë botnore. Magjisë së tij s'mund t'iu shmangte as Fan Noli që njihte aq bukur disa gjuhë të hueja dhe kishte shkrue edhe vetë drama. Posedonte të gjitha mundësitë që të bante përkthime të pakapërcyeshme. Nëse në Jul Qesarin, Makbethin, Don Kishotin dhe Armikun e popullit, përveç kënaqsisë që sjell kontakt me të bukurën, kërkon edhe ma tepër idenë, angazhimin, mundësinë e introspekcionit dhe të çfaqjes së mbrendisë së vet nëpërmjet t'inroduktave, nëse atje i pëlqejnë mendimet dhe filosofija jetësore, në Hamletin dhe Rubairat kërkon në radhë të parë bukurinë, joshjen e saj, por tekembramja edhe funkcionin shoqnor. Noli thot se tragjedija mbi diktatorin e Romës asht vepra ma e limosun dhe ma e rrastë arkitektonisht e Shekspirit. Dhe njimend, ajo dhe Koriolani e Antoni dhe Kleopatra mirren si veprat e tij ma të thadrueme. Për Hamletin thot se asht vepra „më popullore dhe më e thellë" e botës. Edhepse për nga forma dhe kërkesat integrale dramaturgjike nuk mund të përqaset me dramat tjera të Shekspirit, Hamletin e trajton Noli si kryeveprën e tij, sigurisht për shkak të kuptimit të naltë që ka, porosisë jetësore, efektit, moralit. Ai askund nuk krijon distinkcion nga forma dhe përmbajta dhe, nëse mirren parasysh të gjitha përkthimet e tij, do të shihet se nuk i shkonte njana pa tjetrën. Përktheu Poe-n, Tjutçefin, Bodlerin, Verlenin për arsye se vargjet e tyne janë të limosuna deri në përsosmëni, por përktheu Hamletin për arsye se i bahej që tanë përvoja e jetës dhe botës janë përmbledhë në te. Sidoqoftë, duket që Noli asht i prirun ma tepër t'i japë randësi subjektit, materies, landës, dhe në këtë pikëpamje e përkujton Metju Arnoldin, i cili mund t'i ketë ndihmue ta tëhollojë shijen e vet. Prandej edhe zgjedh kryesisht veprat që kanë nji përmbajtje ma kualitative. E Hamleti, ndonëse i bahen vërejtje përkitazi me koherencën e pjesëve me

tanësinë, dallohet në zodiakun shekspirian përkah thellësija e përmbajtjes.

Ndër pesëdhetëmijë veprat e studimet e shkrueme mbi Shekspirin ka mendime të gjithënduershme rreth tij: të papranueshme, të papranueshme, lapidare e konfuze, retorike e filosofike, por edhe mendime të paqarta dhe banale. Aq ma tepër ka mjaft qëndrime kontradiktore dhe, derisa nji numër mendimtarësh si Volter, Tolstoj e Sho e hedhin në fund të pusit, të tjerët e ngrisin në kupë të qiellit. Ndër këta të fundit ka edhe panegjirikë të zjarrtë sikundër janë Gëte, Raskin a Pushkin. Noli, në mundësi joshëse si nga të parët ashtu edhe të dytit, ka intuitë gjeniu që të mos e pasojë zanin e ndonji autoriteti pse asht autoritet, por e heton vetë të vërtetën. Prandej edhe dha mendime origjinale. Simbas tij, Hamleti shpreh kuptimin e autorit mbi njeriun dhe skepticizmin e tij ndaj jetës përgjithësisht. Kur thot se Hamleti „ësht piktura më e pasur dhe më e thellë, që ka dalë nga penda e Shakespeare-it, i cili në fytyrën e tij ka pikturuar vetë veten", në të vërtetë thot nji mendim koincident me ate t'autorit të Luftës e paqës, simbas të cilit Hamleti asht fonograf i autorit të vet. Mirëpo, derisa i dyti me këte çvleftëson kualitetet e tij, sepse donte që fytyrat letrare të flasin me filosofinë e vet kryekëput e jo kurrë me t'autorit, Noli asht i mendimit se krijuesi mund t'ia falë ideologjinë e vet sajimit të vet. Së këndejmi s'nguron ta çojë aq lart Shekspirin.

„Mbas të gjithavet, jam i mendimit se tragjeditë e Shekspirit shprehin ndjenjën subjektive dhe përvojën e mbrendshme shpirtnore. Disa shkrimtarëve iu shkonte përdore të ndajnë n'oda të veçanta jetën dhe krijimtarinë e tyne. E disa të tjerë, mendoj shumica e ma të mëdhejvet, s'mund ta bajshin këte kurrsesi. Dante dhe Miltoni s'janë mëdyshë të çfaqin n'ep dashuninë dhe urrejtjen e tyne. Gëte olimpik asht autobiografik që prej fillimit e deri në mbarim. Sa çuditshëm jeta e gjenive të ndryshëm siç janë Vordsvort, Betoven e Dostojevski e ndriçon veprën e tyne. Kits s'përkon fare me mësimin mbi depersonalizimin e poetit. „Jeta e njeriut me vleftë asht alegori e pandërpreme", shkruente ai; dhe shtonte, „Shekspiri bante jetë alegorije: veprat e tij janë komente të saj". Por, ai shkonte edhe krahas me atmosferën e kohës", shton në fund Dover Vilson, tue spiegue krijimtarinë e gjenive ma të mëdhej të letërsisë e muzikës me akcenti-

min e anës subjektive, por tue mos mohue, anipse disi si me dhunë, as ate historike-shoqnore. Citova rreshtat e sipërmë për arsye se në disa pikëpamje kanë të bajnë edhe me Nolin: së pari, pse edhe ai fut dashuninë dhe urrejtjen e vet në krijimtari; e dyta, pse nji metode përafërsisht të tillë, ndonëse tue theksue reflektimin e atmosferës së kohës në veprën e tij, ai e spiegoi edhe muzikën e Betovenit; dhe e treta, pse tue pranue identifikimin e autorit me fytyrën e sajueme, ai nuk asht ekskluziv, por pranon dhe hulumton edhe gjendjen sociale-shoqnore të kohës. Due të them se kritika e tij na paraqitet e kompletumeme dhe asht e afërt me disa pikëpamje të sodit estetike-letrare.

Të gjitha luhatjet, mëdyshjet, brengosjet dhe komplekset e Hamletit, Noli i spiegon me kuptimin historik-shoqnor kur thot se ai asht njeri i posazgjuem nga errësija mesjetare, porse akoma i paaftë të rroket në vallen e progresit të shpejtë të kohës së re. Përmbysja graduale e feudalizmit dhe ngjallja e kapitalizmit shkaktojnë kontradikta në mendimet dhe veprimet e njerëzvet. Dhe, nji periodë të tillë kalimtare e përshkon nji pesimizëm ose skepticizëm, poashtu kalimtar. Së këndejmi edhe Hamleti, simbas spiegimit të Nolit, nuk asht njeri pasiv por, përkundrazi, asht aktiv, madje shum aktiv, e aktiviteti i tij lidhet me ndërgjegjën e zgjueme të Përlindjes. Kësisoji, ai zen reflekset ma pozitive të fytyravet, sepse edhe metoda e tij asht në pajtim me natyrën e tij revolucionare, asht shprehje e saj. Nëse bahet nji përqasje ndërmjet spiegimeve ma të reja të vepravet të Shekspirit dhe mendimevet të kritikut të parë shqiptar për to, do të shihet se ca konstatime të tij janë rezultat i vizionit të tij real. Ai shkruen se vrasja e diktatorëvet ndryshe trajtohej në Romën e vjetër e Greqinë antike, e ndryshe kundrohej nga bashkëkohanikët e Shekspirit, çka implikon edhe dialektikën e valorizimit që jep kritiku, mvarësisht nga koha. Kështu, kur merr ta spiegojë Hamletin, pikësëpari synon t'i zbërthejë kushtet kur u krijue ai dhe e ven në fokusin e dritës së momentit të vet temporal.

Tue përtrollisë tezën mbi pasivitetin e Hamletit, Noli kap çashtjen e mëdyshjeve të tij, me të cilën janë kacafytë pothuej të gjithë studjuesit e kësaj vepre. Dhe, përkundër shumicës, ai thot shkoqun se bukurija e tij konsiston në veprimin e tij — veprimin moral,

ngulmon ai me të drejtë. Sepse, „ajo që ia bën shituatën më të zorshime dhe më të koklavitur është ndërgjegjësia e tij", thot dhe shton: „I bie erë (Hamleti — RQ) që në krye që vdekja e t'atit nuk ishte natyrale, po do prova të gjalla dhe të shigurta". E këto prova ai i kërkon për të plotësue kërkesat e ndërgjegjës.

Tue hudhë poshtë mendimet simbas të cilavet hamletizmi asht ose „persiatje e thatë", ose „mëdyshje e sëmunë", ose „pesimizëm shopenhauerist", ose „dobësi e vullnetit të njeriut përpara detyrës që ka " (Gete), ose „kundërshtim ndërmjet fjalës dhe veprës" (Juzovski), ose „ndërmjet imagjinatës dhe realitetit" (Morozov), Klajn nxjerr këtë definicion: hamletizmi asht „ngurim para akcionit i njeriut aktiv gjithnji deri që të bindet se veprimi nuk do t'i dalë krim; asht ngurim dërmues dhe cfilitës, sepse këtij njeriu vetëm veprimi mund t'i sjellë qetsim, liri, shpëtim". Që të dy këto elemente — ndërgjegjën dhe veprimin — rreth të cilavet ndërton tezën e vet ky shekspirolog, i shoshit edhe Noli dhe, ndonëse nuk merr si të vetmen bazë të çfletimit të natyrës komplekse të Hamletit, mëdyshjen e tij e spiegon si pasojë të ndërgjegjës dhe lektisjes që të bindet se ka të drejtë. E ndërgjegjës Noli i ven nji akcent të fuqishëm në tanë krijimtarinë. Revolucionari-moralist, tue analizue fytyrat e tjera të tragjedisë nuk e len pa i vu theksin edhenjiherë të mirës në plymin e të këqijavet dhe fjala e tij e fundit për Hamletin asht se lexuesi i kësaj tragjedije mund të ngushllohet mbasi „paska në botë shokë dhe miq gjer në vdekje si Horati" sepse, ky vorfnjak i hyn në hatër me virtytin e tij të lartë të besnikërisë dhe me kompletimin etik. Ai që i shërben të drejtës dhe të vërtetës i shërben progresit — kjo do t'ishte nji nga porositë e kritikut në këtë introduktë të thukët.

Në fazën e dytë të kritikës së Nolit hyjnë edhe introduktat që ua shkroi veprave të Khajamit, Servantesit dhe Ibzenit. Këtu çohet malamal pezmi i tij kundër kapitalistëvet, aristokratëvet, tiranëvet e borgjezëvet që vjedhin e rjepin, si shprehet vetë, popullin e gjorë. Kryeprotagonistin e veprës s'Ibzenit e nxjerr — socialist, obligarkist — antidemokratik, individualist e anarkist, evollucionist antidogmatik, antikristianik, altruist, mesianist-mistik, sepse në të sheh sintezën e të gjitha idevet e kundërthanievet të shekullit të nandëmbëdhjetë. Edhepse autorin e pëlqen pse stig-

matizon moralin dekadent borgjez, si artist nuk len pa vu në spikamë edhe strukturën e arkitektonikën e veprës së tij. Gjithnji, pra, ideologu çfaqet edhe si artist i kritikës. Mund të shtrohet pyetja: ç'e shtyu Nolin të përkthejë Armikun e popullit që në përqasje me disa drama të tjera t'Ibzenit (me Norën, bie fjala), asht hap i vogël mbrapa, kurse kredoja e kryeprotagonistit: „Burri më i fortë i botës ësht' ay që qëndron më i vetëm" nuk mund t'i plotësojë kërkesat e kritikut, i cili dënon individualistët dhe të gjithë ata që prihen nga egoizmi? S'do mend se i pëlqen toni luftarak i dramës dhe ndonëse në të nuk gjen zgjidhjen, çka ai nuk kërkon kurrkund prej artistit, së paku zbulon ngulmëninë që t'arrihet doemos ideali. Edhepse Stokmani, simbas mendimit të tij, nuk ka nji ideologji të caktueme, ai shkruen zjarrtë për te, tamam për hir t'optimizmit dhe shpresës që tregohet aty ndaj ardhmënisë. E ajo që e kërkon ky ma së shumti asht demaskimi i shoqnisë borgjeze të cilën e njollos dhe e kurishton ma zi se vetë Ibzeni. Toni luftarak i veprave të këtij norvegjezi të famshëm asht elementi që josh Nolin. Kërkesa që shoqnija borgjeze të përmbyset „se është' e pamundur të ndreqet me ato baza që ka", të përmbyset jo me anë reformash po „me luftë në tërë vijën" — ja për çka i vihet përkthimit të kësaj vepre.

Në fazën e dytë të krijimtarisë së Nolit si kritik bie në sy simpatija e tij e thellë ndaj njerëzvet stoikë e revolucionarë. Gjithashtu, ndër përgëdheltarët e tij ka edhe ateistë. Këto e provojnë faktet që sjell vetë. Por, që t'u gjindet nji bazë konkrete pohimeve të tilla duhet marrë para sysh disa konstatime të tij nga punimi shkencor kritik Betoveni dhe Revolucioni francez (prej të cilit pata në dorë vetëm pjesën e katërtë), që shënon fazën e tretë dhe të fundit të krijimtarisë së tij.

Kurrkund ma rrast se sa në kët studim nuk shihet Noli kritik, muziktar, sociolog, poliglot, portretist — Noli polihistorian. Tue ia dhanë tatëpjetën tezës së Vensan d'Endit, simbas së cilës Betoveni ishte nji katolik të cilit s'i bani farë përshtypje Revolucioni francez, Noli e plotëson dhe e korigjon edhe tezën pohore të Romen Rolanit. Kur flet për kompozitorin ma të madh të mbarë njerëzimit Noli e nxjerr ateist. Të njajtën gja e bante përpara për Khajamin. Por, përse e ban këte? Si duket, ai pandeh se revolucionariteti

dhe ateizmi janë bindje që s'ndahen njana prej tjetrës. Njeriu që rebelohet nuk ka beson fetishevet, përkundrazi, i përtrollis. E, për të qenë i tillë, revolucionar, s'lypset tjetër përpos vetivet të njeriut të vërtetë, të rëndomtë. Së këndejmi edhe Betovenin — revolucionar, republikan, stoik, ateist nuk e kundron si hero, si legjendë, por si njeri të përditshëm, të zakonshëm. Mitet dhe fetishet i krijon imagjinata e njeriut, e ma shpesh i krijon turma; realiteti s'ka të bajë me to. Dhe, tue zbulue virtytet e nalta morale e njerëzore të kompozitorit, s'nguron të zbulojë edhe veset e tij. Në këtë mënyrë e nxjerr: sarhosh, të dërmuem prej sëmundjesh të ndryshme, të shurdhë; herë pesimist, herë gazmor, herë të bezdisshëm për tanë rrethin e tij, herë gjeni e herë fëmi. Ja kështu e zbret at njeri nga froni i perëndisë dhe ua qas njerëzvet. E shi këtu konsiston vlefta ma e madhe e studimit të Nolit. Kështu revolucionari Nol ua prezentoi qytetarëve të botës revolucionarin dhe republikanin e tyne të fetishizuem. Merita tjetër e tij e madhe asht pse ua ktheu njerëzve përparimtarë të botës at shëmbëlltyrë progresive të kulturës njerëzore. E këte nuk e ban vetëm për arsye se atij taborri i takon edhe vetë, apo për arsye se dëshiron ta zgjanojë shoqninë e tij edhe me nji gjeni. Këte e ban që ta kthejë të vërtetën aty ku e ka vendin.

Betoveni mbahej mbinjeri nga studjuesit e tij. Fan Noli e ban njeri. Prandej, mund të bahet pyetja: cili asht qëndrimi i tij ndaj mbinjeriut, që e përmend në nji poezi të veten. Përgjegjen e saktë e jep studimi mbi Betovenin; madje, jo vetëm mendimet e tij të çfaquna në lidhje me këtë problem, por ma bindshëm vetë mënyra se si ai e uli kompozitorin e çuditshëm nga piedestali hyjnor dhe e çfletoi hollë-hollë botën e tij shpirtnore dhe shoqnore. Kësisoji, Noli tregon se njeri i thonë edhe atij që ban mrekulli n'arte, në shoqni, në histori — mbinjeri s'ka.

Tue shkrue për pikëpamjet e Betovenit ndaj religjionit, ai pohon se ishte ateist. Si bir i Revolucionit francez nuk mund të duronte të jetonte i determinuem nga nji fuqi absolute. Mendja e tij s'mund t'i duronte prangat. Tue çfaqë mendimin se ishte stoik, sjell si argument vetë fjalët e tij: „Unë do ta rrok për gryke Fatin dhe nuk do ta lë të më vërë poshtë". „Tani Betoveni është në rrugë të drejtë", e komenton Noli mendimin e tij. Shihet qartë se Noli i don njerë-

zit stoikë: Brutin, Horatin, Plutarkun, Khajamin dhe tani Betovenin. Sigurisht i adhuron për shkak se: „Stoicizmi i vjetër ka qenë n'esencë ateist, sepse në një gjithësi deterministike të qeverisur prej ligjeve të papërkulshëm nuk ka vend për Jupiterin. Është e vërtetë se stoikët e lejonin Jupiterin të qëndronte në Olimp, po atje duhej të rrinte urtë dhe kjo ishte më e keqe se vetë vdekja për atë plak të braktisur të Rrufeve". Nga këta rreshta shihet se si e spiegonte ai zanafillën e stoicizmit si filosofi, por duket se edhe vetë asht i bindun për determinizmin e njeriut nga ligjet e natyrës që nuk i përkulen asnji fuqije tjetër dhe „s'ndryshohen me lutje të kota as me mallkime". Këtij qëndrimi i thonë ateizëm. Ma tutje Noli s'përton t'i bajë me dije lexuesit e vet se Betoveni nuk donte të pranonte priftin para vdekjes, porse tekefundit këtë e bani për hatër të nipit, nga i cili gjyqi kishte provue ta shkoqte disa herë përpara nën pretekstin se ateisti nuk mund t'edukojë fëminë. Mirëpo, tue regëti, kompozitori shqiptoi fjalët: „Plaudite, amici, comoedia finita est!" Edhe — njiherë mund të shtrohet pyetja: përse Noli i akcenton këto çashtje? Po mos t'i pëlqejshin, do t'i heshtte. Prifti të flasë aq shpesh dhe aq me admirim për Betovenin ateist, për Khajamin ateist! Unë s'besoj kurrë se Fan Noli ishte ma i devotshëm se Betoveni.

Kompozitori i Simfonisë së nandë ishte kosmopolit dhe kritiku citon fjalët e tij. „Nënshtrimi i njeriut nga njeriu më prish gjakun", që e lidhin asociativisht me mendimin e Kantit: „Më ngjethet mishtë kur mendoj skllevërinë". Por, ai kishte edhe disa mendime ma të qarta. „(Betoveni) mendon se duhet të ketë një Byro të Artit në botë në të cilën artisti duhet të dorëzojë krijimet e tij artistike dhe të marrë ato që i nevojiten dhe kjo tingllon si socializmë". Ja këto fjalë të citueme të kompozitorit të madh gjerman ia përkujtojnë Nolit socializmin dhe ai e don muzikën e tij jo vetëm për shkak të bukurisë madhështore të saj, por edhe për shkak të botëkuptimeve progresive të tij. E tanë krijimtarija e përkthyesit të famshëm të Shekspirit asht e brumosun nga nji ndjenjë e tillë. Ai shkroi për Khajamin, Servantesin, Shekspirin, Betovenin pse në ta gjeti vizionarët e mëdhej të njerëzimit, pse në ta gjeti veten.

Kritikat e Nolit janë të shkrueme me nji gjuhë laryshi plot. Ai që lexon njiherë diçka prej tij, herën

tjetër, teksa të shqiptojë fjalinë e parë do të dijë se lexon po at njeri. Sepse, ai ka stilin e vet, stilin që i thonë nolian dhe që s'mund t'imitohet prej askujt tjetër. E ky asht nji argument tjetër që provon se sa i madh ishte. Gjuha e tij asht e pasun dhe s'mund të gjindet fjalë që s'i përgjigjet idesë së paramendueme. Ndonëse përdor disa fjalë dhe shprehje të hueja edhe kur mund t'i gjejë në shqipet, mbarështrimin e fjalisë, sintaktikisht e ka të drejtë dhe në natyrën e gjuhës shqipe. Ndërkaq, fjalët e hueja i përdor ma tepër për shkak se iu përgjigjen nyancavet shpirtnore dhe mendore të tij. Ka disa pasazhe n'introduktat e tij siç asht ky, bie fjala: „Vllaj vret të vllanë dhe i rrëmben të shoqen; e ëma mëndje-lehtë martohet me vrasësin e t'atit; i ungji vrasës uzurpon fronin e të nipit; e dashura e tij e padjallëzuar, pa ditur e pa dashur, vihet në shërbim të uzurpatorit që t'a spiunonjë! miqtë dhe shokët e djalërisë i vënë gracka dhe pusira; populli i falet një mbreti kriminal; ësht' i vetëm, i neveritur dhe i përgjuar prej të gjithëve...", ku ritmi i fjalive të pamvaruna asht i njajtë, gradacioni i mendimit vjen tue u shtue, kurse konkretizimi i atmosferës fiton intensitetin e vet. Përgjithësisht tensioni i fjalive të tij asht i naltë, çkafit i ndihmon edhe mjeshtëria e përdorimit t'interpunkcionit. Me stilin e vet Noli ban mrekulli. Aq asht i rrëmbyeshëm, i pakursyem në shfrymjen e ndjenjavet, derdhjen e pezmit atje ku vret sarkazma e tij. Porse, fuqija e emocionit kurrë nuk ia porrit fuqinë dhe thellësinë e mendimit. E vërteta që hulumton ai kurrë nuk bie viktimë e hirit të botës intime. Ai e kërkon ate me mend, tue shtrue përdhe me argumente të gjitha pengesat dhe gënjeshtrat. Si kritik asht realist objektiv. Stili i tij asht në pajtim me natyrën e tij: revolucionar në shpirt, revolucionar në shprehje — revolucionar në kërkimin e të vërtetës. Ata që studjojnë ideologjinë e tij doemos duhet të kenë parasysh edhe stilin e tij — si të prozës ashtu edhe të poezisë. Fjalët e tij janë kumbonjëse, poezija e tij asht revolucionare edhe përkah akustika e saj, ashtu siç ishte e tillë muzika buçitëse e Betovenit. Ma s'dyshohet se stil asht njeriu vetë, porse mund të jetë edhe anasjelltas. Tani mund t'i kthehemi mendimit të parë: perënditë e mbërthyen Prometheun njiherë e përgjithmonë, por zjarri u mbet njerëzvet; Nolin e dënuen kundërshtarët, por vepra e tij u mbet atyne që deshti ai.

„Njeriu s'mund të thotë: — Due të shkruej poezi! . Këte s'mund ta thotë as poeti ma i madh; sepse, kur krijon shpirti i njeriut i shëmbëllen prushit që vjen tue u porritë por që njifarë ndikese e padukshme, si ndonji puhi kaluese, e përpush deri në shkëlqëm". Kështu shkruente Sheli para nja njiqind e pesëdhetë vjetësh, e kështu e trajtojshin procesin e kreacionit edhe shum e shum poetë e mendimtarë të mëdhej të të gjitha kohëvet. Por, shekulli ynë me bijt e vet të prirun për mohimin e autoriteteve provoi të përtrolliste edhe këtë mendim të çfaqun në trajtë apologjije të poezisë. Megjithate, as këta ithtarë të flakët të punës së kabinetit, e as stilisti Parandovski s'mund t'ia mbushin kujt mendjen se nji çast i tillë i brambullimit t'imagjinatës, që e pason përjetimin e pasionueshëm të realitetit, nuk luen rolin e vet në krijimin e poezisë. Psikologjija moderne i kurishton pohimet e atilla.

S'nevojiten bredhje mbas mendimeve të klasikëve të letërsisë së përbotëshme, e as mbas miteve të kohëve të lashta. Ligjet dhe aksiomat shkencore janë ba shum relative, e lene ma vlefta dhe kuptimi i mitit mbi Orfeun, i cili me bukurinë magjike të zanit dhe fjalëve bani të këllehen demonët; apo i legjendës mbi plakun me harfë në dorë, nga lotët e të cilit u sajuen vargjet poetike. Në këtë kohë relativiteti të formulimeve estetike, poezija mbrohet me njimendësinë e nji të vërtete: ajo asht arti ma intim. Asht ma intime edhe se muzika. Kompozitori shpreh botën e tij të mbrendshme me anën e mjeteve muzikore, kurse poeti mjet

shprehje ka fjalën, e cila vishet edhe me elementet e muzikës — me ritëm, melodi, rimë, tonikë, e të tjera. Muzikën e kap njeriu me shqisën e të ndëgjuemit, e poezinë me të ndëgjuemit dhe të të pamunit. Krijimtarija poetike asht nji rrëfim subjektiv për realitetin dhe çfaqjet e tij të shumnduershme, që janë filtrue nëpër vetëdijen e poetit. Së këndejmi fund e krye e përshkon toni intim, i cili asht i pasionuem a indiferent, i zjarrtë a i ftohët, mvarësisht nga fryzimi, shija dhe mjeshtrija e të shprehunit. Frymzimi i fuqishëm, i sinqertë dhe objektiv, që përcillet edhe me limosjen e mendimeve e fjalëvet sjell sajime vlere të naltë artistike. Flaka e fjalës së thanun në poezi asht elementi i pavdekshëm i saj; me komponentën racionale-refleksive ajo i afrohet përsosmënisë, pas së cilës lektiset secili krijues. Poezija botënore ruen si vlera të përjetshme ato vepra të poezisë, të cilat janë të përshkueme nga lava e ndjenjave dhe plotnija meditative, e kurrsesi laryshinë retorike, që maskohet me stolitë formale të strukturës, si e vetmja dominante kualitative e saj.

Poezija e pavdekshme, ajo poezi e cila i reziston rrëmujës së kohës, në të vërtetë asht poezi e frymzimeve nga jeta, poezi e elementit të ngahershëm n'art: e kuptimit dhe hulumtimit të kuptimit t'ekzistencës së qenies njerëzore me të gjitha manifestimet e saj të ndërlikueme në natyrë dhe shoqni. Asht vështirë të pranohet se mjafton mbyllja ndërmjet katër muresh për të krijue poezi; edhe talentit ma të madh i duhet kontakti inspirativ, përvoja. E frymzimi i poetit asht refleks i mbrendshëm, i shpirtit, refleks i shkaktuem nga kontakti ndërmjet botës së jashtme dhe botës së tij intime — frymzimi asht poezi. Aty ku poetit i shkaktohet ai refleks shkrep edhe xixa që e ndriçon qenien e tij të sinqertë për të derdhë akordet e shpirtit me bukuri të vërtetë.

Frymzimi s'asht hyjnor sikundër thojshin Dante e Petrarka, as demonik sikundër thonte **Gete**, porse asht element jetësor i përjetuem prej s'afërmi a prej së largu, asht jeta vetë. Frymzimi asht dridhje e të gjitha indeve të qenies njerëzore, shkaktue nga reflektimi i dukunive të botës objektive në botën e subjektit. Pasioni vullkanik që përcjell frymzimin, e që e përshkon fjalën magjike të tij, asht ai element i amshueshëm i poezisë, i cili këtë gjini të krijimtarisë e ban art të shpirtit të njeriut. Poezinë e tij ma të bukur

Gete e shkroi në moshën shtatëdhjetëvjecare, sepse poeti — plak n'at moshë ishte dashunue; Petrarka të magjeps me fuqinë e poezisë së vet pikërisht në vargjet kushtue dashunisë së tij fatale; Pushkini asht virtuoz në vargjet kushtue fatit tragjik të poetit Lenski, që në realitet asht parandjenjë e çuditshme e fatit tragjik të vetë autorit; e Lermontovi asht ngaherë aktual me vargjet që ia kushtoi vdekjes tragjike të Pushkinit, shi pse bazë e tyne ishte inspirimi. Edhe Gete, edhe Petrarka, edhe Pushkini, edhe Lermontovi janë shprehë me intuitë e pathos të naltë poetik mu në çastin kur shpirti i tyne ishte pushtue nga impulset e jetës, që në këto rast i thonë inspirim.

Pesha e ndjenjës së pashfryme asht e randë. Frymzimi cyt ndjenja, porse jo aso çfarë i çfaqen çdokujt e çdoherë, veç ndjenja të rrëmbyeshme, të cilat, po s'u shprehen, zharisin qenien e poetit. Poezija e krijueme në nji kësi çasti asht ajo që të magjeps dhe të tingëllon në shpirt porsi ndonji formulë magjike së cilës s'mund t'i largohesh. Ajo asht e thanun me fjalë të kristalta, me stil lapidar, me mendime të thella dhe me muzikalitet e freski të rrallë. Në nji çast të tillë duket tanë qenia e poetit, meqë poezija asht arti nëpërmjet të të cilit shprehet ma së miri shpirti, karakteri dhe intelekti i krijuesit. Ja, pra, ku e kemi elementin fundamental të poezisë — intimitetin. E ky element merr krahë dhe derdhet me fuqi posaçërisht sugjestive, magjepse, vetëm kur për bazë ka inspirimin.

Tue shkrue për poezinë, Vordsvort thot se ajo nuk derdh lotë „çfarë derdhin engjujt", por lotë të natyrshëm dhe njerëzorë. Nëse lotët e gëzimi s'i shkaktojnë vargjet dhe anasjelltas, ato që i shkakton indiferenca, plogështija shpirtnore, s'do të jenë poezi. Pikllim a gëzim mund të na nxjerrë edhe ndonji përjetim i trajtuem nga tjetri, porse në këso rase frymzimi ynë do të jetë i transponume artificialisht, do të jetë i shartuem dhe, sikundër bima e kopshtarit të pavirgjëlltë, do të japë frytin gjysmak. Do të thotë, pra, se poeti frymzohet në gurrat e jetës. Aty ku fatet njerëzore gërshetohen, mvaren e kushtësohen reciprokisht. tue i vu vulën e vet kohës dhe momentit historik. Në këtë drejtim mund të konstatohet se poezija, sikurse edhe çdo art tjetër, asht e lidhun ngushtë me jetën dhe ngado ardhshin frymzimet dhe ndikimet e ndonji poeti, ai me kuptimin e tij temporal dhe histo-

rik do t'i kthehet kohës dhe ambientit — sepse, siç thot Bjelinski, s'ka krijim artistik që të mos jetë me njiqind fije të vetat i lidhun rrast me kohën dhe rrethin e krijuesit.

*

U tha ma sipër se poezija e frymzueme flet me fjalë magjike, sepse çfleton besnikërisht botën e mbrendshme të njeriut — poetit, tue vu në spikamë njikohësisht edhe qëndrimin e tij ndaj realitetit. Pikërisht pse kontakti i saj dhe lexuesit krijohet nëpërmjet të fjalës së frymzueme nga dukunitë dhe çfaqjet e jetës, ajo komunikon me te tue përcjellë kuptimin e vet shi me flakën e shprehjes. Frymzimi si zanafillë bahet edhe pasojë. Nji shkrimtar francez, thot: „romani asht pasqyrë që shetit rrugëvet". Ndërkaq për poezinë e frymzueme, poezinë që të frymzon, mund të thuhet se asht pasqyrë që shetit shpirtin. Ajo të ban për vete dhe të ngjall asociacione të shumnduershme...

Persiatjet e masipërme janë të cytuna nga kontakti me poezinë e Esad Mekulit: *„Kush i pari i bani..."* Kjo poezi, e shkrueme me nji intuitë të fuqishme, me sinqeritet fjale e bukuri shprehje, shquhet përkah intesiteti i ndjenjës dhe vërtetësija e frymzimit, përkah kuptimi i naltë social, moral e njerëzor, përkah domethania e fuqishme shoqnore. Esad Mekuli shquhet në te edhe si portretist, edhe si psikolog, edhe si sociolog, por mbi të gjitha asht humanist i pashoq. Ajo asht dëshmi e pavdekshme dhe përhera kumbuese e nji kohe. Përkah timbri i saj i dhimbshëm, por edhe përkah tanësija artistike, kjo poezi me poemën e Migjenit janë dy kryevepra të pashoqe të letërsisë shqipe. Kuptimi i thellë i çdo vargu të thadruem dëshmon talentin e nji krijuesi të cilin e shquen aftësija e depërtimit në regjionet ma të fshehta të psiqikës së njeriut dhe solidarsija e përdëllimi me çdo qenie të kësaj bote që s'e gëzon hatrin e fatit. Kjo poezi nuk asht e stolisun me kush e di se sa e çfarë figurash stilistike, nuk asht si vashat e kapardisuna me fustan e toaletë moderne, nuk ka theks as ton nostalgjik (të përkujtojmë se shum poetë janë kredhë në njifarë sentimentalizmi me rastin e shtjellimit të motiveve asisoji) — do të thotë i mungojnë të gjitha rekuizitat që u shërbejnë poetëvet fjalambël, të cilët, në vend se me dome-

thanien e vargut e kuptimin e përgjithshëm të poezisë, orvaten ta magjepsin lexuesin me stolitë e jashtme. Mirëpo, kjo poezi ka diçka tjetër që të rrëmben me mish e me shpirt e të ban rob të dirdhjeve të vargut të saj — ka nji spontanitet poetik, nji frymzim të çiltërtë e të kulluet që derdhet në katër pjesë e katër faqe libri, thuese nji fjalë ma pak do ta gjymtonte e nji ma shum do ta zgjatte pa fije nevoje. Tanësisë së kësaj poezije, dendësisë së saj, s'mund t'i bahen kurrfarë vërejtjesh. Forma e saj e ngërthen plotësisht landën, si do të shpreheshin Voren e Velek. Integraliteti i saj mbyllet tamam kur duhet dhe ku duhet. Kur mendon njeriu se si i fanitet aq vizuelisht atmosfera e paraqitun në te, s'mëdyshet të përfundojë se duhet të jetë e shkrueme nën presionin e inspirimit të fuqishëm nga realiteti.

Porse, të shohim në çka konsistojnë kualitetet e pamohueshme dhe të nalta të kësaj poezije t'Esad Mekulit. Analiza jashtëzakonisht e hollë psikologjike e qenies njerëzore, në këto rast e kurbetçiut, lidhja e qëllueme, e bukur, që mund ta arrijë vetëm intuita e talentit të fuqishëm, e asaj krijese dhe elementit social me elementin e natyrës, ban të harrohen kufijt artistikë dhe t'i kushtohet tanë vëmendja vleftës fundamentale të saj — kuptimit t'ekzistencës së nji krijese njerëzore, kurbetçiut. Askund ma bukur se në këto poezi nuk shihet aq dendun ndikimi fatal i vrazhdësisë s'elementeve të natyrës, lidhë me vrazhdësinë e të qenmes së njeriut në nji periodë e kushte të caktueme historike. Nji vitalitet të tillë e kanë n'esencën e vet shumica e poezive të këtij poeti origjinal të letërsisë shqipe. Optimizmi dhe vullneti i pashuem deri në fund, dashunija ndaj jetës, ndaj vetes, ndaj të vetëve që mvaren prej tij — ndaj njeriut dhe totalitetit të tij, edhepse ai nuk asht i përgëdhelun në gjiun e rruzullit, optimizmi i papërridhun i kurbetçiut, i cili s'porritet as me rasën e finales tragjike, porse jehon buçitshëm në horizontin e tij, shpreh stoicizmin e portretit të kësaj poezije, të regjun në valët e përpjekjeve për ekzistencë. U theksue se materia poetike këtu ka gjetë shprehjen e duhun. Kjo faktohet që prej elementeve themelore të saj.

„Retë hijeranda", „qiella si çerep i zi", „shiu me pika si plumbi" — janë ato elementet natyrore të natës së lemeritshme kur „kujisin bagllamat e ndryshkuna në kapakët e dritareve..." të „dhomzës s'errët plot

myk", ku pranë nji drite të venitun e kalojnë natën kurbetçitë „t'rrasun fishek". Natës së tillë që në vetëdijen e subjektit ngjall asociacione llahtari plot i bashkohen elementet akustike që e plotësojnë përbukuri atmosferën, tue shtue gradacionin e tmerit të natës. „... Diku nji za i piklluem, si ai i nanës mbi kufomën e birit të vdekun", „frushkullon erë e furishme", „lebetisin kunorat e pemëve" — janë ca nga elementet akustike që përcjellin at natë dërmimi shpirtnor, që n'imagjinatën tonë reflektohet si stuhija e oqeanit të paskajshëm në shpirtin e detarëve të tretun. Në fund të këtyne kuptimeve, kur intensiteti i llahtarisë që e shkakton terri i natës asht mjaft i naltë, vjen e lidhet përmrekulli ideja e ferrit. Vetë fjalët: hijeranda, si plumbi, kujisin, e furishme, e çame, lebetisin, frushkullon, ferri e të tjera, shprehin kuptime të zymta, sterrë, shprehin nji atmosferë të randë, pothuej të paduruershme — me nji fjalë janë ide kuptimesh skëterrike. Kuptimi dhe tonika e tyne janë në harmoni të plotë me idenë e përgjithshme që përcillet nëpërmjet të tanësisë së poezisë. Ato në nji mënyrë ingjenioze janë zgjedhë për të shprehë nji atmosferë karakteristike të nji kohe dhe nji ambienti, dhe si të tilla reflektohen me efekt të furishëm në vetëdijen e lexuesit, tue i sjellë në shpirt asociacione të randa. Njikohësisht ato edhe vizuelizohen.

Kjo ishte *Nata* dhe, njiherësh, pjesa e parë e poezisë në shqyrtim.

Pjesa e dytë — *Mëngjezi* — sakaq nis me „re të purpurta" dhe „me vesë e puhi". Me t'aguem zhdavaritet terri dhe nji pikë optimizëm prek edhe zemrën e kurbetçiut, por vetëm nji pikë, sepse mbas aso nate qenia njerëzore asht larg haresë dhe gëzimevet, anipse shpresa për jetë, kjo gënjeshtare me ngjyra si t'ylberit, s'i shuhet. Pesha e natës prore asht ma e randë, ma e llahatarshme dhe ma fatale se sa e ditës. Dhe kjo peshë e gulshon shpirtin e tij, jo pse ka kalue nji natë tmeri, por pse edhe ky mëngjes sjell përsëritjen e bredhjeve mbas punës e bukës, sjell përulje e përbuzje — këto kontraste ma të shëmtueta në shoqninë njerëzore, peshën e të cilavet e di vetëm ai që mund t'i ketë shijue në nuancat e tyne të neveritshme. Edhe ky mëngjes asht fillim i djersës dhe gjakut që do të derdhet dhe ta plyrë trupin dhe shpirtin e kurbetçit n'orvatjet e tij për ekzistencën vetiake dhe të buzëvet

që e presin dikund larg, plot lektisje e mall, plot brenga, mjerim e skamje. Së këndejmi edhe kurbetçiut: „... vetëm nganjiherë, n'mbrendi, botnat e reja i vetojnë hareshëm..." dhe i çelen përpara horizonte të reja se „bukë do të ketë... dhe punë..." Por vetëm ngandonjiherë, meqë horizonti i tij dhe shpresa mashtruese me të cilën i kalojnë ditët ngryset ngase asht i vetëdijshëm se sikundër mëngjezi i sodit janë edhe mëngjezet e tjera.

Në dy pjesët e para, si u pa, asht dhanë atmosfera e jetës së kurbetçiut, me akcentin mbi elementet e jashtme t'ambientit ku jeton ai, apo ma mirë thanë nga bredh e vdjerr ditët kurbetçiu. Ndërkaq, në pjesën e tretë ai konkretizohet: jipet portreti i tij. Me disa vija të jashtme, vija që ia ka dhurue natyra, nga nji anë, dhe vija që ia ka „dhurue" nevoja, jeta e merdostë, nga ana tjetër, fitojmë përfytyrimin edhe për mbrendinë e tij, për tanë subjektin e tij. Sa bukur! Përse të zbërthehen detajet dhe nuancat periferike, kur veglat që ka në dorë dhe krahaqafë ai e cilësojnë mrekullishëm. Mjeti i punës e emërton të gjorin dhe në këtë mes i thonë sharraxhi, njeri që shendet rrugëvet dhe — i tanë sy e veshë — pret mos po i thot kush — eja! Portreti i tij asht aq i natyrshëm, aq origjinal, sa që të përkujton menjiherë tanë çiltërinë, por edhe vrazhdësinë e natyrës. Ai të tregon se si krahas shpirtit, natyra e egër di t'i çelë hullija njeriut edhe në pamje. Kështu kurbetçiu bahet nji simbolikë nëpërmjet të të cilës shprehen shkaqet dhe pasojat e kushteve dhe kohës. Ai në të vërtetë asht vetëm nji pjesë periferike e totalitetit shoqnor, porse në të cilën si në ndonji pikë gati statike përmblidhen reflektimet e atyne kushteve, tue shprehë efektin e vet. Suptiliteti poetik i autorit në këtë mes ka tregue tanë tensionin e ndjenjës dhe mendjes së vet.

Në pjesën e katërt finalja imponohet vetëvetiu, porse ma parë, mbas shum netsh e ditsh të tilla edhe portreti ndryshon: në sy i ngulet frika, fytyra i merr ngjyrë shafrani, zhubravittet, flokët i shprishen, buzët i mbushen shkrum — përfundimi asht afër. Rëndom rrjedhja e jetës cakton mënyrën e vdekjes. Në këtë mes përfundimi i njeriut asht ma zi se vdekja — çmendet. Finale tragjike e nji jete të dështueme, të shkatrrueme dhe të dërmueme në luftën për të qenë. Mirëpo, toni i përgjithshëm i kësaj poezije, që ecën nji vije parabolike, nuk asht ngashërues; përkundrazi,

ajo shquhet me optimizëm, me nji epsh jetese, me avenir, sepse „atje mbas 77 bjeshkëve, shtatë gojë presin..." Këto shtatë gojë (ky numër fatal i trashëgimit popullor) janë fryti i gjakut të kurbetçiut — janë pasardhësit e tij, që vazhdojnë jetën, emnin dhe gjininë e tij. Aktivizimi i njeriut s'len kurrë pa dhanë rezultatet e veta dhe këtu asht theksue me perspektivat që mbesin të hapta mbas përfundimit të poezisë. Jeta e kalueme në nji aktivitet të pareshtun asht e denjë për respekt dhe Esad Mekuli me poezinë e tij i kangëton artistikisht kësaj gjallësije vetëmohuese të njeriut prometheik.

Strukturalisht poezija *„Kush i pari bani..."* asht e mrekullueshme. S'ka fije dyshimi se asnji formë tjetër s'do ta ngjallte e konkretizonte dhe ma thellë, ma denjësisht e ma besnikërisht s'do ta shprehte mbrendinë e saj. Ideja e autorit dhe mjetet e përdoruna poetike këtu janë në harmoni të plotë. Forma të cilën ai e ka zgjedhë mvarësisht nga motivi i përgjigjet materies së sublimueme në te. Njeriu shtron pyetjen: a do të pajtohej motivi i tillë me kullandrisjen e rimës, respektivisht a do t'arrihej efekti që e ka realizue Esad Mekuli sikur t'i jipte strukturë tjetër idesë së vet? Përgjegjen pandeh se na e jep ma bindshëm nji përqasje me dy sajime të tjera poetike të letërsisë shqipe. Edhepse komparacioni në konstatimin e vleravet artistike nuk mund të sjellë prore rezultate aq të mira, nji krahasim i tillë imponohet vetëvetiu në këtë mes, po deshtëm të pikasim sikundër duhet bukurinë e poezisë *„Kush i pari bani..."* Motivin e kurbetit, që shtjellohet në varianta të ndryshme në kangët popullore, e kanë trajtue edhe Çajupi e Mjeda. Poezija e të parit mban titullin K u r b e t i, kurse e të dytit S h t e g t a r i. Mirëpo, që të dytë motivin e kurbetit e kanë nxjerrë nga baza reale, tue e lanë pezull ndërmjet të mundshmes dhe të pamundshmes. Që të dytë e kanë rimue vargun, tue i dhanë prioritet muzikalitetit dhe intonacionit të përgjithshëm të poezisë. Vallë, a mund të ketë muzikë dhe lirizëm nji motiv i tillë? ! Aso muzike çfarë i kanë dhanë dy poetët e Rilindjes kurrë. Por, muzikë që derdhet me rrshim ndjenjash, me kapërcime e ndërkëputje të papritunа çfarë ka komponue nji Berlioz — po. Rima e thadrueme dhe ritmi i përkujdesun i përshtaten nji motivi, kurse tjetrin veç mund e damtojnë. Fjala e ambël për nji kuptim që n'esencën e vet asht i vrazhdë,

ngjall ndjenjë neverije, kurse fjala që ekuilibrohet me te përkah esenca, zgjon ndjenjën e të bukurit dhe sjell përjetimin estetik. Do të thotë — motivi dikton formën. Dy poetët që u cekën iu kanë shmangë këtij parimi, së këndejmi edhe poezitë e tyne në fjalë janë „lule romantike". E, megjithate, ato poezi janë në pajtim me qëllimin e tyne. Ndërkaq, me nji ndjenjë të hollë artistike asht zgjedhë vargu i lirë për t'u shtjellue motivi i kurbetit në poezinë e Esad Mekulit. Kjo zgjedhje spontane e vargut të lirë për të shprehë nji aso materie të ndërlikueme jetësore dëshmon edhe njiherë se si impresioni i thellë mund të kthehet në shprehjet artistike, porse dëshmon edhe se sajimet ma të bukura janë ato të frymzimeve nga jeta. Përndryshe, vargu i rimuem në shtjellimin e këtij motivi do t'ia prente hovin dufit të mbrendshëm dhe do ta gjymtonte imagjinatën në të shprehunit besnik t'atij realiteti me të gjitha nuancat e tij. Struktura e kësaj poezije, që hyn ndër ma të bukurat në letërsinë shqipe, e që përgjigjet përmrekulli idesë së saj, asht poashtu dëshmija ma bindëse se procesi i krijimtarisë ka dofarë ligjesh të vetat që kanë të bajnë me nji çast, nji gjendje të poetit, me nji kontakt të papritun të botës së tij intime me realitetin. Ja këtij kontakti i thonë i n s p i r i m. Prandej edhe poezitë që shkruhen në momentin kur poetin e urdhënon zemra shquhen me at fuqinë e tyne të njomë, të sinqertë. Të gjitha këto kualitete i posedon poezija e Esad Mekulit.

Poema e Migjenit mbi mjerimin ka përafërsisht të njajtën ide; asociacionet që ngjall ajo janë mjaft të fuqishme, mirëpo, njeriu shkoqet prej saj me njifarë bindje se poeti përpiqet ta shpie në nji botë, e cila, mu për shkak t'asaj përpjekje të tij, s'duket aq e bindshme. Shihet sheshazi se Migjeni e ka kalue at masën e nevojshme në çdo art dhe rropatet t'imponohet me nji patetikë të pashoqe. Megjithate, poema e tij ka vlerën dhe kualitetin e vet të pamohueshëm. Esad Mekuli tregon nji masë jashtëzakonisht t'ekuilibrueme ndërmjet qëllimit dhe objektivitetit, së këndejmi edhe poezija e tij len mbresën e krijimeve të thella artistike. Ajo të shtrëngon të persiasish rreth kuptimit të saj dhe kuptimit të vetë jetës. Aty konsiston edhe bukurija e saj ma e madhe.

„Kush i pari bani..." nuk shkëlqen me stolisje, respektivisht farfuritjen e vet nuk e derdh me vezullime të veçueme, por me tanësinë e saj integrale. Ai që

e lexon këtë poezi e përshkojnë mornica trupit. Poezija *„Kush i pari bani..."* asht tablло e çkoqun nga jeta. Veçse asht shkrue me duf zemre ajo sjell edhe pasqyrën e vetë poetit — humanizmin, bujarinë, çiltërinë dhe bukurinë e shpirtit të tij. Ajo asht sajue me nji ekonomizim të madh fjalësh. Vargu aty-këtu shkëputet, porse intonacioni dhe gradacioni i përjetimit rritet. Në letërsinë tonë të pakta janë poezitë që kanë epitetin të qëlluem si kjo, që e konkretizon mirë e bukur idenë e fjalës së cilës i shërben, tue shtue qartësinë dhe intensitetin e ndjenjës që përcjell ajo. E shkrueme me fjalë akustike, të qëmtueme me xhelozi që ta shprehin sa ma thellë motivin, e nën presionin e inspirimit të fuqishëm nga jeta dhe e përshkueme fund e krye me nji pasion që të rrëmben me mish e me shpirt kjo poezi të bindë se kjo gjini e artit, si edhe të gjitha artet e tjera, ka qëllimin e vet ekzistues, përse njerëzit i kushtohen dhe e zhvillojnë dhe përse ua dedikojnë njerëzve të tjerë. Ajo të përkujton se hermetizmi i tepruem rrezikon vleftën e poezisë — komunikimin me njeriun, me ate prej të cilit merr materien, por edhe të cilit ia përcjell qëllimin e vet të lartë. Jeta e njeriut, e kushtësueme nga momenti historik dhe konditat shoqnore, shpesh boshllëku i kësaj jete, e shpesh edhe optimizmi me horizontet që çelen para qenies njerëzore, sepse asht prore në gjendje t'ia çel vetes — kjo asht kuintesenca e kësaj poezije njimend të mrekullishme.

*

Sot poezija ka pësue transformime ma tepër se kurrë parandej. Shekulli ynë asht shekull i krijimit dhe përmbysjes së vlerave artistike. Rruga dhe mënyra të reja të shprehjes në poezi, artistët e fjalës kërkojnë pareshtun. Njeriut i shkon mendja se të gjitha baticat dhe zbaticat e këtij shekulli vërtet të shqetsuem janë reflektue veçmas në fushën e krijimtarisë poetike. Derisa nji numër poetësh janë në gjendje të mohojnë çdo mundësi inspirimi nga jeta dhe apologjizojnë punën e kabinetit, të tjerët s'ngurojnë të pohojnë se ajo ushqehet nga impulset e fuqishme që ia sjell kontakti me njeriun e ditës. Derisa nji numër sish profetizojnë se „poezinë do ta shkruejnë të gjithë", të tjerët ruejnë bindjet e kahershme se ajo asht privi-

legjë e ndërgjegjeve ma të zgjueme të shoqnisë. Anri Misho thot se poezija „asht dhuratë e natyrës, hir e jo punë. Ambicja që të shkruhet nji poemë mjafton që të damtohet ajo (...) Dëshira asht vdekje e poezisë". Kësisoji ai pranon vetëm talentin dhe inspirimin. Porse nji aksiomë mbetet ngaherë e pamposhtun: poezija asht gjuha e parë e njeriut, ajo ka fuqi magjike, ajo çfleton mbrendinë e njeriut, shpreh vuejtjet dhe aspiratat e tij, ajo konkretizon andërrat dhe ambicjet e tij, i jep mundësi çfaqjes së sensibilitetit të tij, por, ç'asht me randësi të pamohueshme, me te hulumtohen dukunitë e objektivitetit.

Mirëpo, poezija e të gjitha kohëve ka pasë prore edhe nji qëllim të caktuem: ajo i shërbente diçkafit. Ajo sjell me vete nji porosi të caktueme: porosinë shoqnore, meqë njeriut i dedikohet. Në këtë mes ajo asht e lidhun me subjektin — intimisht, e për shoqninë — funkcionalisht. Së këndejmi s'mund t'anatemizohen inspirimi dhe dëshira në krijimtarinë poetike, njashtu siç nuk mund të përfillet as pohimi se aftësija krijuese asht vetëm „dhuratë e natyrës", meqë njeriu punon e krijon prore në mënyrë të vetëdijshme, për qëllime të caktueme, e tue punue përsoset. Due të them se poetit, që mbyllet në vete, që, si thuhet hermetizohet me ndjenjat dhe botëkuptimet e tij mbrenda nji lëvozhge (të cilën mund t'ia çelin vetëm njerëzit e rrethit të tij të ngushtë), jo sall që i kanoset rreziku të harrohet nga ata të cilëvet iu kushtohet poezija, porse ai vetë e zhduk vetëveten. Objektiviteti përjetohet me intensitet të ndryshëm: mvarësisht nga dukunitë e tij dhe afiniteti i atij që e përjeton, e poezija shi këtë refleks përjetimi ia komunikon lexuesit. Lidhë me këtë shkallë përjetimi qëndron edhe inspirimi, i cili e brambullon imagjinatën e poetit kur vijnë e lidhen ato fjalët magjike, që shquejnë poezinë e pamortshme. Njeriun e inspirojnë: lindja, jeta, vdekja, ngjarjet e ndryshme, natyra, njerëzit — e inspiron ajo që në nji çast i duket ma impresive, në të vërtetë ajo që e tundëllon botën e tij të mbrendshme. Ndonëse disa i veshin inspirimit kuptime profetizuese, mund të pohohet se poeti që krijon në nji çast të tillë fatlum i thot të vërtetat ma të mëdha dhe depërton thellë ndër dukunitë e realitetit. Ndërkaq, drejt inspirimit shpiejnë edhe kujtimet që kanë mbetë dhe ruhen në gjendje latente edhe në ndërdijën tonë. Sidoqoftë, atje ku asht ma i fuqishëm dhe ma i sinqertë mishnimi ndër-

mjet subjektit dhe realitetit, atje edhe inspirimi asht ma kreativ. Intensiteti i përceptimit e shton tensionin e përjetimit. Aty janë edhe rranjët e vlerave poetike...

Poezija e Esad Mekulit asht e brumosun me at fuqi përjetimi e shprehje. Së këndejmi ajo do të jetë prore e freskët, joshëse, aktuale. Ajo do të ketë ngaherë adhuruesit e vetë të sinqertë. Domethania e naltë njerëzore dhe integraliteti artistik e bajnë vleftë jete historike. Aty konsiston edhe multivalenca e krijimtarisë poetike të këtij poeti. Poezija e tij s'e njeh mitin e Narcisit. Ajo njeh vetëm inspirimin nga jeta, nga njeriu — bukuri ka ndjenjën e çiltërtë, e jetë humanizmin e thellë. Kështu, persiatjet rreth poezisë së tij e sjellin rishtazi në kujtesë Shelin, gjithnji at Shelin: „Njeriu, që të jetë i mirë, duhet të persiasë intensivisht; duhet të vihet në pozitë të ndonji njeriu tjetër apo të shum të tjerëvet; gëzimet dhe dhimbjet e gjinisë së tij duhet të bahen edhe të tij vetë. Imagjinata asht mjet efikas i mirësisë morale; e poezija e ndihmon qëllimin e saj tue ndikue në vetë shkakun".

SHKAQET DHE KUPTIMI I NJI TRAGJEDIJE

„Në të gjitha anët shoh vetëm hapsinën e paskajshme që më rrethon si ndonji atom, si ndonji hie që zgjat sall nji çast të pakthyeshëm. E di qartë se së shpejti më duhet të vdes, e ma së paku e njoh at vdekje së cilës s'mund t'i iku..."

(Blez Paskal: MENDIME)

Njeriu punon shekuj me radhë dhe, tue punue, ngrit e përsos jetën, intelektin dhe etikën njerëzore, krijon begati e mbushullimë materiale. Me punë i jep kuptim e bukuri jetës. Përpjekjet e tij nuk i dedikohen vetëm bashkëkohësisë, por si nji hallkë e shtueme n'orvatjet e breznive të kalueme lidhen me rropatjet e atyne që i pasojnë idealet e synimet progresive njerëzore. Këtë punë të vetën ai s'e ban veçueshëm të tjerëvet porse, si nji ndër antarët e gjinisë së njerëzvet, inkuadrohet me frytin e tij në thesarin e përgjithshëm, tue dhanë kështu kontributin si individ.

Tue pasë përpara idealin e lartë që të pasunojë, me sa janë mundësitë e tij objektive dhe subjektive, jetën shoqnore dhe personale, njeriu punon pareshtun dhe s'ka arsye të kredhet në persiatje rreth çashtjeve metafizike, përpos nëse pozita e tij sociale e ven n'aso gjendje që në vend të punës t'u kushtohet kontemplacioneve të paqëllimta.

Nëqoftëse, megjithë instinktin e çdo krijese të gjallë — i cili e shtyn ate të bajë çnuk e çmos për t'u mbajtë në baticat dhe zbaticat e jetës, tue shijue kur krajatat e kur bukuritë e saj del ndonji njeri i cili me qëndrimin e tij apatik, me indiferencën ndaj vlerave të saj dhe diogjenizmin e kurdisun në kokë, u kthehet persiatjeve mbi kuptimin e boshllëkun e jetës dhe ekzistencës së njeriut në kohë e hapsinë, ne, që gjindemi në nji distancë sadokudo të dukshme historike duhet të kërkojmë shkaqet sociale e psikogjenetike për at qëndrim të tij. Nga ky aspekt duhet shikue edhe fatin e Gjon Zaverit të Spasses që sot, tridhetë vjet mbas botimit të P s e-hit, mund të spiegohet nën nji plym rrezesh ma të forta dhe ma të qarta. Në fillim, kur u ndëgjue emni i Zaverit, këtij tipi letrar me qëndrim mohues e dendun edhe nihilist ndaj jetës dhe trashëgimit mendor të njerëzimit, ndaj nji periode historike dhe ca normave morale, kritikët, të befasuem nga ky apostat i letërsisë, ditën ta shpallin „tip pathollogjik" dhe thueja asgja ma tepër. Shikue s u i g e n e r i s, Gjon Zaveri s'asht i ngarkuem me kurrfarë deformimesh psiqike as fizike, morale e as sociale: përkundrazi — asht i shëndoshë, i pashëm dhe i squet, ma dukshëm se sa shokët e rrethit të tij, nëqoftëse mund të thuhet fare se ky ka ndonji rreth. Po kërkuem ndihmën e psikoanalizës apo të psikobiologjisë, prap s'do të gjejmë argumente nga jeta dhe zhvillimi i Gjonit për të dyshue sa i përket psikologjisë së tij. Së këndejmi i vetmi medij objektiv, i cili mund të na shpie tek çelsi i pikëpamjeve pesimiste të Gjon Zaverit janë kondidat shoqnore dhe sociale të kohës që, me strukturën e tyne, ndikojnë gati ekskluzivisht në formimin e pikëpamjeve të njeriut ndaj po asaj shoqnije, ndaj moralit të saj dhe ndaj kulturës, zakoneve e trashëgimit mendor përgjithësisht. Po e shikuem Gjonin nga kande të ndryshme analitike, do të shohim se në njifarë mënyre ai shpreh aspiratat e nji brezi intelektualësh për ta zgjanue horizontin e njohunive dhe kulturës, prandej edhe konglomerati i pikëpamjeve të tij flet sheshazi mbi vakuumin kulturor që ndihej në vend. Struktura ekonomiko-shoqnore e kohës, që reflektohej kanaleve të dukshme apo të padukshme në vetëdijen e subjektit, mund të themi se asht vendimtare edhe për pikëpamjet pesimiste e apatike të Gjon Zaverit, i cili në të vërtetë nuk simbolizon vetëm natyrën e ngrysun të nji ambienti, porse,

shikue pak ma gjanësisht, duket si ndonji reflektim, anipse në përmasa miniaturale, i krizës së ndërgjegjës së mbarë inteligjencës europiane ndërmjet dy luftave botnore. Me indolencën dhe apatinë e tij, e cila ishte e kushtëzueme nga shkaqet dhe pasojat e nji sistemi dhe nji gjendje të përgjithshme shoqnore, ai në realitet edhe sjell pasqyrën e krizës s'asaj pjese t'intelektualëve të vendit të cilët, në vend që t'ishin bartës të nji ideologjije të shëndoshë, optimiste, aktive, të njomë e të freskët, plot afsh dhe prometheizëm (çfarë janë, për shembëll, disa nga portretet e Migjenit), kredheshin në persiatje metafizike, tue bjerrë energjinë, ndjenjën e akcionit, tue humbë lidhjet me realitetin. Megjithate, ne s'mund ta flakim plotësisht momentin psiqik, sidomos në relacionin autori — protagonisti i tij. Nëqoftëse M a r k s i ka zbulue nji dukuni tejet të randësishme, dukuni jetike për njeriun, si krijesë shoqnore: shkaqet e tëhuejsimit të tij, F r o j d i ka zbulue poashtu nji dukuni të randësishme për njeriun si individ: efektin e përjetimeve të prridhuna, të cilat struken dikund në nënndërdijen e njeriut si subjekt dhe ndikimin e tyne në sjelljet e përgjithshme të tij, së bashku me ndikimin e abstenimeve seksuale.

Gjon Zaveri asht pesimist; aty-këtu, kur asht fjala për disa çashtje univerzale, paraqitet edhe si nihilist; s'pranon jetën, dashuninë, moralin dhe i shpall të gjitha këto fikcione; mohon filosofinë, por pa theksue se cilën: ate idealiste, apo materialiste, ose që të dyjat bashkarisht (inkonsekuenca e tij na ban të dyshojmë në shum thanie të tij); mohon zakonet, martesën, shqisat dhe instiktin. Indicje se vuen nga trashëgimi nuk kemi, por se vuen për shkaqe të jashtme, objektive që, tue u ngulitë në vetëdijen e tij, ia helmojnë subjektin, porse nuk tregon se i vëneron, veç kuptohen — po. Do të thotë qenka i tëhuejsuem, i iritun, shpirtnisht i larguem nga shoqnija për arsye objektive, por, njikohësisht, edhe për arsye subjektive. Kjo njiherësh do të jetë teza për ndriçimin e pesimizmit të Gjon Zaverit.

I

Romani P s e asht shkrue në vetën e parë, në formë ditari, me përjashtim t'epilogut, shi pse kjo asht mënyra ma e lehtë e të shkruemit romanesk,

kur autori do t'i shtrojë drejtpërdrejt pikëpamjet e veta. Protagonisti, si shtyllë e veprës, rreth së cilës gërshetohen fare pakëz veprime, por shum ma tepër mëdyshje e kontemplacione, gati nuk vepron, por mendon, persiat, sjell e tjerr të njajtën çashtje: kuptimin e ekzistencës së njeriut në gjithësi, kuptimin e jetës, lindjes dhe vdekjes. Mund ta përqasim me Diogjenin e mbyllun në fuçi, porse me nji dallim: filosofi antik ka sistemin e tij të caktuem, edhepse asht vazhdues i autarkisë sokratike, të cilën, thuhet, e ngrit në nivelin e askezës, kurse Diogjeni shqiptar s'ka sistem të vetin, as pikëpamje origjinale, veç hulumton ca çashtje metafizike, tue kërkue njimendësinë e jetës, pa kuptime të formueme, pa farë qëndrimi konsekuent, tue kullandrisë të gjitha rrymat filosofike, prej Sokratit e deri tek materialistët. Asht njizet e dy vjeç, në moshën kur njeriu krijon pamvarësinë e mendimit, por kur akoma nuk asht i pjekun për të dhanë gjykime të pamvaruna, sepse i mungon përvoja jetësore, horizonti i duhun i njohunive, i mungon pjekunija intelektuale që aq shum asht e mvarun nga rrethanat dhe zhvillimi i përgjithshëm. Tue u nisë nga galimatiasi i pikëpamjeve të tij, Zaverin mund ta trajtojmë si agnostik, racionalist, idealist, materialist, porse jo si empirist, edhepse përvojën e të tjerëvet e respekton dhe i falet. S'e njeh jetën, jo për shkak se asht i ri, jo përshkak se i mungon kërshërija, mbasi çashtjet nga të cilat asht i preokupuem na shtyjmë të pandehim se asht tip kureshtari dhe hulumtuesi, por ngaqë s'asht njeri i akcionit dhe intuitës. Ai s'thellohet në probleme. por vetëm shqet përmbi sipërfaqen e tyne. Kjo asht veti e njerëzve pasivë. E shquen indolenca, plogështija, ritmi tepër i ngadalsuem i jetës, nji inercion pleqërije, prandej edhe i pëlqen ma tepër të mirret me çashtje astrale, metafizike, apokaliptike, se sa me aso jetësore, në kuptimin aktiv të fjalës, aso reale, të cilat kërkojnë mprehtësi logjike dhe përvojë jetësore, aftësi konkludimi dhe aprovimi a flakieje. I mungon zotësija e krijimit dhe posedimit të nji organoni në jetë.

Njeriu asht fjala e fundit e evolucionit dhe si i tillë duhet të rropatet të zbërthejë kuptimin e dukunive të natyrës, tue kërkue kuptimin e njimendësisë së jetës dhe të qenies së tij, si krijesë transitore e kësaj bote. Në këtë drejtim ai ka krijue thesarin shumshekullor të hulumtimeve të kësaj njimendësije. Këtij thesari mendor i thonë filosofi. Porse, Gjon Za-

veri ate e mohon, e flak, tue e quejtë gënjeshtër, sepse, la merr mendja lumëmadhit, që s'ia ka dhanë përgjegjën pyetjes jetike, të përbame nga kompleksi i pyetjevet: pse lind, pse jeton, pse vdes, nga vjen, ku shkon, ç'qëllim e ç'kuptim ka jeta e njeriut, e të tjera, e të tjera? ! Në lamshin e këtyne pyetjevet, të përmbledhuna në nji: cila asht njimendësija e jetës, ai s'nguron ta mohojë këtë filosofi që shekuj me radhë vendnumron, tue shtrue kur teza, kur antiteza, ashtu sikundër ban edhe vetë Gjoni, pa i sjellë kurrfarë të mire dhe progresi shoqnisë dhe njerëzimit përgjithësisht. „E ç'farë është kjo filosofi, mik? Nuk e prek, nuk e ndëgjoj, nuk e shoh dhe... përsëri quhet filosofi? ! (...) Filosofi sokratike, filosofi aristoteliane, filosofi kantiane, filosofi... njerëzore... e ç'farë më hyn mua në qese me këto filosofi? !" Padyshim asgja, mbasi kushtet shoqnore të tij nuk ishin që të mirrej me nji filosofi materialiste, e cila, së paku do t'ia tregonte rrugën e vërtetë të jetës, tue e kthye me shpirt e optimizëm kah jeta, e jo kah vdekja e dhunshme. Ai mohon filosofinë idealiste, me përfaqsuesit ma të shquem të saj, kurse ndërmjet rreshtave kuptojmë se do ta përfaqsonte filosofinë e lidhun me jetën e njeriut, me progresin e mirëqenien e tij. Pasojisht me qëndrimin e tij të përgjithshëm, ai asht i vetëdijshëm se çdo krijesë e natyrës asht kalimtare, e mortshme: „sot është dhe nesër s'është!" Prandej kjo e vërtetë e idhët e brengos at njeri të veçuem nga shoqnija, po, të veçuem me fajin e saj, sepse, po të konsistonte në baza të shëndosha, s'do t'i jipte askujt mundësinë e tëhuejsimit. Trimi ynë, në mungesë të ndonji pune ma të frytshme, ka kohë të persiasë dhe nga persiatjet e veta të vuejë, e tue u cfilitë dëshprohet, kështuqë rrugën e vetëvrasjes e shkel dalëngadalë edhe vetë, ndonëse drejtimin ia kanë caktue kushtet... Prandej në vetëdijen e tij shprehen edhe dukunitë sociale (për të cilat do të bahet fjalë pak ma vonë). Ai lektiset mbas vetmisë: i pëlqen errësija, meqë i duket se drita do t'i pengojë mendimet e tij të zymta, sterrë, rreth çashtjeve poashtu të ngrysuna. Dhe, kur gjindet i qetë në vetmi, veç dashunisë iluzioniste dhe vdekjes e pse-ve të lidhun me to, në kokë i regëtijnë edhe kuptimet abstrakte për te dhe kohën e tij: bukurija, lirija, ndjenja. Ai s'asht i lirë, syefaqe po, por esencialisht jo; s'ka mundësi as kushte që të veprojë si të dojë; presioni i kohës dhe sistemit shoqnor i impono-

het në të gjitha fushat e aktivitetit të tij, së këndejmi, në mungesë të lirisë reale, tretën në sferat e lirës s'imagjinueme. Por, mjerisht për te, as atje nuk gjen lirinë e dëshirueme, meqë sakaq ballafaqohet me njimendësinë e tragjikës së njeriut, i cili s'ka përpara ndonji ideal të caktuem për të cilin do të përpiqej e të luftonte. Prandej edhe ngel pezull ndërmjet të mundshmes dhe të pamundshmes, ndërmjet ambicjes dhe mundësisë, në flakën e të cilavet digjet brambullueshëm imagjinata e tij prej njeriu të tëhuejsuem. Asht interesant të shohim se ç'përgjigje u jep ai fjalëve të bashkëbiseduesit të tij, profesorit, i cili e këshillon që të jetojë sikundër pjesa dërmuese e njerëzve, tue e kthye shpinën njashtu siç fryn era, por tue mendue si t'ia do zemra, mbasi tekefundit, vetëm të menduemit asht nji proces i lirë dhe i pakontrolluem. „Por unë e dij se një njeri, që ka të drejtë, duhet edhe të veprojë; mirëpo profesori është kundra veprimit" — thot Gjoni, edhepse vetë s'di të veprojë, s'di e as që asht njeri i veprimit o akcionit, e ata që ishin t'akcionit, s'guxojshin, meqë e vërteta paguhej shtrejtë. Së këndejmi edhe profesori thot se njeriu i sodit ma së miri e ka që të mendojë, mbasi ndër mendime, në këtë zonë sadokudo të pamvarun s'mund të futet kush. Me anën e mendimeve njeriu i krijon vetes iluzionin e lirisë dhe të prehjes. Trimi ynë kërkon këtë liri dhe prehje, por s'i gjen. Ikën nga vrazhdësija e realitetit material dhe zatetet në vorfninë intelektuale, ku ajri ishte shum i rrallë, njohunitë të pakta e etja e tij shum e madhe. Në nji këso situate përqafon ate që e para i gjindet pranë dorës, që i ofrohej e imponohej — tanë trashëgimin idealist filosofik, porse asht i vetëdijshëm se me te s'do ta gjejë të vërtetën të cilën e kërkon. Tekefundit, e kotë ishte e vërteta të cilën e hetonte, e ma të kota mjetet me të cilat iu kishte rrekë. Prandej edhe jeta e tij asht iluzion, pluhnizë mbi sytë e drejtuem nga kupa e qiellit. Me proceset mendore ai i ikën realitetit, me thellësinë e shpirtit mohon normat e shoqnisë, të cilat janë tabu dhe thuejase të pacënueshme për dike. Ngaqë i mungojnë farë njohunishë të gjana dhe sistematike, ngaqë edhe ate që e di s'ka ku ta zbatojë sikundër lypset, ai s'i gjen vetes tjetër rrugëdalje përpos të kredhet në botën e iluzionevet, ku gjen satisfakcionin e vet shpirtnor. Po ta dinte rrugën e daljes nga ai rreth magjik, nga ajo zabullimë shoqnore, ai nëqoftëse s'do të tregonte farë

aktivizmi, farë mospajtimi, nëqoftëse s'do të përqafonte prometheizmin e portreteteve të Migjenit, bile do të ngazëllehej për lirinë shpirtnore, për atë satisfakcionin e mbrendshëm dhe në ngazëllim e sipër, mos asgja tjetër, së paku do të pranonte filosofinë e Natanelit të Zhidit: „Veprimet tona lidhen për ne sikundër farfuritja për fosforin. Ato na harxhojnë, vërtet, porse ato përbajnë shkëlqimin tonë", ose: „kushtoja tanë lumtuninë çastit". Mirëpo, Zaveri s'e ban as këte. Bota e tij shpirtnore, ajo botë e mbrendshme që përjetohet n'intimitetin ma sekret, asht nji botë asketi, e cila puthitet mjaft bukur me qëndrimin e tij të përgjithshëm prej njeriu pasiv dhe indolent. Nëqoftëse nji njeri asht i inklinuem të mirret kryekëput me çashtje metafizike, tue deklarue se ia grish kureshtjen misterioziteti i tyne, ai njeri mu pse asht tepër i preokupuem prej tyne, nuk do të jetë në gjendje të përsojë ndonji përjetim si ma intensiv të shpirtit. Gjon Zaveri asht kundër çdo epikureizmi, meqenëse imagjinatën e ka të lidhun për fikcione ma parë se sa për objekte konkrete, asht kundër çdo hedonizmi, meqë i pëlqen të ngritet shpirtnisht nga realiteti. Tueqenëse pandehte që njimendësinë s'do ta gjente me ndonji sistem të caktuem filosofik, ai ban ekskurzion nëpër të gjithë, apo gati nëpër të gjithë dhe s'ndalet tek asnjani. Qëndrimi i tij labil në fushën e filosofisë dhe përgjithësisht ndaj saj mund të spiegohet me dyshimin e tij total ndaj çdo norme e aksiome, që tok me konceptin dekartian do ta flakte, ndoshta, sikur të kishte pasë ndonji kontakt ma të rrastë me filosofinë marksiste të cilën, edhepse nuk e përmend askund, e as ndonji ithtar të saj, prap e shohim dendun në pozita të saj. Njimendësija, si e quen vetë, të cilën e hulumton, asht enigma e lindjes, jetës dhe vdekjes. Tue e mohue bukurinë e jetës me të gjitha atributet e saj, ai mendon pareshtun rreth vdekjes dhe peshës së saj, para së cilës ndien nji shprazti të paspigueshme. Sikurse shumicën e filosofëve dhe shkrimtarëve, edhe Diogjenin shqiptar e intereson kjo finale e jetës dhe, meqenëse n'at konglomerat mendimesh s'di t'ia gjejë vetes shtekun ma të qartë, konstaton nji të vërtetë: me vdekje lindet njeri i ri, që njiherësh asht i vetmi ngushllim i tij në kuptimin e përgjithshëm të tragjikës jetësore. Kjo e vetmja notë ndjellamire, por disonante në krahasim me pikëpamjet e tij të përgjithshme, megjithë negacionin që i ban jetës,

flet për disa lëvizje dialektike në shpirtin e Zaverit. Mbas vetëvrasjes së Gjonit, ajo grimë optimizmi që gjindet në shpirtin e t'afërmive të tij i kthehet të shoqes, Afërditës, e cila, me stocizëm fshatarak, me gazmend e hare jetësore dhe botëkuptime të shëndosha e të pamolepsuna nga rrymat dekadente të shekullit, vazhdon, ndoshta me krijesë të gjallë në bark, ta përmbyshë detyrën e çdo të gjalli — vazhdon jetën me punë e me sy të drejtuem nga e ardhmja.

Gjon Zaveri, asht njeri i cili di t'i venerojë gjanat e dukunitë, por ngase asht plotësisht i pushtuem prej „enigmës së jetës", s'di ta gëzojë çastin, as ta shijojë dosido bukurinë e jetës, të cilën asht në gjendje ta pikasë — e pikërisht ky Gjon i ndërlikuem, antihedonist dhe antistoik njikohësisht asht i prirun t'i përudhë të tjerët ngandonjiherë që ta gëzojnë jetën. Mirëpo, kështilla e tij lidhet me nji kusht: njeriu s'duhet të bajë mëkatë kurrë, meqë gëzimi, ndoshta, asht i lidhun për mëkatën. Si bir i shekullit dhe shoqnisë së kohës asht i bindun se çdo njeri qenka n'aso situate e cila vetëvetiu e ven në pozitë të bajë mëkatë, (mbasi struktura e shoqnisë klasiste asht e tillë), porse detyra që i shtrohet secilit përpara, simbas moralit të tij, asht që të bajë sa ma pak mëkatë: e i liruem krejtësisht prej saj nuk mund të jetë askush. Këtu qëndron esenca dhe njimendësija e moralit të tij mjaft, mjaft human. Mëkatën si kuptim, edhepse lexuesi rëndom e lidh me pikëpamje religjioze, duhet marrë si nji aspekt social, që në këtë vepër shprehet mjaft shpesh dhe theksueshëm. Ai pohon, me plot të drejtë, se nuk gjindet dot nieri pa mëkatë meqë, krijesa njerëzore jeton tue veprue, e kur vepron, deshti e s'deshti, vihet n'aso pozite nga e cila ndaj dikujt tregohet i drejtë e ndaj ndonji tjetrit mëkatnor. Tekefundit, njeri i thonë sepse vepron kur mirë e kur keq por, nëqoftëse keq ban në mënyrë të vetëdijshme, atëherë i thonë njeri-mëkatnor. Njeriut, i cili s'ban kurrfarë mëkate, i thonë shenjt, e meqenëse shenjtorë s'ka, do të thotë secili njeri, pamvarësisht nga vullneti i tij, asht pjesëmarrës i njifarë mëkate të madhe o të vogël. Kuptohet sheshazi: teksa lind njeriu gjindet në nji log ku s'mund ta evitojë mëkatën, e kjo ishte pasojë e strukturës së marrëdhanieve ndërmjet njerëzvet.

Ate e intereson tanë kompleksi i sipërpërmendun i pyetjeve të lidhuna me lindjen, jetën dhe vdekjen, por kjo e fundit, kur e shikon nga aspekti social, i sjell

njifarë ngushllimi, sepse para saj i lajnë hesapet të gjithë njerëzit pa kurrfarë dallimi. Kjo shpatë e Damokaleut nivelizon të pasun e të vorfun, të bukur e të shëmtuet, gaztorë e pesimistë, të mençëm e tarallakë. Meqenëse asht i ri dhe i mungon përvoja jetësore, ajo pasuni mendore aq e nevojshme për formimin e botëkuptimeve dhe sistemit të caktuem filosofik, e që nuk fitohet nëpër katedra por në luftën e ashpër jetësore, Gjoni kërkon njeriun që i duket se, me horizontin e tij të gjanë të përvojës, do t'ia sqarojë enigmën e cila ia posaqis shpirtin. E nëse nuk do t'ia tfillojë, së paku do t'ia lehtësojë barrën e randë me të cilën e ka ngarkue veten ky apostat i shoqnisë, paradoksi i të cilit asht aq ma i madh, kur shohim se si asht i mirëpritun në çdo rreth e ambient. Nji vargu pyetjesh që shtron trimi ynë do t'iu përgjigjet plaku i përvojshëm, Nasi, i cili, përpos që ka shijue të gjitha nuancat e jetës: skamjen mërgimin, urinë, jetën baritore, por në fund edhe mbushullimën materiale, e jo edhe shpirtnore, respektin e rehatinë, asht nji altruist, gati kosmopolit, që i shëmbëllen Gjonit. Pikëpamjet e tyne në lidhje me shum probleme që e mundojnë Gjonin janë pothuej identike, prandej edhe respekti i këtij për plakun asht i pakufishëm.

Lexuesi pret, gja që asht plotësisht e natyrshme, që Zaveri dhe plaku Nasi t'i konfrontojnë mendimet. Mirëpo, autori këte s'e ban. Dikush mund të pandehi se në kët mes qëndron nji ndër të metat strukturale e formale të veprës. Ndërkaq, po u përcoll ideja qendrore e veprës, do të shihet se Spasse edhe këtu asht konsekuent dhe pason idenë që ia ka shtrue veprës së tij.

Zaveri, u theksue ma naltë, asht nji përfaqsues i rinisë dhe intelektualëve të demoralizuem të nji kohe e nji ambienti të caktuem, respektivisht asht inkarnacion i njeriut që jeton në nji vakuum, t'iritun, të dërmuem shpirtnisht, njeriut që i kaliset vetëvetes, njeriut të pamundësi e as përgatitje për përqafimin e ndonji ideje të caktueme progresive, edhepse vetë individualiteti i tij asht negacion i së vjetrës, kurse plaku, me mençurinë e tij të hollë, e që ka për bazë përvojën shumëvjeçare, mënyrat e ndryshme dhe dërmimet skaj më skaj të botës, vetëm i përforcon dyshimet pesimiste të tij dhe inkuadrohet në konceptin e përgjithshëm zaverian. Në vargun e përgjigjeve që iu jep pyetjeve të djaloshit, plaku nxjerr në shesh

nji numër thaniesh, që mund të jenë edhe sentenca, të blueme sa e sa herë, prej filosofëve ma të vjetër e deri në shekullin tonë. Edhepse shihet që s'janë formulime autoktone të trollit dhe natyrës shqiptare, ne s'befasohemi aq shum prej tyne, mbasi i ndëgjojmë nga goja e nji personi të sprovuem gjithqysh nëpër baticat dhe zbaticat e jetës. Shikue nga nji kand tjetër, mund të konkludohet se përgjigjet e plakut, pa ndonji bazë konstante filosofike, vejnë në dukje qartazi se si idetë e importueme filosofike nga Europa, të cilat s'trajtoheshin e as nuk komentoheshin fare nga ndonji person sadokudo i pajisun me njohuni përkatëse, po helmojshin shpirtin e të riut. E importoheshin ma së shumti aso ideshë, të cilat i përgjigjeshin zabullimës shoqnore, meqë baza e tyne konceptuale ishte idealizmi, në rastin e cekun: idealizmi subjektiv.

Kritika e kohës ia veshi Spasses ndikimin nga Shopenhaueri, Tolstoi, Leopardi e Niçe, e sidomos nga ky i fundit. Në nji vepër çfarë asht P s e-hi, me nji gërshetim ideshë të ndryshme, që s'lidhen në ndonji sistem të caktuem, asht shum vështirë të konstatohet kryekëput se nga ka pësue ma së shumti influencë autori. Tekembramja, kjo çashtje s'asht aq me randësi, por edhe nëqoftëse asht, ngel e zbetë para randësisë së burimeve inspirative që i shërbyen Spasses për të krijue këtë vepër në të cilën ideja e mohimit të jetës, në të vërtetë asht ide e mohimit të nji realiteti të zymtë. Ndikimin e konceptit themelor filosofik të Tolstoit: „mos e kundërshto të keqen me dhunë" mund ta pranojmë në kompartmanin e përgjithshëm zaverian ndaj shoqnisë e njerëzvet, porse jo edhe ndaj dashunisë e femnës. Nëqoftëse realisti i madh rus predikon kuptimin tragjik të vdekjes dhe, si thonë studjuesit e tij, i afrohet kësaj tragjike njerëzore ma tepër se askush tjetër, Spasse në trajtimin e këtij problemi qëndron në pozitë krejt tjetër: i liruem nga religjioni. Në këtë drejtim i afrohet Niçes, i cili predikon vdekjen „në çastin e duhun". Derisa Tolstoi e merr si tragjikë të përjetshme „tragjedinë e shtratit bashkëshortor", që do të thotë se i kushton randësinë e duhun anës fizike, landore, të dashunisë, do të thotë instiktit, e jo iluzionit, Zaveri përfill vetëm anën fiktive

të këtij emocioni. Kemi edhe nji argument tjetër flagrant për mohimin e konstatimeve të tilla. Tolstoi çfleton, si thonte vetë „dialektikën shpirtnore" të karaktereve të tij, meqë shpirtin e njeriut e shikonte nga nji pozitë dialektike dhe e mirrte të ndryshueshëm „si lumi", kurse Spasse në veprën e tij jep nji psiqikë statike, të palakueshme, të ngurtë dhe, në sensibilitetin e saj, metafizike. Prandej, nëqoftëse ndokush e kërkon këtë ndikim si sistem, si parim të përqafuem prej së jashtmi, do të gënjehet, sepse ai mund të jetë vetëm periferik, ndikim i pësuem nga ndonji formulim epizodik i Tolstoit, që asht sall nji degëz e vogël e trungut të tij të madh filosofik. I tillë asht edhe fati i supozimit se ndikimi i Niçes mbi fazën e parë të veprimtarisë së Spasses asht dominant. Mund të përfillet vetëm mundësija se Spasse ka pësue ndikimin poashtu të disa pjesëve të krijimtarisë së Niçës, porse jo të tanësisë dhe të kuptimit të përgjithshëm të veprës së tij. Tekembramja, Niçe kërkon njeriun e fuqishëm fizikisht e shpirtnisht, njeriun e merdostë, të shkathtë e të pameshirshëm, me nji fjalë kërkon mbinjeriun. Nji kësi njeriu — mbinjeri duhet ta zavendësonte zotin, të cilin ai e shpalli të vdekun. Ndërkaq, Gjon Zaveri asht antipod i mbinjeriut niçean; përqasja ndërmjet tyne mund të na e përkujtojë raportin që mund të kenë mesveti ujku dhe qingji. Mandej edhe diçka tjetër: stilisti dhe filosofi gjerman, sado paradoksal që mund të duket për pikëpamjet tona ndaj krijimtarisë së tij nji konstatim i këtillë, kërkon nji art të kthjellët, të freskët, dritë plot, art i cili duhet të ngjalli shpresa, të na bajë të duem jetën, art që e ngrit optimizmin jetësor të njeriut kurdoqoftë dhe kudoqoftë. „Veçori esenciale e artit — shkruen ai — asht aftësija e tij e përsosjes së jetës, e krijimit të bukurisë dhe mbushullimës: arti esencialisht asht afirmim, mirëqenie, adhurim i jetës. C'asht arti pesimist? Në mos i thonë kësaj kontradiktë? Po". Dhe ma tutje: „Artin e kemi që të mos shkatrrohemi për shkak të së vërtetës". Do të thotë, iluzionin e mirëqenies dhe prehjes, meqenëse nuk na e krijon realiteti, duhet të na e krijojë arti. E Spasse, ç'na sjell me romanin e tij të parë, me këtë shtatanik të vetin, me të cilin, po ta kishte shkrue, bie fjala, në Parisin e 1935-çit, me siguri do të bahej i famshëm? Na sjell nji pesimizëm që asht negatio vita, nëpër gojën e Gjon Zaverit, si fytyrë

qendrore e veprës dhe gojës së Nasit, si fytyrë që s'asht bile as epizodike, por e rastit, anipse mjaft markante përkah fuqija e individualitetit të vet. Mirëpo, diferenca e moshave të tyne, që kap nja shtatëdhjetë vjet, s'asht pengesë që të kenë pikëpamje identike. Edhe ky moment, kjo diferencë në moshën e tyne, e cila nën të tjera kushte e në tjetër kohë, do të duhej të sillte edhe ndryshime në pikëpamje, meqë plaku ka të drejtë ta mohojë jetën mbasi përvoja e tij asht pelin e idhët dhe gjindet me nji kambë në vorr e me tjetrën mbi, kurse Zaveri asht i ri dhe duhet të shquhet me vullnet e optimizëm, këtu e fakton tezën se Zaveri e mohon jetën sepse asht i tëhuejsuem nga shoqnija për shkaqe të shumta dhe të ndryshme. Në fund mbetet konstatimi i ndikimit t'ushtruem nga Shopenhaueri dhe Leopardi, por pjesërisht. Ç'asht ma me randësi në këtë mes, duhet ditë se nën ndikimin e kurrfarë literature njeriu nuk e krijon kredon e vet sa nën ndikimin e atmosferës autoktone sociale e shpirtnore. Së këndejmi romani i Spasses asht i brumosun nga disponimi i nji momenti historik dhe nëse kryeprotagonisti asht i plyrun në pesimizëm — fajin nuk e kanë librat e hueja, por sistemi, shoqnija dhe koha. Ideja e Sterjo Spasses asht origjinale dhe interesante, e pse i zihet për të madhe ndikesa — kjo do të jetë ma parë gjanësija e kulturës së tij.

Por, të shohim cila asht filosofija e këtij plaku të sprovuem. Nji njeri i cili jetën e fillon që nga fundi, tamam që nga ai fundi i llahtarishëm gorkian, me nji krrabë, strajcë e gunë, si të vetmën pasuni dhe mbas travajave të shumta nxjerr përfundime për jetën çfarë janë ato të tij dhe të Gjonit njikohësisht, ka të drejtë t'i ruejë ato tri sende — simbole të skamjes e mjerimit — si relike dhe kujtim i atyne ditve të vështira, me që llim që të jetë prore e zgjuet vigjilenca e tij dhe të mos kredhet në mëkata, për të cilat u fol ma naltë. Nëqoftëse shpirti s'i koruptohet, sic ndodh në të shumtën e rasave, atëherë edhe respekti i tij ndaj skamnorëve do të jetë përherë i përcjellun nga përdëllimi. Pa pretendime fetishizimi të përvojës s'idhët në jetë, ai nxjerr nji konkluzë shëmbëllyese me ate të filosofit anglez se „njeriu për njeriun asht ujk", e veçmas në nji shoqni ku konkurenca asht e pameshirshme ndaj ligjeve të moralit dhe kujdesit njerëzor. Këte ai e ka sprovue në të gjitha skajet e botës, e ia thot edhe realiteti i vendit

mbasi kthehet s'andejmi. Njikohësisht jeta e ka mësue, sigurisht kontrasti i jetës njiherë si i vorfun e mandej edhe si i pasun, se e vetmja pasuni ma e madhe e njeriut asht dinjiteti njerëzor dhe harmonija mbrenda Unit vetiak. Ajo gnoti seauton[1]) e Grekëve të vjetër asht aksiomë që i imponohet me ekskluzivitet secilit individ që dëshiron të vendosë qetësinë e harmoninë personale. Së këndejmi tanë koncepti i tij filosofik, apo ma mirë ta quejmë formula e tij jetësore, konsiston në nji humanizëm të thellë, që prihet nga respekti dhe adhurimi i qenies së njeriut dhe nga përpjekjet për përmirësimin e së tanishmes së tij. Meqenëse qëndrimi i tij ndaj kuptimit të përgjithshëm t'ekzistencës asht pesimist, që do të thotë se vdekja asht ajo e cila e huton edhe këtë nandëdhjetëvjeçar, s'na befason kërkesa të cilën ua drejton njerëzvet që ta shfrytzojnë jetën dhe, në mos asgja tjetër, bile „ta kujtojnë vehten të lumtur". Tue u nisë nga ky aspekt ai i rekomandon njeriut që të mëqaket ngahera për të qenë ai që asht, sepse ndër shkaqet e çkepjes dhe cfilitjes fizike e shpirtnore të njerëzvet janë iluzionet e tyne të rrejshme se mund të jenë jo ata që janë por të tjerë. Meqenëse e flak metapsikozën, për të cilën Naimi tregonte nji afinitet të posaçëm me konceptin e tij panetist, ky asht ithtar i nji koncepti tjetër i cili, edhepse i përshkuem nga toni pesimist, prapseprap konsiston në nji humanizëm, që mbi të gjitha çmon etikën dhe nderin njerëzor. Shkurt: asht humanist përsa i përket strukturës sociale të shoqnisë, në ç'pikëpamje koncepti i tij puthitet plotësisht me ate të Zaverit dhe, skeptik përsa i përket trajtimit filosofik të kuptimit të jetës së njeriut në gjithësi — do të thotë mikrokosmosit në makrokosmos. Jeta — thot ai — përmban vetëm dyshime. Edhe në këtë mes mendimet e tij përputhen krejtësisht me të protagonistit, i cili e kërkon njimendësinë e të vërtetës me dyshim dhe skepticizëm ndaj secilit kuptim dhe secilit gjasend.

Se Zaveri asht i papërvojshëm, se nuk ka mbërrijtë ta njohë jetën sikurse lypset për të mundë të depërtoië në fshehtësitë e saj dhe në regjionet e errta të njeriut, fakton edhe ndikimi që ia bajnë fjalët e bashkëbiseduesit, të cilin e respekton si njeri të shenjtë, njashtu siç respekton edhe çdo krijesë tjetër,

[1]) Njihe vetëveten.

e edhe femnat, përkundër pohimeve se asht antifeminist, përkundër mohimit që ia ban martesës dhe dashunisë së lidhun për te. Tevona edhe këtij i regëtijnë në kokë mendimet që parandej i dukeshin të huaja dhe gati absurde. Tue qenë konsekuent ndaj pikëpamjeve të përgjithshme personale, ai pëson vetëm nji ndryshim të vogël: zen të mendojë në mos asht a s'asht ma mirë që njeriu t'i kushtohet jetës, sepse sheh që gati të njizet e tre vjetët i kanë kalua tue kërkue „të vërtetën" dhe p s e-hin e lindjes, jetës dhe vdekjes, kurse si gëzimi ashtu edhe idhnimi kanë karakter tranzitor. Së këndejmi në çaste të tilla i kujtohen edhe vargjet khajamiane:

...Ngreh-u! Sa rron zbraz kupa dhe puth çupa:
Ke shekuj që të flesh në qetësi!

Por, prap, jo! Edhepse veprimet e tij flasin për nji njeri të matun, mitar, gati statik n'ato skofitë e tij ndaj njerëzvet, afektet ia shprehin të kundërtën: asht prore i pakënaqun me vetëveten, rehati shpirtnore s'mund të gjejë askund, sepse asht bir i kohës, pjellë e nji periudhe dhe ambienti plot kontradikta. „Bëj ate që të teket: kjo asht Jeta!" Megjithate, ai s'e ban vetë këte, sepse s'i teket gjasend; njeriu që ka kërkesa e don jetën, e Zaveri, meqë s'e don jetën, s'lyp ndonji të mirë prej saj. Ngurimi i tij para bukurive të jetës ngritet në nivelin e askezës, e katarzë asht vdekja.

Njeriu, kur s'ka mundësi objektive të mirret me ndonji punë të dobishme, kur shoqnija s'i sjell kondita për orvatje frytdhanëse e kreative, doemos i kushtohet ndonji vesi të damshëm, ose kredhet në botën e imagjinatës, për t'u kënaqë me iluzione në vend se me gjasende reale, apo për ta harrue njimendësinë e realitetit. Së këndejmi në roman figurojnë: Gjoni si përfaqsues i botës që gjen shprehje n'iluzionet vetiake — nga nji anë, dhe Pola e djemt e kohës që i kushtohen kumarit e veseve të tjera — nga ana tjetër. Ma merr mendja se këtu, e jo n'afinitetin e tij që të zhytet në sferën e imagjinatës, qëndron shkaku i tragjikës dhe konfliktit zaverian me veten dhe shoqninë. Përse e trajton ai vdekjen si nji barazuese të të gjithëvet, të të pasunëvet dhe të vorfunëvet, të femnavet dhe mashkujvet, të mbretënvet dhe lyparakëvet? Meqë, ndoshta, nji mendim i tillë i sjell ngushllim, satisfakcion shpirtnor dhe qetësim të revoltës së mbrendshme

ndaj dikujt. „Por — ah, o i ri! — të gjitha kalojnë nën shkëndiat përvëlonjëse të shpatës sime. S'merr përpara syve se ç'farë je a cili je!" — i faniten Gjonit fjalët e vdekjes, që asht „ngushllimi i të vobektit" dhe çmeritje e shastisje e të pasunëvet, këtyne njerëzvet zemërgurë, të cilët ajo i bie në shkallën e Hiçit, tue i mbushë me frikë dhe tue ua përulë dinjitetin, sikundër asaj mbretneshës britanike që në momentin e fundit të jetës pranoi ta jipte mbretninë mbarë për edhe nja pesë minuta gjallesë. Formulime të ngjashme për vdekjen gjemë tek nji varg shkrimtarësh të mëdhej, të cilët qenë veçmas të preokupuem nga ky problem. „Krimbi ësht' i vetëmi perandor që na ka për të ngrënë. Ushqejmë të gjitha bagëtit' e tjera që t'i hamë dhe të majemi, dhe bëhemi të majmë për krimbat e kufomave. Mbreti i majmë dhe liparaku i thatë s'janë veç dy gjellë të ndryshme, dy pjata, po për gjithatë tryezë. Ky është fundi" — thot Shekspiri[1]).

Shtruem tezën se Gjon Zaveri asht i tëhuejsuem nga shoqnija, nga familja dhe nga vetja. S'asht i kënaqun me asgja dhe me aske, e në radhë të parë me veten. Skepticizmi dhe antihedonizmi i tij janë tabu për te; dyshimit ia nënshtron çdo mendim e dukuni; s'përfill norma as ligje, e as që sheh vetë ndonji perspektivë të qartë. Me vetëdijen dhe veprimet e veta i vihet përballë çdo akcioni. Po të veprojshin të gjithë njerëzit sikurse ai, evolucioni do të ngelte në vend njiherë e përgjithmonë. Inercioni asht në gjakun e tij, vdekja asht ai vel i zi përtej të cilit s'sheh tjetër gja. Tragjika e tij asht truni i tij; me te dëshiron të sprovojë njeriun e botën, jetën e vdekjen: prej gjasendevet deri tek dukunitë metafizike. Mirëpo, jeta organizohet me ndihmën e procesevet të të menduemit, por s'kalohet vetëm me to e nën kontrollin e tyne. Njeriun e prin edhe njifarë bote e mbrendshme, e cila lyp të përfillet, lyp t'i plotësohen huqen, sepse njeriu, ndonëse me të menduem ngritet lart tue i dhanë kontributin e vet thesarit të njerëzimit dhe etikës shoqnore, prap asht qenie bilogjike. Prandej, mjer ai që ndjek sall zanin e racios, e jo edhe të shpirtit dhe emocionit! Shkaku tjetër, pra, i tragjikës së Gjon Zaverit asht përfillja konsekuente e perceptimeve mendore dhe prridhja e pamëshirshme e ndjenjavet, e ins-

---

[1]) Hamleti, akti IV, skenë II; përkthimi i Nolit.

tiktit. Shpesh njeriu me të menduem krijon botën e iluzioneve, andërrave, botën e tij ireale, siç vepron trimi ynë, por kjo botë asht eterike dhe s'e dëshmon kuptimin e ekzistencës së vërtetë, poqese nuk provohet edhe me shqisa. Iluzioni i lumtunisë që mbështetet vetëm në përfytyrime asht iluzion, e lumtunija e vërtetë ka mbështetjen objektive, materiale. Në mungesë të kësaj lumtunije ai edhe qëndron ndërmjet jetës dhe vdekjes, fizikisht i gjallë e shpirtnisht i vdekun. E kush do ta shpëtonte nga nji gjendje e tillë shpirtnore, nga ajo atmosferë e helmueme e mbrendisë njerëzore? Vetëm Shoqnija. Shkaqet subjektive të nji pezmatimi të tillë janë të vume në plan të dytë. Por, kur shoqnija asht e ngrysun, kur ajo s'asht e interesueme për fatin e individit si pjestar të saj, atëherë edhe ai krijon botën e tij tragjike, dhe në mungesë të ndonji perspektive si ma të ndritshme, të ndonji ideje progresive, ecën me shpejtësi nga asgjasimi i vetëvetes. Fati i Gjonit s'asht i vetmuem në letërsinë botnore. Me botën e vet iluzioniste, astrale, me egoizmin e çfaqun në veprime, e jo aq me gojë, ai asht pjellë e momentit historik, e shpraztisë intelektuale, që shquen at periodë. „Njeriut të sotçëm mund t'i duket se Gjoni nuk është i kohës. përkundrazi ai është i kohës dhe koha e sotçme e bëri të mendojë ashtu. Ndofta shum i ri punën e filloi nga lartë" — flet Spasse, tue faktue kështu se protagonisti i tij ka kuptimin e vet historik. Pikërisht koha për të cilën flet autori, e kjo do të thotë shoqnija e asaj kohe, i dha mundësi Gjonit ta torturojë kokën me ide të giithënduershme dhe me pyetje siç janë këto: „... ku është qëllimi i njeriut, (...) ku është qëllimi i jetës vetë, i jetës s'ime, i Unit t'em...? dhe tutje:" Është diçka kjo Botë a po asgjë? Ka qëllim a po s'ka qëllim? Linda! Po pse u — linda? Jam! Po pse jam? Do të vdes! Po pse kam për të vdekur? Po ecij, por nga po vij? Kaloj rrugës, por ku po vete?" Dhe kështu me radhë edhe sa e sa pyetje të ngjashme që s'shpiejnë askund dhe nuk sjellin kurrfarë përgjegje, porse dëshmojnë se ai cili mirret me to dhe ia parashtron vetes vuen nga apatija dhe kotësija, se ka humbë kontaktin me realitetin dhe plevat n'ajr.

Shihet sheshazi se Gjonin e dërmojnë edhe kundërthanie mbrenda konceptit të tij filosofik. Siç vëren edhe kritika e kohës, herë asht metafizicien, e herë meterialist. Edhepse rrallë e tek pranon se zoti asht

krijues i botës, kohëmbaskohe shfryen edhe mëllefin e tij prej njeriut të tëhuejsuem edhe kundër kësaj pjelle t'imagjinatës së njeriut dhe e ven në tallje, tue ba shaka n'adresë të tij. „S'paska vdekur nga Zoti, po qënka mbytur nga uji" — e komenton vetëvrasjen e shokut të vet, Gjençit. Tutje shohim se bukur shpesh e merr zotin fajtor pse disa njerëz bajnë jetë të mrekullishme, e disa të tjerë katandisin si mos ma keq, tue vu kështu në spikamë kontrastet e mëdha të shoqnisë përsa i përket gjendjes sociale. Bie veçmas në sy se si çashtjet religjioze, që ishin mjaft aktuale në kohën e tij, s'i zen gati fare në gojë, e kjo do të thotë se nuk i përfill. S'do mend se Gjoni ndien nji si frikë paskaliane para „hapsinës së paskajshme" dhe pozitës së njeriut në te. Kompleksi i pikëpamjeve dhe veprimeve të Gjon Zaverit shpie të përfundohet se ai s'asht në vazhdën e botëkuptimeve të bashkëkohasvet, porse asht demiurg i botës së vet, specifike në çdo pikëpamje; në këto specifictet të natyrës së tij qëndron edhe randësija e tij historike. Mirëpo n'anën tjetër mund të konstatohet se autori duhet të ketë qenë i informuem, edhepse jo hollësisht, mbi zhvillimin e mendimit bashkëkohor n'arte dhe shkencë. Protagonisti i tij zen ngojë edhe problemin e kohës dhe hapsinës, që do të thotë se krijuesi, përveç nga tekstet filosofike, ban vaki se kishte ndëgjue diç edhe për teorinë e relativitetit, të cilën e kishte publikue asokohe Ajnshtajni.

Përveç se ç'mendon dhe ç'vepron, lexuesit i kujtohet edhe nji çashtje tjetër në lidhje me Zaverin, respektivisht i kujtohet t'i bajë vetes pyetjen: përse ai s'shquhet me kurrfarë reminiscencash, që do të kishin të bajshin drejtpërdrejt me të kaluemen dhe fëmininë e tij, në bazë të të cilave do të përfundohej se çfarë ka qenë miturija dhe rinija e tij, çfarë e ka pasë atmosferën familjare në të cilën asht rritë, me ç'pikëpamje asht pajisë që përpara, e të tjera. Tueqenëse jeta fshatare e Shqiptarëve ishte pothuej çdokund e njajtë, me të njajtat probleme e brenga, me të njajtat botëkuptime e zakone, mbetet të besojmë se me zhvillimin e intelektit të tij gjatë shkollimit iu ka zgjue edhe vetëdija për gjendjen sociale shoqnore, për ç'arsye edhe asht arratisë shpirtnisht. Fshatari, marrë përgjithësisht, asht indiferent ndaj vdekjes, ashtu sikundër asht indiferent ndaj të kaluemes dhe ndaj ardhmënisë. E përse mos t'ishte i tillë? Ç'të mirë i sillte jeta?!

Porse, gjatë jetës së vet asht stoik. Gjoni qëndron në nji pol të kundërt me ligjin jetik të fshatit. Fshatari e provon ekzistencën e vet në kontaktin me realitetin; shqisat janë instrumentet me anën e të cilavet bindet se asht gjallë; kontemplacioni zaverian s'flen në natyrën e tij. Gjonin e shquen e kundërta e ekësaj: bota e tij asht ireale. Meqë s'mirret me çashtje praktike, duket se s'asht prej mishi dhe gjaku, porse prej ndonji flurome. Duket se mohon të gjitha zakonet dhe pikëpamjet e të parëve, mbresë të tillë len me indolencën e vet, porse nuk e shohim t'aftë të përqafojë ndonji ide të caktueme progresive. Ma mirë s'mund ta quejmë se hibrid i Oblomovit, apo i ndonji apatiku tjetër. Pezullon ndërmjet mohimit të të vjetrës dhe hulumtimit të të resë. Ky do t'ishte, ndoshta, përkufizimi ma objektiv i relacionit të tij ndërmjet perfektit dhe futurit. Së këndejmi asht plotësisht e natyrshme pse mbas Zaverit, si protagonist të Pse-hit, vjen Afërdita, si protagoniste e Afërditës. Jo pse ai vetë përqafon ndonji ide të re, por pse tragjika e tij dëshmon për nji njeri të tretun, njeri i cili asht shkëputë psiqikisht nga tradita, anipse ndonji rruge të re s'asht nisë. Vdekja e tij e len njeriun me totalitetin e vet n'alternativë... Në nji këso periode kalimtare edhe durimi i Zaverit asht në zgrip, prandej si të veprojë ndryshe, përpos të bajë ate që e bani. Kryen vetëvrasjen, veç të tjerash edhe për të tregue se nuk vdiq nga dora e zotit?! Ndoshta për të tregue heroizëm?! Por, a mund të jetë kjo edhe vdekje mbas së cilës fillon jeta e re?!

III

Motivi që e cyt Gjon Zaverin të kredhet në pesimizëm, e pastaj edhe të mohojë jetën me të gjitha të mirat e saj, asht dashunija. Ai, si njeri sadokudo i emancipuem, ndien se zgjedhja e lirë asht i vetmi akt moral për te, së këndejmi edhe vihet në nji opozitë shpirtnore ndaj të gjithë atyne që ia imponojnë dëshirën e vet në këtë pikëpamje, si edhe ndaj tanë kompleksit të trashëgimit që ka të bajë me aktin e dashunisë dhe fejesës e martesës. Këtu edhe fillon konflikti i tij me veten e shoqninë, këtu zanë rranjë persiatjet e tij metafizike me të cilat, i bahet, se ndien kënaqsi ma të madhe se sa në kontakt me realitetin. Shkak i shkëputjes së tij nga bota e përditshme qenka, pra,

dashunija. Kjo ndjenjë asht edhe shkaku i tragjedisë së tij, shkaku i tragjedisë së Gjençit, shkaku i tragjedisë së zonjës P. Vetëvrasja e papritun e Gjençit, vdekja e shpejtë e zonjës P., si ngjarje epizodike, me tragjikën e vet shtojnë efektin e kuptimit tragjik që ka Zaveri për dashuninë përgjithësisht, dhe i japin tonin filosofik këtij motivi, edhepse shquhet mjaft edhe toni sociologjik e moral i tij. Epizodat në lidhje me dy dashunitë e dështueme e shtojnë intensitetin e idesë së veprës dhe i kontribuojnë integralitetit të saj. Asht fakt se Gjoni duket boll i panatyrshëm në qëndrimin e tij ndaj këtij emocioni ma të fuqishëm në jetën e njeriut dhe orvatjet e tij që të na i faktojë pikëpamjet e veta ndaj dashunisë dhe femnës mbesin të pamotivizueme sa duhet. Nji konstatim i tillë duket aq ma paradoksal kur shihet se ai asht nji krijesë mjaft sensibile, që di të vuejë thellë n'Unin e vet, duke qa hallin e vetes dhe hallet e të tjerëvet. Prandej edhe mendimet e huajtuna nga aristofani, Shopenhaueri, Tolstoi, Niçe dhe thesari popullor arab e shqiptar s'mund të na bindin se qëndrimi i tij asisoji ndaj femnës asht rezultat i bindjeve të krijueme nga përvoja e të tjerëvet. Jo. Qëndrimi i tillë asht i kushtësuem nga rrethanat objektive dhe pikërisht këtu asht shkaku i vërtetë i indiferencës së tij ndaj sharmit e bukurisë femnore, që di t'i dallojë ma pikatshëm se të tjerët, dhe ndaj dashunisë përgjithësisht. Pozita opozitare e Gjonit ndaj dashunisë asht opozitë e krijueme apriori, për ç'shkak ai edhe përfill dashuninë shpirtnore platonike dhe mohon botën e ndjenjës fizike, ndjenjën e shkaktueme nga shqisat dhe kontakti.

Njerëzit pandehin se dashunija landore iu sjell kënaqsi — thot Gjoni — por ata në të vërtetë s'e dinë se vetëm e kanë autosugjestionue veten. Do të thotë se dashunija edhe për ta asht n'esencë vetëm nji iluzion, diçka që duket se ekziston e në realitet s'asht ashtu. Prandej edhe lektiset mbas dashunisë rinore, dashunisë së pastër dhe të pacënueshme fizikisht, në kohën e kërkesavet gjithnji ma të guximshme të civilizimit modern ndaj trupit të femnës. Edhe në fushën e dashunisë trimi ynë i shëmbëllen Diogjenit: e kërkon ate që mund ta gjejë, por s'e gjen, s'kënaqet me gjanat reale, porse me ato misterioze. Kërshërinë e tij e fton çdogja e fshehtë, fiktive dhe

ezoterike, prandej asht kundërshtar i trupit të femnës, e për çudë, asht kundërshtar edhe i hulumtimit të skutave të shpirtit të saj. S'shohim se provon ndonjiherë ta kuptojë botën e mbrendshme të femnës. Por, lumëmadhi Gjon, as në këtë mënyrë nuk e zbulon ate që e kërkon, ashtu sikundër nuk e gjet njimendësinë e jetës dhe vdekjes me dyshimin e tij. Cili asht shkaku i kësaj indiference të Gjonit ndaj femnës dhe dashunisë së saj? Po pranuem se ai s'e përfill dashuninë landore pa ndonji motiv të jashtëm, do të thotë shtrëngohemi të kërkojmë shkakun psikologjik. E shkak të tillë s'kemi. Asht i mirëpritun në çdo shoqni dhe i dashunuem nga femnat. E, dihet mirëfilli, se këto krijesa me intuitë dhe aftësi praktike për jetë të përditshme, s'kanë fije afiniteti të dashunojnë ndonji mashkull i cili tregon neshtrasha të çthurjes dhe defekteve psiqike. Jemi, pra, të shtrënguem të kërkojmë shkaqet e jashtme, normat dhe prangat shoqnore që e kanë kushtësue qëndrimin e tij indiferent ndaj dashunisë dhe martesës, e lidhun me këte edhe apatinë e tij jetësore. Këto norma janë kërkesat e moralit shekullor në fshat — në nji anë, dhe interesi që fut gishtin e vet edhe në dashuni e martesë — n'anën tjetër. Qe edhe nji nga arsyet e tjetërsimit të Gjon Zaverit nga shoqnija, nga jeta, nga dashunija dhe nga vetëvetja. S'ka dyshim, veprimet e tij janë veprime egoisti, individualisti, porse pikëpamjet e tij ndaj marrëdhanievet njerëzore, ndaj pasunisë, moralit e shoqnisë, ndaj miqsisë e, tekembramja, edhe dashunisë, janë pikëpamje që ia imponon moskënaqsija e prridhun. Qëndrimi i tij human ndaj disa kategorive të marrëdhanieve njerëzore e provon të vërtetën se egoizmi i cekun sipër zbehet para këtij qëndrimi.

Gjoni asht i vetëdijshëm se n'esencën e moralit, si të qytetit ashtu edhe të fshatit, ndaj martesës, qëndron interesi, prandej edhe revolta me askezën e tij mund të lidhen me neverinë që i shkakton profanosja e tillë e dashunisë. Meqenëse s'i di mjetet me të cilat do të luftonte kundër nji morali asisoji, shtrëngohet të tërhiqet në vetminë e tij shpirtnore dhe prej andej të kundrojë me pasivitet çnjerëzimin e bashkëkohasvet dhe keqpërdorimet e femnës shqiptare. I vetëdijshëm se në nji shoqni të tillë s'bahet martesë pa interes, prandej s'mund të ketë as dashuni

pa interes, trimi ynë vihet përballë asaj shoqnije dhe, në mos ndryshe, në mos me rebelizëm, bile me opozitë shpirtnore do t'i tregojë se nuk pajtohet me moralin e saj. Kështu ze fill edhe nihilizmi i tij.

Që në vogjli prindët e kanë fejue me Afërditën, kështuqë edhe martesa me te i imponohet në bazë të kanunit të pacënuem kurrë. E Uni i tij s'pajtohet me te, sepse sheh që motivi i kësaj martese konsiston n'interes. Së këndejmi rrjedh edhe gjykimi i tij se njeriu, mvarësisht nga rrethi dhe botëkuptimet e këtij rrethi tanësish, trajtohet i moralshëm apo i pamoralshëm. Kështu shpreh at dialektikën e moralit, të kushtësuem nga veprimi i individit dhe relacioni i tij reciprok me shoqninë dhe normat e saj. „Ti, o njeri, natyrisht edhe unë që po të shes aqë mend, nuk jemi veçse krijesa që qëndrojmë pezull ndërmjet ndershmënisë pa fill dhe pandershmënisë pa fund! Nuk jemi veçse të qenme të gjalla, që notojmë ndërmjet asaj që quajmë të vërtetë dhe asaj që quajmë gënjeshtër! Po e them këtë gjë, sepse duhet t'i marrim përpara syvet të dy faqet e njeriut e jo vetëm njerën, si bëjmë sot". Kështu mendon Gjoni dhe e sqaron qëndrimin e tij tue thanë që nëse nji njeri për nji ambient asht i ndershëm, meqë respekton ligjet e normat e tij, po ai njeri, për nji rreth tjetër tregohet i pamoralshëm, sepse mohon reliket e tij tradicionale, ose për arsye se nuk sheh vleftën e tyne etike, ose për arsye se lektiset për marrëdhanie ma humane ndërmjet njerëzvet. Deshti dhe s'deshti, njeriu qëndron në fushën e nji dualizmi moral dhe pasojisht kësaj asht në pozitë të mohojë, në nji anë, dhe të përkrahë e tumirë, n'anën tjetër. Rruga e konfliktit asht e hapët: e konfliktit me shoqninë dhe e konfliktit me vetëveten. Ai që pajtohet të kullandrisë kompromisin siguron mirëqenien dhe „respektin e shoqnisë", kurse ai që zen pozitë revolte asht i anatemizuem si djalli vetë. Zaveri, meqenëse i mungon energjija, vërgjilltësija, largëpamësija, meqenëse i mungon vrulli shpirtnor e fizik i nji njeriu t'akcionit, s'asht i vendosun, por i branis punët, prandej edhe Uni i tij vjen tue ra gradualisht në konflikt të dyfishtë: me shoqninë dhe me veten. Ndërgjegja e tij vuen pse shtrërngohet të pasojë zanin e traditës, normat etike të të cilës përsa i përket martesës janë prapanike, si dhe pse asht i vetëdijshëm se cilat duhet të jenë

motivet e nji akti aq të randësishëm për gjininë njerëzore. Ai pohon se martesa duhet të jetë nji akt plotësisht i lirë, prandej asht edhe kundër atyne që prihen nga paragjykimet, ashtu edhe kundër atyne që prihen nga interesi. Sa u përket virtyteve të njeriut asht i bindun, ashtu sikundër edhe për të gjitha vetitë e tjera, se ato nuk janë privilegjë e shtresave të zgjedhuna, privilegjë e qytetarëvet, porse i takojnë çdo njeriu pamvarësisht se ku jeton dhe në ç'gjendje materiale asht, vetëm nëse asht i moralshëm dhe fisnik. Bujarija mund ta stolis si qytetarin ashtu edhe fshatarin; bile, bile, në thaçim të vërtetën, fisnikërija dhe begatija shpirtnore e morale janë ma parë veçori e fshatarëve të pazvetnuem nga shum dukuni të civilizimit depërtues. se sa të qytetarit, i cili në luftën e pamëshirshme për fitim bjerr cilësitë ma të bukura të njeriut. Ja edhe nji grusht turinit të borgjezit, apo miniaturës së tij. „Fisnikërija nuk e ka vëndin as te nami i stërgjyshërvet as te pallatet madhështore, as te pasuria, por mbrenda në shpirtin e njeriut". Morali, pra, qenka emanacion i jetës së mbrendshme, prandej Zaveri asht i mendimit se do t'ishte ma mirë që „i dituri të martohet me një të paditur, sepse i padituri a e paditura kanë nevojë për një mësonjës të përditçëm, që të përmirësojnë jetën". Këto janë ndër argumentet kryesore që na parashtrohen me qëllim që të besojmë se motivet e refuzimit të tij për t'u martue me Afërditën s'kanë të bainë me origjinën e saj, meqë Gjoni asht edhe vetë fshatar, mandej as me bamuninë se ajo asht e pashkollueme, e ai njeri thueja me kulturë të naltë. Shkaku qëndron gjetiu: ai s'e përfill dashuninë trupore, por vetëm ate ideale, platonike, sepse: të parën e lidh me interes, kurse të dytën me të gjitha aspektet etike njerëzore. Meqenëse dashuninë e vërtetë s'e ka përjetue, e as që shpreson se do ta përjetojë, pandeh se s'ka nevojë për pretekste të tjera. Shkaqet e asketizmit të tij mund të jenë dy farësh: psikologjike dhe sociale. Në planin psikologjik shkaku s'asht zbërthye fare (mjerisht, autori s'asht përpjekë ta ndriçojë protagonistin e vet edhe nga ky aspekt), anipse edhe ky mund të lidhet me ate social, duke qenë i kushtësuem prej tij. Nji çashtje duhet pasë prore përpara syvet: Gjoni asht njeri human, altruist, prandej kërkon që njeriu i cili e dashunon njiherë femnën, ta dashunojë nga-

hera: edhe si të re, edhe kur të plaket — sepse ky asht kushti i domosdoshëm për nji harmoni ndërmjet mashkullit dhe femnës. Edhepse nji konstatim i këtillë duket pakëz paradoksal dhe kontradiktor, asht e vërtetë kjo se ai e respekton femnën ma thellë dhe ma sinqerisht se sa të gjithë moralistët e kohës, prandej edhe marrëdhaniet për të cilat ban rropatje ky janë njerëzore, të shëndosha, të lira nga interesi, qoftë edhe ai trupor — por ato ekzistojnë vetëm në vizionin e tij.

Edhepse ekstrem n'askezën e tij, qëndrimi i Gjonit duket ma i denjë dhe ma i drejtë se sa i atyne që janë në gjendje ta përulin këtë krijesë me veprimet e veta edhe ma ekstreme e jonjerëzore. Sjelljet e tij ndaj secilës femën, madje edhe ndaj Afërditës, janë sjellje të nji humanisti dhe skofiari. Pamja fizike, origjina, baza materiale s'luejnë dot farë roli për këtë altruist të madh, i cili edhe në këtë pikëpamje zen pozitë tjetër në krahasim me të tjerët.

Bie në sy se vuejtja e Gjonit s'imponohet si vuejtje cytjesh psikologjike, por sociale; vuejtja e tij s'i shëmbëllen vuejtjes dhe kotësisë së Mersos[1]) apo të Stivenit[2]), porse asht nji vuejtje e posaçme, e shkaktueme nga kotësija, nga tëhuejsimi i njeriut në nji ambient të katandisun në pikëpamje sociale. Edhepse nuk e shquen revolta e trimit t'absurdit, ai digjet, qetazi në shpirt, e kio flakë e prridhun asht simptom i nji revolte të prridhun. E habit shum hipokrizija e njerëzvet; s'kupton çka cmon njeriu ma shum: shtazën që ia ban tana ato shërbime, apo pëllumbin që jeton si parazit. Prandej i pëlqen konstatimi i Polës: „Njerëzija i falet atij që korr e jo atij që mbjell!" Asht i pataksun nga sjelljet e atyne që përjashta, në sy e faqe të botës, i bainë grues nderime, tue u sjellë me skofi e kuides ndaj sai, kurse në shtëpi, gjatë jetës së përditshme, kur vërtet duhet të vijë në shprehje qëndrimi i tyne i saktë ndaj saj, e urdhënojnë pamëshirshëm, e keqpërdorin dhe e shqelmojnë. Shkaqet e kësaj hipokrizije, këtij qytetnimi të rrejshëm, duhet kërkue shi në bazën e martesës — interesin. E thembër Akili e moralit asht mu martesa që sjell probleme sociale e

[1]) Protagonist i romanit të Kamysë I hueji.
[2]) Protagonist i romanit të Xhoisit Uliks.

etike. Nga ky aspekt edhe Gjoni, me rastin e martesës, zgjedh nji rrugë që sadokudo e then at vazhdën shekullore, mbasi pandeh se, mos qoftë në gjendje t'ju ndihmojë me shembullin e tij bashkëkohasvet, bile së paku „të mos u bajë dëm", gja që përputhet me pasivitetin e tij të përgjithshëm në jetë. Ndërkaq, habitet edhe nga ekstremiteti tjetër: disa njerëz janë në gjendje ta fetishizojnë femnën dhe ta ngrisin përmbi autoritetin e mashkullit në kohën e depërtimit të disa normavet të moralit europian. Në nji kësi dualizmi etik ai s'di t'orientohet — e vjetra i duket e shkelun ma nga koha, kurse e reja tepër e shpejtë pikërisht me anën e saj negative, dhe pushtuese e kualiteteve të trashëgueme. Së këndejmi vjen në gjendje të çuditshme dhe s'di për çka o për ke të kapet: ngel në vakuum. Si takon kësaj as asaj ane, mbetet njeri fillikat, pa kurrfarë baze reale. E të tillë kishte shum, por fillikat në mënyra të tjera. Prandej e marrim simbol të kotësisë dhe njeriut të tëhuejsuem.

E dashunon e shoqja e Petrit, e dashunon Pola, e dashunon Afërdita. Por, ky s'e dashunon asnjanën sosh: të shoqen e Petrit — ngaqë çmeritet kur mendon se si nji femën shqiptare asht në gjendje ta tradhtojë të shoqin, pa ndonji arsye të dukshme përpos për huqe femnore; Polën — ngaqë s'e kupton lirinë dhe guximin e vashës shqiptare me ç'shquhej ajo; Afërditën — ngaqë s'përfill shpirtnisht zakonet e vendit; që të trija — ngaqë s'përfill dashuninë landore, veç ate fiktive, iluzioniste.

Në rastin e dy të paravet ai sheh, pothuej, njifarë zvetnimi moral të shoqnisë; sa ma tepër i qasen aq ma tepër i duket se vjen në shprehje egoizmi dhe qëllimi i tyne utilitar. Si bir fshatari asht mjaft skeptik ndaj depërtimit të liberalizmit në moralin e njerëzvet, e sidomos të femnës dhe s'pajtohet kurrsesi me shkatrrimin e disa vlerave etike, ndonëse ca prej tyne s'janë ruejtë kurrë as në fshat. Si futet n'ambientin e qytetit kupton se sa i madh asht roli i pares dhe tralliset nga nji konstatim i tillë. „Po! Sa mynxyrë e madhe është në shekullin tonë kur mendoj se njeriu është bërë bar, kurse paraja dhëmb, në vend që duhet t'ishte e përkundërta! Edhe tani nuk e teproj aspak kur them këtë të vërtetë të hidhur: Që të gjithë njerzit e kësaj Bote i shoh me nga një shportë

egoizmi në krye. Barku nuk është gjë tjetër veçse qëllimi; shporta-egoizmi është ideali i sotçëm intelektual dhe strajca — interesi është ura që bashkon barkun me egoizmin; a po ta themi mbas hipokrizës së sotçme intelektuale: strajca — interesi është ura që bashkon qëllimin me idealin... „Ja grushti tjetër që i jipet ndjenjës borgjeze, por tani mu në pikën e saj ma të dobët. Në nji këso babillonie interesash, vorfnije intelektuale e krize të përgjithshme të ndërgjegjës ai s'i di vetes tjetër shpëtim pos hermetizmit shpirtnor dhe kredhjes në nji botë efemere ku të tjerët, pandeh, s'mund t'i qasen. I okupuem nga bota e tij subjektive edhe ky, pëkundër dashunisë që ushqen për të gjithë njerëzit dhe për çdo krijesë të gjallë, shquhet si nji individualist, i paaftë për sakrifica, shquhet si nji egoist i pushtuem nga imagjinata dhe bota vetiake. Njeri i flashkët me veprime, kurse me mendimet e veta i çkepun, s'asht në gjendje të përqafojë të renë, konturat e së cilës, sado të zbeta në fillim, e të papranueshme për nji rreth konzervator, prap shquheshin dikund në horizont, por as ta mposhti vendosmënisht të vjetrën që, shihet sheshazi, s'i pëlqente dhe kishte humbë çdo simpati e ndoshta edhe tolerancë ndaj saj. Ja kështu ky burrë i tretun orvatet të gjejë, a së paku t'i krijojë vetes, iluzionin e lirisë personale, lirisë në kuptimin rusoist të fjalës. Meqaket por s'e gjen, së këndejmi me nji indiferencë të cuditshme i dorëzohet dëshirës së prindëvet, të cilët e martojnë me Afërditën — për të pasë grue pune, grue rangësh, grue që pret e përcjell mysafirët simbas traditës së kahershme. Në këtë mënyrë i dorëzohet aktit nga i cili reshtet që prej fillimit. Gjoni përbuz interesin, përcmon qytetarin i cili e shikon gruen e ardhshme në prizmën e prikës që ka, përcmon zakonin për shkak të të cilit katandis fshatari kur marton të birin ndërsa përdëllen vashën në të dy rastet, meqë asht viktimë e keqpërdorimeve të mashkujve të koruptuem. Ai vetëm në këtë rast ngrit lart zanin e tij të heshtun dhe i drejtohet femnës shqiptare „ta formojë lumturinë me zemër, e jo me para", meqë asht koha që edhe ajo të duket e gjallë. Po, ky Gjon lumëmadhi, ky djalosh që aq sa e mëshirojmë aq mund të jemi edhe indiferent ndaj tij, sa e respektojmë aq mund ta përbuzim, sa e urojmë aq edhe mund ta mallkojmë, hesht para urdhënit të babës dhe

martohet me Afërditën, i vetëdijshëm se rruga së cilës ishte nisë, e shpiente drejt katastrofës. Zakoni e bani të martohet e kurrsesi zani i shpirtit të tij. E zani i shpirtit të tij kurrsesi s'asht za i nji harmonije të mbrendshme, por i nji shqetsimi që s'gufon përnjiherësh, veç digjet mengadalë, qetazi dhe aq ma zharitshëm për at shpirt.

„Kryetari, mbasi lëçiti aktin e celebrimit, na kërkoi pranimin tonë. Unë me gojë plot dhe i qeshur i u përgjegja: E d u a!" Ndërkaq, Afërdita, kur i vjen radha për t'u deklarue, „duke unjur kokën edhe më tha nëpër dhambë e si nënë tokë: „P... o!" Kjo fshatare, pa pompë e ngërfosje, por thjesht, përvuejshëm, njashtu sikundër asht e përvuejshme tanë jeta e saj, e shpreh dëshirën nga e cila asht djegë vjet me radhë; e shpreh thjesht, por thot shum, edhepse nji përgjegje e tillë i imponohet, ndoshta, nga shkaqe të ndryshme; kurse ai, djaloshi i kulturuem, deklarohet, gjoja tanë shend e verë, tue përdorë nji fjalë kuptimi të naltë — e, thot nji ndër gënjeshtrat ma të mëdha dhe ma mëkatnore në jetën e tij të shkurtë. Konsekuent në pikëpamjet e tij pesimiste ndaj botës dhe totalitetit jetësor, ndaj natyrës, moralit, njeriut dhe femnës, e kësaj here inkonsekuent ndaj vetëvetes. Indolenca e tij jetësore shprehet edhe gjatë aktit të martesës. Edhe ceremonija e fundit asht e tanë në tonin e tij të ngrysun. Nji përgjegje e këtillë mund t'agitohet që përpara. Po të thonte — s'e due — atbotë s'do t'ishte Gjon Zaveri, sepse do të çfaqte haptazi revoltën e tij, aktivizmin shpirtnor për të çue deri në fund fjalën. Mandej do t'i shtrohej përpara imperativi i jetës. Mirëpo, ndienja e luftës për ekzistencë s'asht veti që e stolis ate. Së këndejmi ..e dua" asht gënjeshtër para vetes, por gënjeshtër që s'i shkakton valë atmosferës së tij apatike. Edhe në këtë çast mendja i shkon gjetiu, „jo për dasmën, por... për njëmendësinë e dasmës". E njimëndësija të cilën e kërkon ai shqet nga hiçi. Gjatë ceremonisë së martesës atij i fluturon mendja tek jeta që do të ketë me Afërditën dhe purteket kur e mendon mëkatën që do ta bajë në kontakt me ate që s'e dashunon me ndjenjë të çiltërtë e abstrakte. Me sjelljet e tij tregon se nuk pranon nji varg adetesh, me ç'rast demoralizon brezin e vjetër dhe u hyn në qejf të rijvet. Megjithë ngurimin që ndien ndaj dashunisë

landore, në fund ai, sikurse çdo krijesë tjetër e gjallë, i nënshtrohet ligjit jetik të natyrës dhe evolucionit dhe kapitulon me tanë konceptin e tij filosofik idealist mbi dashurinë e martesës para Afërditës, që spikatet me afsh jetese. Në këtë mes i bahet se profanos idealin e tij astral dhe hapat që e shpiejnë drejt tragjedisë vijnë tue u shpeshtue. E cilin ideal ka profanosë? Të vetmin që kishte: idealin e dashunisë rinore-fiktive, e cila ngel sekret për te. Në planin e persiatjeve ngel pa rezultat, në planin e jetës poashtu pa rezultat.

Gjoni i jep fund ditarit natën e martesës. Ideali i tij dështon prandej përse të lodhet tutje?! Tani e merr fjalën autori dhe në nja pesë a gjashtë faqe i përshkruen ditët e fundit të protagonistit të vet, tue e shty vetëdijshëm nga vetëvrasja dhe, për të qenë gjoja ma i bindshëm, sjell letrën e tij të fundit, si arsytim për vetëvrasje. Nga letra shihet se atmosfera e jetës intime të trimit tonë vjen tue u terratisë. kurse temperatura tue u shtue. „U — ngop me nusen e re mbrenda një jave" — thot Spasse. I ngopun me të gjitha dhe me asgja, i shpërblyem me respekt dhe përçmim, i tretun në fluromën e nji jete të rrejshme, pa bazë nën kambë e pa perspektivë përpara, horizonti i tij errësohet vrik kur lëshohet perdja e tragjedisë. Gjon Zaveri ban vetëvrasje.

IV

Tragjika e Gjon Zaverit si njeri gati asht e barabartë me tragjikën e tij si tip letrar. I mallkuem nga kritika, i mallkuem nga moralistët, i mallkuem nga pedagogët, ai pothuej u përjashtue nga bota e librit. Përse e anatemizuen lumëmadhin? Vallë, a vetëm pse vrau veten-a? Ma parë për arsye të shkakut të vërtetë për të cilin bani vetëvrasjen. Kritika e kohës gjen me keqardhje elemente të mendimit materialist në konceptin e tij filosofik. Aty-këtu shihen edhe elemente ateizmi. Ndërkaq, si problem në vete shtrohet mu vetëvrasja e tij. Njeriu çon dorën kundër vetes atëherë kur në shpirtin e tij thehet diçka e randësishme, kur i këputen lidhjet me veten dhe me botën e jashtme, kur i sheh të përmbysuna idealet njiherë e përgjithmonë. Tue vra veten ai vret edhe vuejtjet e veta.

Gjoni ka lindë dhe asht rritë n'ambientin e fshatit, ndër njerëz fetarë por, megjithate, fenë gati asnjiherë s'e ze ngojë. Kur mbytet Gjençi shohim se vdekjen e tij e komenton me fjalët e nji ateisti, tue thanë se ka vdekë prej ujit e jo prej zotit. E pastaj edhe vetë zgjedh nji vdekje të tillë — prej ujit. Gjençin e shohim njeri të praktikës, jetës — ban vetëvrasje; Gjonin njeri t'imagjinatës dhe abstrakcionit — ban vetëvrasje. I pari për shkak se s'mund të vendosë harmoninë me rrethin e vet; i dyti për shkak se s'mund t'ekzistojë në nji botë ireale, të cilën e ka krijue me fantazinë e vet për t'ikën nga realiteti që Gjençin e shtyn të bajë krim mbi veten. Do të thotë shkaku asht i njajtë për të dytë. „Gjençin mirë ç'e gjeti" — thot Gjoni kur ndëgjon për fatin e shokut të vramë nga shkaqet e dashunisë, hiçit, si thot ai. E përse mandej ban edhe vetë vetëvrasje? Për shkak të dashunisë — jo! Këte e mohoi tue dënue aktin e shokut. Pranon vetë, pra, se shkaqet janë të tjera. I quejtëm shkaqe origjine sociale e morale. Dis-harmonija në mes të vizionit të tij dhe realitetit i shkakton dëshprimin dhe katastrofën. Por, vetëvrasja e tij ka edhe kuptim filosofik. Ai s'asht i sëmundë psiqikisht dhe psikiatrit s'do t'ishin në gjendje t'i caktojnë ndonji diagnozë të preme. Vetëvrasja e tij asht mohim: mohim i zotit dhe fesë. Nuk e shohim t'i falet as t'i lutet kujt. Nuk e shohim si e përjeton çastin e fundit. Jeta e tij fillon nji natë t'errtë, kur gjimon e veton, kur fryn nji erë e stuhishme dhe valët e liqenit çohen malamal: fillon në vetmi. I vetmuem edhe vdes. N'ju dashtë kujt efekti pedagogjik tek e ka: shkrimtari na thot të mos e pasojmë rrugën e tij në nji mënyrë mjaft të bukur. „Fshatarët e varrosnë me nderime të mëdha intelektualin e tyre të vetëm, por në vetmi". Në vorrin e tij të thjeshtë" nuk ka as emër, as datë e as shenjë..." E në vetmi, izolueshëm të tjerëvet, vorrosen ata që janë të mallkuem.

Vetëvrasja e Zaverit, sikundër vetëvrasja e Kirilovit[1]), asht në kundërshtim me zotin, me fenë, dhe do të thotë mohim i tij, respektivisht i saj. Frika që ndien Zaveri para hapsinës së paskajshme s'asht frikë

[1]) Protagonist i romanit të Dostojevskit Shpirtnat e këqij.

nga zoti, por ma parë frikë e nji ateisti të vetëdijshëm se vdekja asht ajo finalja tragjike përtej së cilës ekziston hiçi.

N'anën tjetër asht e çuditshme gjakëftohtësija e Gjonit mu para aktit të vdekjes. Ndoshta edhe në këtë mënyrë, tue mohue frikën që ndiejnë njerëzit e devotshëm prej vdekjes, mohon ekzistimin e zotit. Vdekja asht e detyrueshme, prandej përse ta bjerrim dinjitetin dhe të përulemi para këtij imperativi — kështu disi mendon ai. Vetëvrasja, thot Moris Blansho, i shtron pyetje jetës: a asht e mundshme jeta? Këtë pyetje e shtron meqë ai cili vritet mund të jetojë ende. Këtë pyetje mund ta shtrojmë edhe në lidhje me Gjonin. A ka pasë mundësi të jetojë akoma? Për ta shpëtue nga vetëvrasja, shkrimtarit do t'i duhej edhe nji vepër e tanë dhe, kush e di, a do ta shpëtonte edhe dinjitetin e tij.

Që të mos keqkuptohen konstatimet e sipërme, duhet theksue se nuk e shpall Gjonin hero — akti i tij s'asht akt trimnije. Porse, nji njeri i cili në jetë prihet vetëm nga truni dhe mohon tanë bukurinë e ndjenjës, tue krijue kult askeze, s'mund të ketë ndonji finale ma të mirë. Na s'mund ta gjykojmë pse asht i tillë, as pse asht njeri pasiv, anemik, steril. Ai asht prodhim i nji momenti historik. Në karakterin e Gjonit mund të pikasen edhe tipare ekzistencializmi, prandej imponohet pohimi se krijimin e këtij tipi në letërsinë shqipe e kanë kushtësue klima e vendit dhe rrymimet e mendimit europian ndërmjet dy luftave botnore. Pesimizmi në këtë kohë karakterizon jo vetëm letërsinë, por edhe filosofinë. „Teksa të lind, njeriu asht mjaft i vjetër për të vdekë", ose „njeriu asht brengë për shkak se asht tranzitor". Kështu e formulon Hajdegeri kuptimin e ekzistencës së qenies njerëzore në kohë e hapsinë. Problemi i vdekjes trajtohet prej shum shkrimtarësh. Ajo asht brengë dhe s'i len të qetë shumicën e tyne. Këtë shqetsim të njerëzvet gati ma së miri na e tregojnë fjalët e Mishel Lerisit: „Atëherë akoma s'pranojsha se ajo që e shtonte edhe ma zi tërbimin tim kundër jetës s'ishte determinizmi që na e imponojnë ligjet natyrore e shoqnore, por vetëm vdekja..."

Gjon Zaveri asht tip specifik i letërsisë shqipe. Si i tillë duket i kurdisun, i pabindshëm dhe, ndoshta, i rrejshëm. Por asht specifike edhe klima në të cilën

ka lindë e asht rritë ai. Lektisja e tij që t'i kthehet sa ma shpejt nanës-natyrë tregon se jeta vetë ban selekcionin e krijesavet: e afta me gëzim e optimizëm vazhdon jetën, kurse e plogështja zhduket parakohe në dialektikën e saj. Jeta dhe vdekja e Gjonit sikur e përkujtojnë lexuesin: s'jetohet veç me mend, por edhe me ndjenja. Prandej, vetëvrasja e tij, e shikueme nga perspektiva historike, e afirmon këtë tip të letërsisë shqipe, ashtu siç thuhet se e afirmon revolta trimin e absurdit të Kamysë. Autori ndoshta ka heqë dorë nga P s e-hi, së këndejmi edhe e ka shkrue A f ë r d i t ë n diametralisht të kundërt me te përkah esenca e pikëpamjeve jetësore. Mirëpo, çdo vepër letrare, me të dalun në dritë, shkoqet nga krijuesi i vet dhe vazhdon jetën pamvarësisht prej qejfit të tij. Ajo bahet njifarë objekti. Si realizim artistik romani i Spasses asht i huej për lexuesin e sodit, e si pasqyrë e nji kohe të caktueme ka vleftën e vet. Ndërkaq, opusit edhe ashtu të gjanë t'autorit i jep përmasa edhe ma të mëdha.

Tue shkrue për poetët dhe poezinë, Bloku, në nji vend, thekson se, sikundër as vdekjes, njeriu i gjallë s'mund t'i ikën shenjës që len poezija në kalimin e vet; njeriu, shton ai, s'mund t'i lakojë as emnit që jep ajo, kur çfaqet nevoja. Simbolisti i njohtun di se poezija asht e kushtësueme nga koha dhe rrethanat shoqnore, porse, tue i vu vulën asaj kohe, ajo ushtron ndikimin e saj në botën njerëzore. Kështu, edhe kuptimi i saj shton vlerën që ka, sepse ngërthen në vete funkcionin shoqnor, në nji anë dhe ndikesën emocionale, n'anën tjetër. Përvoja që sublimon nuk përcillet në trajtë aksiomash shkencore, por krahas përjetimit ndjenjor. Në këtë mënyrë domethania e poezisë iu qaset ma lehtë njerëzvet që janë përherë objekt dhe qëllim i saj. Poezija ngjall asociacione, e lidh me to edhe emocione, në saje të mjeteve të veta me të cilat e hulumton të vërtetën e njeriut, kohës, shoqnisë, kuptimit dhe qëllimit jetësor. Sot ekziston nji numër poetësh që mejtojnë se shekujt e afekcioneve dhe bukurisë së transformacionit emocional kanë kalue njiherë e përgjithmonë dhe pohojnë me ngulmë se metafora tok me figurat e tjera stilistike përmban tanë kuptimin e poezisë moderne. Mendimin e tillë mëqaken ta provojnë me veçoritë dendun ekstreme të romantikëve dhe qëllimisht harrojnë të vigjilojnë se arti i fjalës, si edhe çdo art tjetër, në plan të parë ka komunikimin me njeriun nëpërmjet t'asociacionevet që ngjall tek ai. Kuptohet se ndjenja nuk asht tanë bukurija, porse kjo asht rezultat i saj. E buku-

rija nuk asht vetëm harmonija e formës. Ajo implikon edhe përcjelljen e përvojës, kuptimin, domethanien. Poezija nuk asht vetëm fjalë, muzikë, tonikë. Nji qëndrim i tillë shpie në pozita idealiste. Kur Ofelia e pyet Hamletin: „Me se, Imzot, munt të ketë bukurija marrëdhanie më të mira se sa me nderin?" ai i përgjigjet premas: „Po, pa fjalë; se fuqi e bukurisë mund t'a transformojnë nderin në panderësi më shpejt se sa forc' e nderit t'a kthenjë bukurinë në shembëlltsi të tij; kjo ka qenë paradoksale një herë, po tani koha e provoj të vërtetë." Mos do të thotë kjo se ndjenja që ngjall arti, në saje të bukurisë së vet, asht në gjendje ta kthejë nderin në panderësi?! S'do dyshue fare. Secila punë e njeriut, e veçmas krijimtarija artistike kërkon nji sensibilitet të hollë, nji pasion dhe përkushtim shpirtnor, sepse vetëm me tru asht vështirë të përjetohet bota, e madje as të njihet. Arsyeja dhe mprehtësija e ndjenjës me intuitën janë elemente që përbajnë bazën gnoseologjike. Nuk di a mund të ketë ndonji poet që s'ndien shpirtnisht se poezija nuk ka të bajë me ekzaktësi çfarë, për shembëll, i cilëson shkencat e ndryshme, porse konsiston në njohjen intuitive dhe emocionale, në të kuptuemit e dukunive të ndryshme jetësore, njerëzvet, marrëdhanievet ndërmjet tyne dhe raporteve mes tyne dhe natyrës. Po të provohej shtruemja e mendimit se vetëm trajtimi i këtij përjetimi ndjenjor asht i mjaftueshëm për të krijue poezi, s'ka dyshim se njeriu do të binte në pozita hedoniste. Imponohet vetëvetiu respektimi i kërkesave poetike dhe përdorimi i mjeteve sa ma të qëmtueme për t'u përcjellë ideja. E nga nji harmoni e tillë që në qenësinë e vet ka përvojën e pasun, kurse si rezultat doemos i çfaqet respekti mirënjohës në formë të lidhjes emocionale për at krijim, del poezija që ngulitet në kujtesën e njeriut. Ndoshta kjo përvojë e begatshme për të cilën po bahet fjalë asht mu e vërteta, të cilën Rene Shar e identifikoi me vetë poezinë. Por, dihet se përvoja e vërtetë nuk mund të kanalizohet tjetërkah njerëzisht përpos drejt të vërtetës. Ajo sedimentohet vjet me radhë nga fuqija e përjetimit të realitetit dhe e kuptimit të dukunive dhe çfaqjeve të ndryshme jetësore.

Hasen krijime poetike që shikue mvarësisht nga përfillja e kërkesave dhe aksiomave estetike, nuk mund t'iu bajë vërejtje as esteti ma i shquem, porse,

megjithate, sa i përket përvojës që sjellin me vete, janë të tejdukshme. Ndjenja e zgjueme dihet se e angazhon gjithmonë edhe trunin e njeriut. Së këndejmi mund të thuhet se fryti i parë i nji sajimi poetik asht kontakti emocional dhe mendor që ven me lexuesin e që humb a fiton në shkallën e intensitetit të vet mvarësisht nga fuqija e përjetimit të krijuesit dhe përvoja që sjell me vete. E këtë përvojë tani e marrim të mundshme apo të pamundshme mvarësisht nga fuqija sugjestive me të cilën asht shprehë.

Natyra ka ligjet e veta, dhe, ndonëse njeriu natyrën e ndryshon, ligjet e saj vetëm mund t'i konstatojë. Edhe poezija ka ligjet e saj, por poeti këto i ndryshon tue ia përshtatë elementit të vet. Së këndejmi quhet edhe arti ma subjektiv në nji objektivitet trajtimi të njeriut. Racionalistët thojshin se mendojnë prandej ekzistojnë, kurse poeti mund të shtojë edhe këtë: ndiej e mendoj, prandej mund të krijoj dhe ekzistoj. Tue depërtue n'esencën e dukunive të ndryshme shtohet ekuivalenti artistik i nji sajimi e me këtë edhe ai emocional, si rezultat i këtij fryti. Lexuesi s'ndien dhe s'ndalet të persiasë kur sheh nji rrasë shkambi të ftohët, mbasi kjo mund mos t'i sjellë farë asociacionesh, ndërsa i bashkohet poetit kur ky në poezi fut edhe ngrohtësinë e zemrës.

*

Enver Gjerqeku asht nji prej poetëve tanë që krijimtarisë së vet ia dhuron ngrohtësinë dhe përvojën jetësore. Disa nga poezitë e tij sublimojnë nji përvojë të gjanë dhe shquhen me refleksionet e tyne kuptimplote. Në këtë kontekst, poezija N ë s e që cilësohet përkah theksi mendimtar dhe harmonija e plotë e impresionit dhe ekspresionit mund të na tregojë nga ecën krijimtarija e tij në kohë të fundit. Opusi i interesimit të tij kap dukuni, forma dhe kuptime të ndryshme jetësore. Asociacionet për persiatje ia cysin ora, xixëlloja. skyferi, marimanga, ujëdhesa, bleta, bari, shelgu, blini — këto nominalie që përfshijnë kuptime të florës, faunës, kohës dhe hapsinës. Të gjitha ato janë ba skelete të mendimeve të tij rreth jetës, njerëzve dhe virtyteve e veseve të tyne. Nëpërmjet të tyne hulumton vetë kuptimin e ekzistencës. Ca prej

tyne, të përdoruna kryesisht si metafora, kanë arrijtë të bahen simbole. Nëpër shendjet e poetit sipërfaqes së natyrës duhet kërkue metaforizmin e lidhmënisë së njeriut me te. Derisa skyferi asht ai gjykues e arbitër i pameshirshëm i krijesave të ndryshme që zvarnisen qetas sipërfaqes së dheut, ashtu sikundër mund të jetë i tillë edhe njeriu që rastisja historike mund ta ketë vu në piedestal skyferi, marimanga asht nji nga krijesat e tokës që zotësinë dhe vleftën e vet miniaturale i shndërron në dredhi e veprime të paskrupulla. Derisa skyferi metaforizon krenarinë e patundshme, meqë naltësija e pacënueshme dhe e sigurtë i japin guxim e mundësi të pandeh se thojt e tij janë shpatë mbi kokën e çdokujt, marimanga asht antipod i tij. Derisa skyferi ua fut me mner klithjet e tij njerëzvet në palcë të kurrizit, sepse zani i tij gëzon mbrojtjen e naltësisë së tij, marimangës i duhet të përdorë mashtrimin, sepse fuqija e determinon ekzistencën e saj. Kësisoji, vetë situata jetësore e sjell në pozitë të zvetnohet, prandej ajo kërkon shum e ma shum dhe s'di kurrë të ngihet. Me pak cenet e saj vetëm ngacmohen që të gllabërojë edhe ma, kështuqë edhe rrjeta i rri prore e ngrehun. Ndonëse gjakpirës, skyferi asht kryenaltë, porse kjo veti s'ia pakson mëkatat dhe mëninë e zgjueme tek viktimat e tij. Marimanga asht pshikatare, sepse ajo di t'u vejë pusi sall të dobtëve. Në mungesë të fuqisë zhvillohen „kualitetet" e tjera jetësore si kompenzim natyror i tyne. Marimanga aq e vogël, aq e mjerë, aq e paskofi, aq e lebetitshme „lakmon diellin në kambët tueja me e shti" prandej asht e kuptueshme përse nuk i zgjedh viktimat e veta.

Enver Gjerqeku iu drejtohet bashkëkohasvet me disa prej poezive të veta dhe përpos njerëzvet, i flet edhe kohës. Afinitetin e vet për refleksione ai ma së miri e shpreh në poezinë e përmendun N ë s e. Këtu sikur asht sublimue përvoja dhe qëndrimi ndaj shum dukunivet jetësore. Mendimet dhe persiatjet e poetit janë shtrue në trajtë alternative, kurse pikëpamjet e tij s'imponohen ndryshe përpos me kuptimin etik rreth qenies njerëzore.

Kur nji qëndrim shprehet nëpërmjet të fjalës n ë s e, kjo do të thotë se të rekomandohet porse nuk t'imponohet — në rastin konkret ashtu e kemi. Njeriut i reko-

mandohet spontanisht zgjedhja e asaj që i duket se mund të jetë ma e dobishme, apo ma e ndajqasshme. Ndërkaq, i rekomandohet tekembramja edhe ajo që mund t'i lajë pasoja ma të vogla. Nëse zemra lektiset pas syvet e nuk mund ta dijë se ç'vullkan a akullnajë fshihet mbas tyne, e ka ma mirë me nënqeshje t'i gjejë folenë e strukjes zhgënjimit të vet shpirtnor. Në persiatjet e strofës së parë mund të pikasen nuancat e dyshimit total që përvidhet vetëdijshëm gjatë tanë sonetit. Vallë, a mund t'i thonë këtij qëndrim agnostik para transformimeve të çuditshme, para minikrisë së njeriut të sodit?! Kjo ishte porosija e parë.

Nëse lektisjen e zemrës e përcjell loti, ai lot që në të shumtën e rasavet asht prodhim i artistit të ganduem nga dëshira e zjarrtë që të korrë duertrokitjen e adhurueme, ma së miri asht të themi se shëmbëllyeshëm artistit të përmendun po rrjedhin edhe lotët tanë. Sepse, kujtimet tona s'na lidhin për prezentin veç për ndonji të kalueme të jetës sonë. E koha e kalueme asht ajo perdja ma e sigurtë për t'i strehue ngjyrat e prezentit. Kjo do të thotë se me ndihmën e pretekstit mund t'arrihet të kthehet rishtazi pesha e pikëllimit në venë, në gazmend. Kjo ishte porosija e dytë.

Mirëpo, nëse ndodh të fitojmë në jetë farë simpatije a të vejmë ndonji miqësi në mënyrë të lehtë, pa kurrfarë pocaqisjesh, poashtu lehtë fitojmë edhe përgëdheljet, uratat, miklimet, përgëzimet e dhurimet. Porse jeta e tregon nji të vërtetë: asgja e vlershme nuk mbërrihet sipërfaqes së lëmuet: rruga e së mirës shtrihet malamal. Dashamirësija, pa nji pa dy mund të kthehet n'antinomi të vet, njashtu sikundër përgëdhelja që mund të bahet shuplakë. Sepse, „Ku ka gas tepër, ka dhe helm të mprehtë. Gas bëhet helmi; helmi gas krejt lehtë", na thot i madhi Shekspir në përkthimin e të madhit Nol. Kështu mund të formulohet porosija e tretë e poetit. Ajo e spikat dialektikën e marrëdhanieve ndërmjet njerëzvet. Çdogja, e edhe dashunija, apo format e tjera të raportevet ndërnjerëzore pësojnë të kundërtën e trajtës së përparshme. Po: çdogja panta rei.

Nëse jemi të prirun ta kalojmë nji pjesë të jetës, ose pa ba përgjithësime, bile ndonji çast jetësor, n'andërra e përhimje të ndryshme, që nuk janë të

lidhuna për objekte të kandshme e të hareshme, ma së miri do t'ishte mos të kërkojmë gjenezën flurore të pikllimit, meqë kujtesa dendun bahet shkak i helmimit të shpirtit të njeriut. Kësisoji kujtimet dalin bukur shpesh si motive pezmatimesh, cfilitjesh e dërmimesh mbasi loti, lektisja, përgëdhelja — që u përmëndën sipër — nuk mund të bahen prezent, por vetëm perfekt. Dora që ban mrekulli s'ia del t'i çfletojë fshehtësitë. Kjo asht punë e intuitës, e imagjinatës së papengueme. Tekefundit, të kaluemen s'duhet shoshlue shum. Lene ku asht, të del ma mirë. Kësaj do t'i thojshin porosija e katërt.

E. nëse njeriu s'asht i kënaqun me vetëveten, do të thotë nëse s'posedon asnji prej veçorive të Narcisit, (të tillët po vijnë shum tue u rrallue në botën tonë) ma së miri asht t'i kandisë vetes mendjen se gënjehet. Pasqyra mund të bahet kob dhe mjerim i dikujt, por tjetrit i sjell iluzionin e lumtunisë. E pasqyra janë edhe njerëzit për njani tjetrin. Por, simbas porosisë së tretë, objektiviteti i kësaj pasqyre asht shum relativ. Në rastin tragjik njerëzit janë pasqyrat ma të vërteta. Dhe, nëqoftëse dike e lajthit ajo copë qelqi e lyeme me zhivë, mos të nxitojë, ia thot tjetri të vërtetën. Pasqyra zbulon vetëm facetën, e pasqyra — njeri nxjerr edhe profilin e shpirtit. Shpesh, njeriut i duhen iluzionet, prandej para qelqit që na e tregon të vërtetën dhe na lajthit njikohësisht ma së miri asht t'i bajmë qejfin vetes. Simbas kësaj porosije — të pestës me radhë — iluzionet janë ma se të nevojshme gjatë jetës.

Ndërkaq, nëse njeriu kredhet në gjithëfarë persiatjesh, s'do mend se ma së miri e ka që n'aventurën e tij intelektuale të njohë së pari vetë njeriun. Persiatjeve të tij s'i reshten dukunitë e ndryshme shoqnore dhe natyrore, imagjinata e tij asht e lirë të kapë me flakën e vet si zogun e lirë në maje të malit ashtu edhe pulëbardhat në det. Ai bredh me guxim e krenari të madhe shekujve dhe meridianeve dhe ban orvatje të pakursyeshme për të njohtë natyrën dhe huqet e saj, për të pushtue ate, e cila mund t'i shërbejë mirëqenies së tij dhe për të mposhtë ate, e cila mund t'i sjellë krajata jetës së tij. Porse, njeriu aq i mrekullueshëm, njashtu si rruzulli toksor që ka dy polet e veta, ka edhe ky dy skaje t'elektrizueme në mënyra të ndryshme — në njanën anë janë virtytet

e n'anën tjetër veset e tij. Si nji krijese të prirun të pësojë metamorfoza të shpejta, njeriut shpesh i përzihen virtyte e vese. S'andejmi asht e kuptueshme pyetja a e poetit: „A duhet të mendoj se njeriu ka edhe hale?"

Në se në të vërtetë përbahet prej dy tingëllimesh. Tercina e fundit e sonetit të parë, respektivisht kuptimi i saj mbështetet në njifarë dyshimi si ind i idesë që sjell, meqë bota e lindun në lojë përbahet prej njerëzish që „e kanë" thithë sa herë kanë qenë ma t'urtë!" Kjo tercinë logjikisht mund të lidhet me tercinën e fundit të sonetit të dytë, në të cilën dyshimi ndaj kualiteteve të njeriut, anipse me theksin e mohimit të këtij dyshimi, prapseprap vjen tue u shtue. Derisa njeriu i shëmbëllen peshkut, asht plotësisht njisoj si t'i kishte edhe eshtnat prej llastiku. Peshku njimend i ka eshtnat pak ma të fortë se sa llastiku, porse asht peshk dhe simbolizon njeriun pshikatar. Dhe, kush mund të pohojë se fuqija e maqinës s'e ka ba nji pjesë njerëzish t'i shëmbëllejë peshkut?! Mirëpo, do t'ishte lajthitje të mejtohet se kuptimi i përgjithshëm i tingëllimit Në se përbahet prej dyshimit. Besimi në gjininë njerëzore akcentohet shi me mohimin që i bahet mundësisë së degradimit të tij deri në përqasjen me nji materie shum labile. Madje, vargu i fundit i tercinës së fundit asht lutje që i tanë dyshimi i çfaqun të shndërrohet në negacion të vetëvetes. Njeriu fsheh si gazmendin, lektisjen, pikllimin, lotin, andërrat; njeriu mohon para vetes identitetin e vet; njeriu dyshon në përgëdheljet ngaqë tutet mos janë miklime. Memento të tingëllimit duket se janë vetëm dyshimi dhe negacioni. Ndërkaq, vargu i fundit ka pretendime të mohojë, apo së paku, të zbusë at dyshim. Veç e vërteta e shpie poetin në rrugë të drejtë: nji dukuni që zu të bahet pronë e padëshirueme e njeriut s'mund të përjashtohet ekskluzivisht. Së këndejmi ai thot: „Jo, jo. Mos besoni, se drita jonë na vret!" Ta merr mendja se jeta mbështetet në kualitete humane e fisnike të njeriut, e mbasi dyshimi s'ban pjesë ndër virtytet, ndërgjegja e grish poetin ta mohojë. Mirëpo, kur përvojën e pasojnë persiatje e mendime të shëndosha, atbotë edhe e vërteta duhet të pranohet si e tillë. Dikur thuhej se njeriu mund të jetë qingj, por edhe

ujk për njeriun. Në shekullin tonë thuhet se njeriu asht pa vetem pesnk dhe ujk njikohesisht.

Poeti i cikllt „Xixelloja" persiat me qejf për njerezit, ashtu sikundër e ban këtë edhe per jeten pergjithësisht. I njeh mirë, s'ka fije dyshimi, se vetë jeta e sjell njeriun në situatë që të veje kontakt me njerëz të ndryshëm. Prandej edhe ua primon vetitë ma te strehueme. Soneti N ë s e asht fryt i nji përvoje të gjanë dhe i kontemplacionit rreth saj. Ndonëse nuk mund të determinohet temporalisht, sepse kualitetet e saj mund t'i përshtaten çdo kohe, bahet sikur asht nji vizion poetik. E inspirueme nga nji moment i caktuem, ideja e tingëllimit s'mund të kufizohet vetëm në te. Nji shëmbëllesë refleksive e gjejmë edhe në sonetin O r a. Ai dyshim gati total, ajo luhatje e pandërpreme, ai ritëm vazhdues, të cilin njeriu lektiset ta vejë ndonjiherë ne gjendje statike edhe në kët mes shprehet përmes vargjevet që i drejtohen kohës: „O, ec tash me mue, ma zgjat dorën shqim. /Se shpesh po lodhem në bebzat e hueja,/ Tue kërkue n'to nga nji grimë pranverë".

Enver Gjerqeku, në poezinë e tij refleksive, asht poet i perceptimeve të qarta dhe asociacioneve të fuqishme. Objektet — simbole rreth të cilëvet persiat vizuelizohen fluturimthi në saje t'asociacioneve të ngjalluna tek lexuesi. Ai ndikon pak me akustikën e vargjeve. Ritmin e ka disi të njitrajtshëm, intonacionin poashtu të qetë, pa fundosje e shpërthime të befasishme — nji qeti e pashqetësueme i mbështjell mendimet e poetit të „Përmendores së fjalës". N ë s e nuk posedon at pasuninë e imazhevet sikundër, bie fjala, U j ë d h e s a, porse ka kualitetet tjera që e radhisin ndër poezitë e tij të bukura. Ajo që shquen individualitetin e tij poetik në kët mes asht masa — kjo ndjenjë aq e nevojshme në fushën e artit. E ky kualitet e shquen veçmas tingëllimin N ë s e, në të cilin ideja kryesore nuk asht shndërrue në viktimë të bredhjevet mbas efekteve poetike, mbas figuravet, rimës, ritmit e mjeteve të tjera. Spontaniteti i nevojshëm aq shum sidomos në poezi rrjedh ngadalë-ngadalë prej vargu në varg, prej strofe në strofë, tue i kontribue kështu gradacionit të qetë, mitar të tezës dhe antitezës, me kuptimin e të cilavet asht sajue soneti në fjalë. Poeti asht i prirun ta shquejë Unin e vet gati në secilin sajim poetik; sensi-

biliteti i spikatun s'i lejon ta abstrahojë dhe depersonalizojë veten as kur përdor simbolet siç ishin të naltëpërmendunat.

Tingëllimi, vejnë në dukje disa estetë, e ndër ta edhe A. Leferr, asht nji formë poetike bukur e ngushtë ose, si të thuhet, mjaft e kufizueme dhe megjithë liritë që i akceptojnë poetët në te sot, rishtazi nuk lejon at përhjedhjen e imagjinatës sikundër mund të bahet në vargun e lirë. Për t'iu shmangë dosido rregullave të vrazhda të sonetit duhet posedue aftësinë e manovrimeve logjike dhe poetike, e ç'asht ma me randësi, edhe prirjen e modestisë në të shprehun. Ai që gjurmon me fanatizëm mjete bombastike nuk mund t'ia dalë ta çfaqë spontanisht, bukur, mendimin në trajtën e sonetit. Ai vetëm mund të bie viktimë e ambicjeve të veta që të provojë aftësinë edhe në këtë formë klasike dhe mjaft autoritative të poezisë. Mirëpo, poeti i Blerimit të vonuem asht tregue njimend poet me invencion në pushtimin e kësaj forme të poezisë dhe në frenimin e ceneve të saj, e ndoshta mu kjo trajtë i asht tregue ma e përshtatshme për çfaqjen e persiatjeve dhe mendimeve të veta. Me sensibilitetin, që e derdh me bollëk në nji numër të poezive të veta ma kualitative, por kurrë tue mos iu nënshtrue patetikës artificiale, zen impresione të fuqishme, të cilat nëpërmjet të metaforave kuptimplote dhe të qëllueme, i kthen n'ekspresione farfuritëse. Kështu, edhe nëpërmjet të këtij tingëllimi konstatohet virtyti i poetit: ndjenja e masës. Kjo nënkupton, përveç flakjes s'efekteve të cekuna, edhe gjetjen e nji natyrshmënije, spontaniteti, në të shprehun, edhe gjetjen e masës sa i përket hermetizmit, edhe braktisjen e fjalëve boshe në trajtë epiteti të panevojshëm.

Enver Gjerqeku me pak të tjerë asht hulumtuesi ma besnik i vargut të gjuhës shqipe, i ritmit, rimës, tonalitetit, muzikës, figuravet; ai asht hulumtues i fjalës shqipe të vargut dhe i frymës poetike shqipe. Së këndejmi e shton kënaqsinë e përjetimit asociativ fjala e zgjedhun nga krijimtarija e Lasgushit o Mjedës, intonacioni i këtij të dytit dhe pedanterija fanatike e atij të parit. Të gjitha mjetet poetike që janë shkri në thadrimin e vargjevet të sonetit Nëse provojnë se i përgjigjen atij mendimi fluror të paqëndrueshëm, të shprehun mes alternativash logjike dhe

janë në harmoni të plotë me idenë kryesore të përmbledhun në nji fjalë me aq shum shërbime. Dhe aty janë futë shum kategori e atribute të jetës, ngjyra të llojllojshme të saj. Porse, ajo që bie veçmas në sy asht orvatja që përfundimi të forcohet me nji theks të shquem human. E ai përfundim i pacaktuem, i ngjyrosun nga patetika dhe emocionet e poetit, asht në harmoni të plotë me titullin fluror. Përvoja jetësore e poetit asht mjeti i tij, organoni i tij, për të njohtë botën dhe njerëzit. Përvoja s'ka të kufizuem dhe se kush ia jep modalitetet e përjetimevet personale dhe frymën e vet. Në këtë mes përvoja e Enver Gjerqekut asht përvojë e kësaj kohe dhe e të gjitha kohëve e ai e ka veshë këtë herë me petkat e nji trajte të paselitun mjaft në poezinë shqipe.

*

Në çaste vezullimi të ndjenjës së përjetueme thellë në shpirt, ndodh që poeti të gjindet para imperativit që kësaj ndjenje t'i japë formën e duhun, meqë shpreson se me aq ka në duer të gjitha armët e nevojshme për të depërtue në sferat intime të të tjerëvet. Por, ç'mund të ndodhë? Poezija e tij lexohet pa kurrfarë angazhimi, pa hare, pikllim as dashuni. Fryti i imagjinatës së tij s'asht i motivizuem për të ngjallë asociacionet tona. Ai ngel në periferi të përcjelljes së përvojës jetësore që e shprehun me mjetet poetike, synon të bahet vizion jetësor. S'mund të thuhet se dëshira ia shuen vetë suksesin poetik, meqë kësisoji do të pohohej se aftësija kreative asht kryeqëput dhuratë e natyrës, s'mund të thuhet as se ai vetë nuk e përjeton rrast secilën fjalë të qitun në letër, meqë kësisoji do të mohohej karakteri intim i poezisë, por mund të thuhet shkoqun: poeti flet për çashtje efemere dhe s'përcjell përvojën mbas së cilës konsiston e vërteta. S'do mend se asht në favor të poetit që ai vetë ta ketë përjetue thellë motivin e shtjelluem, fakt që shton ngrohtësinë e prodhimit të tij, porse nuk mund t'imponohet si e vërtetë se poezija do të dalë artistike. Nëqoftëse poeti shkithet nën barrën e ndonji ndjenje personale tragjike, lexuesi mund të thot: ani çka! Nëqoftëse shkëlqen shend e verë, tue derdhë në të gjitha anët harenë e tij, prap

ai mund t'i thot: s'e besoj që e ke përnjimend. Shkaku asht i qartë: lexuesi kërkon t'i besojë poetit. E do t'i besojë kur ky i flet sinqerisht, kur i flet me modesti dhe spontanitet. Përvoja e jetës, kur asht e njimendët dhe e sinqertë nuk duron të vishet me bombastikë.

Poezija asht ngushtë e lidhun me krijuesin e vet, i cili fut në te edhe individualitetin e tij, tue i vu shpesh ngjyrën e gjendjevet momentale. Së këndejmi asht aq e nevojshme ajo ndjenja e masës. Poeti i Blerimit të vonuem nuk e harron prore Narcisin, porse as nuk i sillet aq dendun në mend. Së këndejmi poezitë e tij posedojnë edhe at lirizmin e lezeçëm e edhe at thellësinë e përjetimit të realitetit. Bahet sikur nuk e relativizon kurrë objektivitetin. Poeti, sikurse çdo njeri tjetër, asht i determinuem nga koha në të cilën jeton, porse ky ia kthen at kushtësim me vulën që i ven. Në dritën e këtij mendimi kuptohet pse ai me nji pjesë të qenies së vet i takon edhe ardhmënisë. Shumkush e përqas poetin me shkencëtarin — të dytë janë njerëz që bajnë zbulime. Mirëpo, poeti asht edhe njifarë vizionari.

Refleksi emocional-asociativ asht atributi me të cilin lexuesi i përgjigjet poezisë. Thuhet se edhe nji poezi që nuk kuptohet ka vlerën e vet artistike, sepse ngjall asociacione të lidhuna për ndonji objekt, kujtim a dukuni. Po, vec nëse asociacionet nuk janë sadokudo të qarta, efekti i saj asht i mallkuem të rrijë në shkallën ma t'ultë. Mendimi i kristalizuem, mendimi si rezultat i përvojës jetësore, eleminon hermetizmin total. Tingëllimi Nëse nuk asht i qartë si pasqyra, porse nuk asht as i errësuem me tendencë. Ai ka nuancat e veta hermetike që, tekefundit, shtojnë intensitetin e asociacionevet dhe ndjenjës, si refleks të tyne a posteriori. Metafora ma në fund edhe ka këtë kuptim: që si fundament i krijimtarisë poetike ta fusë lexuesin në botën e autorit, por jo turravrap, veç gradualisht, mbas pak pocaqisjesh, kur ai zbërthen kuptimin logjik dhe hyn në substancën e saj. Kështu kunorëzohet qëllimi sakramental i poezisë, mbasi lexuesi i bashkohet imagjinatës së tij dhe, nëqoftëse sajimi poetik ka në bazë përvojën e thellë jetësore, të sinqertë ky e përjeton edhe si refleks të vetin intim.

Format poetike kanë pësue ndryshime të mëdha, kështuqë edhe tingëllimi toleron rysni të ndryshme, anipse ma kufizueshëm se sa gjetiu. Ndoshta vetë ky fakt do të thotë se nevoja e përcjelljes së nji përvoje e kuptimi ma të gjanë asht shprehë edhe në te. Kuptimi i bukurisë nuk përfshin vetëm mënyrën simbas së cilës asht thanë diçka, porse edhe ate se si asht thanë dhe çka asht thanë. E bukurisë njeriu i përgjegjet me admirim. Poezija flet për njeriun dhe jetën e tij, prandej sot, kur poetët po flasin ma shpesh për gjasendet, lexuesi admiron sajimin e atillë. Nëse asht poezi që sjell asociacione dhe persiatje.

Poeti e pason zanin e kohës së vet, ndonëse bukur shpesh i del përpara, tue krijue kështu vizionin e tij poetik. Ai s'asht profet, porse poezija, simbas nji adhuruesi të saj, ka diç nga profetizimi.

PORTRETE TË VRULLTA DHE MITARE

Në tregimet e Azem Shkrelit Sytë e Evës dhe Bjezga janë dy portrete femnash të shikueme nëpër dritën e ndjenjës së tyne: dashunisë. Femna ngaherë kishte nji militant t'ekzistencës së barabartë me mashullin, nji mik e mbrojtës që rropatej fyt e qafë për mirëqenien e saj dhe përfilljen e dashunisë së saj. Ky dashamirë i flaktë i femnës asht poeti. Ai, me fuqinë gjeniale të psikologut dhe sociologut ua çfletoi mashkujvet veset dhe virtytet shpirtnore të kësaj krijese. Nëqoftëse femna e botës së qytetnueme me kohë u nivelizue me të shoqin në çdo pikëpamje dhe, nëqoftëse mashkulli zu të sillet me skofi ndaj saj, nji pjesë e meritës për këte u takon poetëve. Së këndejmi edhe ato kanë të drejtë pse i dashunojnë aq zjarrtë dhe çfaqin admirim ndaj antit të tyne. Thuhet se Laura asht qenia ma magjepsëse, ma e mrekullueshme dhe njikohësisht ma hyjnore e kohës së mesme. Prapseprap, s'besoj të ketë vdekë e lumtun. Ndonëse femnat kanë instikt ma të zhvilluem e afinitet ma të spikatun për dukunitë dhe format e ndryshme të jetës, mjaft shpesh vetë bukurija bahet shkak i mjerimit dhe pocaqisjeve të tyne. Tue u tëhuejsue nga vetja ato tëhuejsohen edhe nga mashkulli — egocentrizmi plakos qenien e tyne shoqnore. Qyshse ekziston ajo ban jetën në mesin e dy kontrastevet: në nji anë asht e adhurueme, e ngritun në piedestalin e perëndeshës, ku vuen për shkak t'izolimit nga njeriu, e n'anën tjetër asht e përulun, e përçmueme, e prridhun dhe e shtypun, prandej e vume në nji pozitë tragjike.

Përmenda poetin dhe femnën e adhurueme dhe të përçmueme njikohësisht, shi pse nji kuptim të tillë mbi fatin tragjik të femnës e gjejmë edhe në novelat e poetit Azem Shkreli. Në trajtimin e natyrës dhe pozitës së femnës ndër ne ai, përkrah elementevet tragjike, fut edhe mjaft lirizëm. Porse në këto mes poezija e tij shquhet me akorde të dhimbshme. Novelat e Azem Shkrelit në të vërtetë janë poema në prozë. Secili pasazh i tyne asht i tujgun me lirizëm të fuqishëm, me observacione të holla, me mprehtësi konstatimesh. Akordet lirike dendun e damtojnë prozatorin, e nxjerrin nga rruga e soditjes realiste dhe e shpiejnë t'iu nënshtrohet huqevet subjektive. Ndërkaq, Azem Shkrelin jo vetëm që nuk e damton kjo, por, përkundrazi, shton intensitetin artistik të krijimeve të tij, tue e gozhdue kështu lexuesin për to. Kjo derdhje e tingujvet lirikë në prozën e tij ka shkaqet e veta: ai flet për nji qenie të vrullët dhe mitare njikohësisht, flet për femnën shqiptare deri dje robkinë dhe flet pasionueshëm, bindshëm, herë me patetikë e herë me mprehtësi psikologu. Magjinë e fjalës së tij e shtojnë mendimet e kristalta, kuptimplote. Pareshtun shihet se ai e përdëllen këtë krijesë, i dhimbet pse e kaluemja nuk e ka vu nën krahun e mëshirës së vet, nuk e ka përkrahë e as mbrojtë. Nga postulatet e tij etike sikur flet filosofija e malsorëvet krenarë, të cilëvet vrazhdësija e natyrës dhe barra e randë e kohës kurrë s'ua kanë përulë dinjitetin, e as thye optimizmin jetësor. Tanë krijimtarija e tij edhe mbështetet n'ato pikëpamjet e shëndosha, plotësisht materialiste të të menduemit dialektik të njeriut të popullit. Portretet e tij qëndrojnë aq larg persiatjevet metafizike dhe shprehin me punë, me dashuni, me pasion dhe epshe, me të gjitha veprimet e veta, me jetën e tyne, ato ndryshimet e shpirtit të njeriut.

Femna shqiptare asht nji kaptinë e veçantë dhe n'esencën e vet tragjike e marrëdhanievet shoqnore në të kaluemen. Shum nga poetët e prozatorët tanë rrëfejnë për pozitën e saj sociale, etike, morale, rrëfejnë për dashuninë e saj, për prridhjen e kësaj dashunije apo ngadhnjimin e mundimshëm të saj nën kushte të vështira dhe me krajata të shumta. Azem Shkreli, ndërkaq, rrëfen nga nji aspekt e kand tjetër

për dashuninë e femnës dhe kryesisht e shikon nga mbrenda, tue shtrue koordinatat e psiqikës së saj.

Në novelën Sytë e Evës, në të cilën gërshetohen dy ngjarje, dy kohë, dy kategori njerëzish, dy mënyra dashunije, dy koncepte jetësore, femna asht pothuej ajo e njajta: madhështore nga jashtë, enigmë e pazbërthyeshme sa i përket shpirtit dhe shtresave të tij, nji labirinth i vërtetë. Ajo asht krenare, epshore, e zjarrtë. Pasioni i njomësisë trupore i derdhet nga sytë dhe njeriut i fanitet prore si nji geizer i pashterrshëm, nxehtësija e të cilit ka tamën në nji thellësi të madhe, të pambërrijtshme. Epshi i saj asht lumtuni, në njanën anë dhe tragjikë, n'anën tjetër. Kur gjaku i kallun flakë qarkullon dejvet dhe ujit të gjitha indet e trupit të freskët — kjo asht nji apotheozë e risisë dhe pafajsisë, porse kur ai gjak helmon arsyen dhe shuen qetësinë e jetës — kjo asht nji tragjikë e llojit të vet. Tulja, protagonistja e novelës në fjalë, sublimon lumtuninë dhe tragjikën njikohësisht. Lexuesit i përhihet si nji shtojzavalle mishi e gjaku. Njeriu mund t'i veshë epitete të ndryshme, mvarësisht nga qëndrimi i tij ndaj etikës dhe normavet shoqnore. E ajo, ndonëse si shtojzavalle, asht krijesë reale — kështu imponohet me ekzistencën dhe finalitetin e vet. Por, ndoshta asht njifarë sinteze e të gjitha virtyteve dhe veseve të femnës; ndoshta asht personifikim i ngadhnjimit dhe dështimit të femnës shqiptare; ndoshta asht ajo zana e trashëgimit populluar — zana që shiton veten dhe djalin në të njajtën kohë. Prandej halluku s'njohin gja tjetër rreth e qark saj përpos shtëpisë ku ajo ndryn at njomësi të bujshme, at vullkan të pashueshëm prej njeriu. Tue kalue asajtpari ata i thonë njani tjetrit:

— Aty flen Tulja.
— Cila Tule, hej?
— Nji Tule asht, ma.
— Pale, pale!
— Tanusha e Sherif Tunës.
— Për shtatë gjaqe vajzë.
— Yh, yh!

Emni i saj asht simbol i bukurisë, i shëndetit, i të pambërrijtshmes: ky emën përplaset kumbueshëm shkambijvet tue lanë vakuum në zemrat e atyne që ia sodisin çerdhen. Disa sish dëshirojnë ta kenë për-

jetë, të krijojnë ardhmëninë me te, qoftë edhe në maje të shkambit, të jetojnë nga lumtunija e shikimevet; të tjerët kënaqen tue e imagjinue në gjumë, tue krijue iluzionin e depërtimit n'andërrat e saj; e ata, që janë si ma realistë dhe ma modestë, e dëshirojnë vetëm nji natë. Mirëpo, në kuadrin e kësaj apologjije fshihet veçmas adhurimi i pafrenueshëm i Ndue Dedës, që bjerr kohën e risisë dhe kthehet në nji tragjikë jetësore. Ai asht nji fantast i llojit të vet, pa çfarë malsija nuk ka ngelë kurrë, kurse finalja e tij e zymtë që mund të paramendohet asht pasojë e mungesës s'aftësisë që të qëndrojë me kambë në tokë. Ai të ban me dijtje se në njeriun jetojnë të strukuna do drille e naze që nuk iu përulen kërkesave t'arsyes, së këndejmi edhe ndjenja e trishtshme që përcjell jetën e tij kushtësohet nga ajo kryeneçësi e posaçme.

Jeta e Tules asht e përshkueme nga tingujt e tragjedisë së femnës, e cila me adhurimin e bukurisë së vet sjell edhe kobin e fatkeqsinë e vet. Tulja asht narcisoide dhe këtu qëndron shkaku i parë i tragjedisë së saj psiqike dhe tëhuejsimit nga shoqnija. Po të kishte nji qëndrim ma objektiv, ma modest ndaj vetëvetes, me siguri do të ndryshonte edhe fatin e vet. Sepse, fati nuk asht fatalitet; fatin ia cakton njeriu vetëvetes, thonë optimistat e jo edhe filosofët. Sidoqoftë, fati i Tules ngjall përdëllim respekt plot. Krijesat e zatetuna me aq energji jetësore dhe të zharituna nga fuqija e ndjenjës elementare nuk mund t'i mëshirojë kush pa iu çfaq njikohësisht edhe respekt të denjë për personalitetin e tyne të thellë. Tulja asht viktimë e gjallë e atij narcisoizmi të vet, e asaj krenarije të patundshme dhe do ta kundrojshim me indiferencën e spektatorit të painteresuem sikur në formimin e këtyne ndjenjave e vetive të saj mos t'ishte i përziem edhe i ati. Në këtë mes edhe ai bahet në njifarë mënyre shkaktar i tragjedisë së saj. Por, pjesëmarrja e tij në dështimin e lumtunisë dhe jetës së Tules asht shum ma e gjanë. Ai pandeh se asht derë soji e pashoqe, se i tillë duhet të jetë edhe burri i saj, se ajo, Tulja, nuk mund të bahet „shujta e kujdo", se në mungesë të djalit dikush duhet ta bekojë për mipa sepse, ma në fund, në këtë mënyrë nuk do të fiket emni i tij. Frigohet se ajo lule kundërmonjëse e kujdesit dhe dashunisë së tij prindore, e selitun me skofitë ma të buta të

prindit, do të fiket e vyshket në duert e kush dreqi e di kujt. Prandej me vendosmëninë e prindit që përditë e ma shum ia kryp trutë fëmisë së vet me formulat e veta jetësore, zen dhe e paralizon Tulen tamam në lulen e rinisë së saj. Ai, në të vërtetë, s'mund të mejtojë se i tanë qëllimi i tij i mirë mund të kthehet në negacion të vetëvetes.

Shumkujt i del e kundërta nga ajo që pret shumkush mbjell me qëllim që të korrë fryte të begatshme por, mjerisht, jeta ia luen lojën e vet. Tulja me t'jatin janë shembëll i nji zhgënjimi të tillë, ndonëse në rastin e tyne mund të përfillet edhe alternativa tjetër, simbas së cilës ai e paralizon plotësisht vetëdijshëm iniciativën e të bijës. I patrashëgimtar tjetër, ai s'merr guximin e stoikut të ngel fillikat me të shoqen e plakun në shtëpi. Asht e mundshme se Azem Shkreli i ven ma tepër theksin admirimit që ndien Tulja ndaj vetes së vet, prandej këtë element psikologjik të prindit të vetmuem vetëm e ze ngojë dhe s'e shtjellon tutje. Porse, nji asht e vërtetë: me kapërthurjen e çuditshme të të gjitha rrethanavet, kjo bijë malsije bahet yll i rrallë në qiellin e mashkujvet, të cilin ata e lypin, e dëshirojnë pa masë, por s'e gjejnë dhe s'mund t'i qasen dot. Dhe, sikundër femna që ndien kënaqsinë për shkak të plotësimit të sedrës kur sheh mashkujt tue iu gjunjëzue epërsisë së misteriozitetit të saj, Tulja zen t'i shikojë ata mbas vetullash dhe të mendojë se nuk ishin për te. „Kur krenarija e këtij mendimi luftonte me epshin (Tulja i mrekullohej vetëvetes) dukej ma e bukur. Ia kishte andja të skuqej përdëllimesh të lajkave të mashkujve. T'i ngashërente, derisa të mos i përuleshin e dukeshin të vegjël si krymbat. Dhe mandej t'i mëshironte me nga nji këshillë — që të provojshin me i mbushë synin e mendjen ndonji tjetre. Porse, të mos përkuleshin ma n'at mënyrë para t'adhuruemeve të tyne, meqë femnat janë të pamëshira ndaj të mjerëve nga dashunija".

Azem Shkreli e ka rrethue Tulen në të gjitha anët me bukuri, me art, me shkëlqim: e ka ba tamam zanë mali. E, megjithate, Tulja e tij asht reale si të gjitha qeniet reale të kësaj bote. Nganjiherë duket se flet e persiat përtej se ç'i lejon niveli intelektual i ambientit, prandej mund të bahet si e zbukurueme, e ngritun mbi realitetin, e zmadhueme tepër n'at hijeshinë e saj në krahasim me vendin dhe konditat. Megjithate,

Tulja asht pikërisht ajo malsorja e buhishme, e trentë, si thonë malsorët e zjarrtë, dhe mirret si portret karakteristik i mileut të saj. Asht e zmadhueme n'at bukurinë e saj, prandej edhe ngulitet në kujtesë. Në portretin e saj janë përmbledhë veçoritë e shum të tillave të malsisë. E bukurija s'ishte kategori e jetës që s'e njihshin malsorët dhe malsoret. Përkundrazi, ata i shquen fisnikërija e shpirtit dhe harmonija e pamjes. Azem Shkreli veç ka zanë si ma n'esencë këto veti të njerëzve të malsisë. Sikur të pohohej se ai ka brimue vetëm faqen e bardhë, dritën e nji ambienti dhe nji kohe, atëherë kjo do ta ngushtonte kuptimin e artit të tij. Porse, duhet thanë se ai pikas edhe terrin e nji atmosfere. Së këndejmi, Tulja e tij shihet edhe tue u dërmue mu në valën e nji adhurimi të pakufishëm nga mashkujt. Ajo asht e soditun dhe e çfletueme nga shum anë.

Kudo qofshin dhe kudo jetofshin, njerëzit janë mësue të krijojnë mite, kurse apotheoza e kësaj dashunije që mbyt me dy teha asht mit i nji ambienti ku femna shtypej e gulshohej nga dora e po atij mashkulli që e izolonte nga gjinija e vet. Së këndejmi edhe Tulja i hakmerret me fuqinë e femnës, me magjinë dhe misterien e natyrës dhe epshit të saj. Por, sikundër ajo krijesa që tue gëlltit tjetrin han edhe veten, njashtu Tulja, tue mundshtue mashkujt në krye me Ndue Dedën, mundshton dhe dërmon edhe veten e rininë e vet. Kënaqsija që ndien nga përpëlitjet epshore të lakmitarëvet kthehet e bahet shkak i përpëlitjeve të saj edhe ma fatale. Prandej natën pierron sytë nga vapa e madhe që i gufon prej trupit, mblidhet e shtrihet orë e çast dhe çkopsit kopsat për të zhdavaritë at zabullimën e pamëshirshme shpirtnore dhe fizike. Në këtë mënyrë, kjo femën me dimenzione shum të kufizueme veprimesh, porse epshore dhe senzuale si heterat e stërvituna në jetë, kundron lëvizjet e trupit të vet si lektisje të saj pas ndonji „vullneti të huej", pas ndonji „fuqije mistike". Në çastet e narcisoizmit, kur sa ndiente kënaqsi tue kundrue bukurinë dhe njomësinë e vjet aq edhe i frikësohej zjarrit të mbrendshëm, Tulja dridhet si thupra n'ujë. „Flokët i derdhte valë luginës së gjijve, të cilët, në dritën e zbetë të hanës që përvidhej ndërmjet grilave, shpërthejshin si gejzere. Të bardhë dhe të fortë, ngriheshin si dy kryengritje

të saj të pashueme kundër fatit dhe dikujt që nuk e njihte, Atje nalt, përpëlitej deri vonë tue luejtë me gjijt e vet, prej të cilëve trembej si prej njizet e gjashtë vjetëve. Pak nga pak, avullohej..."

Në këso momentesh vetëkënaqsije, që n'esencën e vet fshehin të vërtetën e Tules, asaj i vetojnë njiherësh edhe mendime në lidhje me peshën e fatit dhe ardhmëninë, kështuqë zen të ndiejë revoltë „ndaj dikujt që nuk e njihte". Kjo revoltë në realitet asht negacion i vetëkënaqsisë që ndiente pak ma parë. Me te i hakmirret shpirtnisht gjinisë mashkullore që e determinon ate në të gjitha pikëpamjet. Kësisoji, mospajtimi ndërmjet kërkesave t'instiktit të natyrës njerëzore dhe mvarësisë nga konditat dhe normat shoqnore etike të nji ambjenti sjell zvetnimin psiqik të qenies së femnës. A ka faj vetë ajo? A duhet ta dënojmë pse asht aq e bukur dhe e dashunueme njiherëpërnjiherë në vetëveten? — më bahet s'ka nevojë për spiegime. Tulja — kjo asht nji jetë e djegun në flakën brambulluese të krenarisë marroqe, nji lum rrëmbyes i shterrun shi në tamën e vet. Tulja asht risi e venitun nga shuemja e risisë. Dëshira e zjarrtë e secilës femën, instikti i saj sakramental që ta japë frytin e vet asht prridhë në te nën presionin e dëshirës sedërtare të prindit. Njeriu admiron fuqinë e pakrahasueshme, rrëmbyese e të kobshme të feminitetit të saj, prandej s'guditet qysh asht ba Ndue Deda skllav i pranguem për jetë i magjisë së trupit të saj. Pamja, fjalët, qëndrimi, shikimi — çdogja e saj — posedon nji magnetizëm të çuditshëm të cilit mashkujt nuk mund t'i rezistojnë. Shtëpija e saj asht nji fuqi gravituese e tokës që tërheq jo vetëm shikimet, por edhe andërrimet e mashkujvet. Tulja sikur e ka gjakun e përziem me drogë; ajo të dehë, të mrekullon, t'i ban sytë të të lëmeken, ta kapit trupin e pocaqis shpirtin me pamjen e vet engjëllore e djallëzore njikohësisht. Ai zjarr i saj i mbrendshëm, që i shquhet përjashta, në pamje, asht nji satanizëm i enigmës femnore, asht shkak i kobit të saj dhe mashkullit. Tulja nuk asht bukuri e botës moderne, ajo personifikon idealin e bukurisë së kangëtarit popullor; ajo asht bukuri klasike. Portreti i saj nuk asht ai i piktorëvet modernë: i Manesë, as i Sezanit, as i Gogenit; ma parë asht i Ticianit, si Venera e tij. Qepallat e saj janë krahë korbi, vetullat — hanë pesëmbëdhe-

tëshe. Xhubleta i pëlset nga shëndeti dhe plotnija e trupit. Fytyrën nuk ia stolisin zbehtësija dhe toaleta. Tulja asht bukuri e natyrës virgjine, asht bukuri elementare e nji ambienti të paprekun nga moda dhe civilizimi. Së këndejmi edhe njerëzvet iu fanitet si shtojzavalle. Nji femën aq e bukur, aq senzuale, me potencial aq të pashterrshëm dhe të paprekun emocional, asht e natyrshme dhe e kuptueshme të jetë me resë, me huqe, me naze, të lektiset mbas pispillimeve dhe stolisjes. Ndërkaq, Tulja nuk e ka asnji prej këtyne vesevet. Asht e natyrshme që në jetën e femnës kësisoji të shpërthejnë skena erotizmi dhe refleksione epshore, porse tek ajo nuk kemi asgja të këtillë. Vlimet e saj të mbrendshme janë vetëm nji kushtrim i prridhun për plotësimin e të drejtave të zemrës së saj. Përshtypja e sekujt që do të rropatej të përfytyronte përpara Tulen do t'ishte kjo: nji engjëllushkë me pamje njeriu (engjujt s'çojnë dashuni, meqë ashtu duen njerëzit). Dhe, njeriu befasohet dhe habitet pa masë e pakandshëm kur pikas se si asht e mundun që nji aso natyre e bujshme t'u falet urdhënavet dhe hirit të prindit për gulshimin e fuqisë së vet. Tamam në këto mes vjen çfaqet intuita e autorit që të zajë vijat karakteristike të njerëzvet të nji ambienti të caktuem dhe me përgjithësime artistike t'i ngrisë në nivelin e karakteristikave të përgjithshme njerëzore.

Fati i Tules, edhepse deridiku i kushtësuem edhe nga ai narcisoizmi i saj, prap e akuzon mashkullin për qëndrimin e tij ndaj femnës. Këtu femna nuk asht viktimë e indiferencës dhe qëndrimit johuman të mashkullit ndaj saj, por e dashunisë së tij robnuese, të pakuptimtë dhe egoiste. Edhenjiherë, pra, grueja pëson shum për arsye se mashkulli don ashtu. A don i ati i Tules për të mirën e saj, tue pritë rast ma të përshtatshëm për te, apo pse nuk mund të pajtohet me shkretnimin e shtëpisë mbas martesës së saj eventuale — janë dy shkaqe prej të cilëvet i dyti do të peshonte ma randë në diagnozën e psikiatrit. Tulja nuk asht mëkatnore ndaj askujt përpos ndaj vetëvetes. Ka çaste kur njeriu duhet të flakë të gjitha përudhjet e dashamirësitë dhe të ndëgjojë zanin që i del nga mbrendësija e shpirtit, vetëm e vetëm që të mos e mallkojë dikur fati i vet. Aq sa e prijnë njeriun këshillat e racionalizmit të vet, aq duhet ta prijnë

nganjiherë edhe kërkesat e trupit. Sepse, krijesa njerëzore nuk asht vetëm tru, por edhe gjak. Tulja asht viktimë e njianshmënisë në këtë pikëpamje. Pleqnija e saj e trishtshme hap horizontin që t'ia parashohim nji finale tragjike. Paradoksi asht i qartë: nji krijesë e pafajshme në jetë s'korr frytet e mirësisë dhe virtyteve të veta; përkundrazi, jeta e shpërblen me të keq. Po mos t'ishte ai pasioni i saj i trentë me të cilin e kundron aq lezeçëm bukurinë personale, njeriu do të shtronte pyetjen: a asht e mundun mos të përdëllehet Tulja dhe të mos fajsohet deri në mallkim i ati i saj?!

Me fatin e Tules gërshetohet edhe ai i Ndue Dedës. Që të dytë janë ekuilibrue përkah fuqija e ndjenjës dhe derisa ajo ngulmon t'i rezistojë vardisjes dhe dashunisë së tij të pamasë, ky s'di të zmbrapset e as ta ffrenojë rrebeshin e botës së tij intime. Mirëpo, në fund nuk mund të dallohet qartë se ç'dominon në shpirtin e tij: „Andja apo mënija. Apo, edhe andja edhe mënija, në nji njazim të tretë, ma të fortë se këto të dyja dhe ma të fortë se ai vetë". Ndue Deda ndryn në vete nji përkushtim të posaçëm, përkushtim idealist që përkah ngulmënija e vet duket gati patologjik, e që mund ta zbërthejë mundësija e konstatimit të parë tok me variantën e dytë: t'ekzistimit të sedrës dhe mënisë së tij, t'ekzistimit të ndjenjës që të hakmirret për vuejtjet savjeçare të shkaktueme nga dashunija e papërfillun. Ndjenja e tij do të shkrinte gurin, njashtu si di ai të përmbys kryq e minare për hirin e dashunisë, ndërsa vendosmënija rezistuese e Tules mjafton t'i shtypë edhe erupcionet ma të fuqishme të gjakut të saj, sepse kërkesat e autoritetit prindor janë ma vendimtare se sa imperativi fiziologjik. Fytyra e Ndue Dedës asht veçmas impresive mu për shkak të këtij përkushtimi idealist. Kur pandeh se e vetmja pengesë e realizimit të dashunisë së tyne asht feja, ai, për ta bindë ate se nuk njeh fe as ndasi tjetër, then kryqin e vorrit të t'jatit dhe e ven në gardhin e kopshtit të saj. Për kuptimin e njerëzve t'atij mileu kjo asht profanosje e gjanave të shejta. Por, ç'nuk ban dashunija e njazueme me mëninë e cytun nga mospërfillja në nji trevë ku njerëzit i falen mitit të dashunisë s'anatemizueme. Fuqija e ndjenjës e ban të verbët Ndue Dedën, ia helmon arsyen, dhe s'sheh se me vardisjen e vet shkakton reshjen e saj.

Dashunija e tij e sinqertë mund të jetë magjepsëse për çdoke, porse jo edhe për objektin e kësaj dashunije. Ai, ngaqë asht mjegullue syshë dhe mendje nuk pikas se mu ngulma e tij që ta përvehtësojë Tulen, e sjell në pozitë tragjikomike. Nëqoftëse, sikundër thot vetë autori, „femnat nuk i dëbon rreptësija", ndërmjet këtyne dy krijesave senzuale ndodh e kundërta: mashkullin nuk e dëbon qëndrimi i rreptë i femnës, veç përkundrazi, e cyt, e tërheq e përvehtëson edhe ma tepër.

Këto dy krijesa të cilësueme përkah fuqija e jetës së tyne andërrimtare sikur janë zanë në njifarë valleje rituale dhe pasohen shëmbëllyeshëm yjvet që s'e zanë dot njani tjetrin. Në rropatjet e tyne që të vendosin harmoninë dhe plotninë që ka njeriu vetëm në dashuni, ato nuk ia dalin dot, kështuqë ngjallin asociacione të jetës së dështueme.

Edhepse e adhurueme prej rrethit të vet dhe lakmitarëvet. Tulja përkrah adhurimit ngjall edhe përdëllimin, sepse asht nji vashë e mbetun e njikohësisht tragjike. Fati i sai i trishtmë kushtësohet nga dy determinanta: psikologjike dhe sociale. Ajo, si femën, asht nji vullkan i pashterrshëm ndjenjash, porse vullkan që nuk shpërthen kurrë, sepse vlimet e tij të mbrendshme i drejton shkopi magjik i trimit prej përjashta. Tulja asht nji lule që pret vjeshtën e vdekun dhe e djeg brvma e papritun. Ajo asht inkarnacion i femnës që shkrihet nën peshën e begatisë së vet emocionale, prandej edhe dhimba që lidhet me venitjen e saj asht akuzë e përsërishme kundër nënshtrimit që ia sjell kufizimi i lirisë femnore në zgjedhjen e fatit të vet. Katarza që përjeton Ndue Deda krve ca vjetsh lektisjesh mbas sai, bahet tani shkak i lektisjeve të saj mbas nji forme të re jetësore, ofarë ajo nuk kishte pasë rasën të shijonte kurrë. Kështu, këto dy pole të të njaitës dëshirë të ziarrtë. kur bashkohen me hirin e rastisjes, nuk konsistojnë ma në dëshirën e interferencës së tyne por, sikundër edhe deriatëherë, vazhdoinë rrugën e ikjes dhe pasimit. Veç me nji ndryshim: tani nuk asht Tulja ajo që ikën, që reziston, por ajo që shkon mbas, që lutet, që përgjëron. Koha dhe mosha ma në fund e bajnë të vetëdijshme se e tanë jeta e saj e deritashme ishte nji dështim i kryeneçsisë dhe krenarisë së pakuptimtë, e që tash mund të përkujtohet vetëm me

melankoli. Kjo do t'ishte determinanta psikologjike. Mbas gjithë atij qëndrimi të patundshëm, që do ta magjepste edhe fanatikun ma të rreptë të moralit, kjo qenie iu përkulet ma në fund ligjësive të gjithëfuqishme të jetës së njeriut dhe e kërkon me kushtrim shpirti at formë jete që nuk e përfill vjet me radhë. Kështu, kjo femën vitale dhe e atilltë, që dikur të mahnitte me vendosmëninë e karakterit dhe freskinë e jetës, bahet tani miniaturë e pamjes së vet të përparshme, jo pse zen pleqnija t'ia lajë gjurmat e veta, por pse në fatin e saj shquhen shenjat e nji dështimi të përjetshëm. Finalja e Tules asht aq ma e randë dhe ma e dhimbshme për arsye se kuptohet shkoqun që rruga e saj jetësore nuk asht e zgjedhun aq me iniciativën personale, sa e caktueme nga ana e t'jatit. Ajo nuk di të kërkojë mënyrat e orvatjevet për sendërtimin e pamvarësisë dhe lumtunisë së vet, jo pse nuk e cilëson zgjuetsija, por ngaqë nuk i jipet mundësija të bajë rropatje të tilla — "ajo asht e mvarun nga hiret e prindit dhe t'ambientit. Së këndejmi edhe përpëlitjet e saj në flakën brambulluese të zjarrit të mbrendshëm, e edhe lektisja e përgjërimet e heshtuna në fund e tregojnë mvarësinë e femnës nga epërsija e mashkullit në nji rreth njerëzish ku asaj nuk i përfilleshin kërkesat dhe dëshirat. Kjo do t'ishte determinanta sociale.

Emni i protagonistes së tregimit Bjezga asht poashtu emën malsije mjaft i shpeshtë. Ajo quhet Grishë, anipse lumtunija nuk e grish as këte. Grisha asht fizionomi femne karakteri të kundërt me ate të Tules. Ndërsa Tulja ndryn në thellësitë e shpirtit të gjitha baticat dhe zbaticat e gjakut të vet, Grisha derdh rrëmbyeshëm dhe shkundullueshëm tanë lavën e qenies së saj. Mirëpo, n'esencën e jetës dhe finalitetit të tyne qëndron e njajta ide — asnjana sosh nuk ia dalin t'i sendërtojnë qëllimet dhe aspiratat e veta jetësore. E edhe kjo i shëmbëllen të parës: me pamje, me pasuninë e natyrës, energjinë jetësore, porse asht ma eksplozive dhe ma e rrëmbyeshme, asht ma guximtare në dashuni, me nji fjalë asht individualitet ma i spikatun sa i përket iniciativës dhe shprehjes së botës intime. Po të dashunonte tipin e Ndue Dedës, at njeri të zatetun me epshe dhe lektisje, ndjenjat e saj do të përfilleshin, kurse lumtunija nuk do t'i shqiste duersh si motrës së saj përkah fati. Mirëpo,

ajo asht lidhë shpirtnisht për nji njeri tjetër, i cili për hir të zanit asht në gjendje të përtrollis edhe ndjenjat ma fisnike dhe ma të sinqerta. Ai asht si nji shtatore anemike para kësaj krijese të buhishme, të rrëmbyeshme si uji i sheut që vërshon pafrenueshëm mbas rrshimit të shiut veror. Në mesin e tyne shoqnor këto dy femna nuk zatesin korelativin përkatës të konstruktit të tyne shpirtnor, prandej edhe orvatjet për vendosjen e lidhjeve ndërmjet tyne nuk sjellin rezultat. Në këtë mes jeta i jep shprehje asaj ironisë së saj karakteristike: kërkojnë harmoninë natyrat që s'përkojnë fare mesveti.

Grisha u takon atyne femnavet që s'njohin të tjerat ligje përpos atyne të zemrës. Tingujt që i burojnë prej atyhit janë urdhën dhe imperativ i saj. Ndërkaq, ndjenjat nuk i sulen andej nga kanë rrugën ma të çelun. Ato janë kthye nga nji objekt i caktuem dhe nuk i çkoqen deri që ta pushtojnë ose të flaken nën presionin e përçmimit. Së këndejmi, fuqija dhe çiltërija e dashunisë së saj cysin respektin dhe admirimin e kuptimit të saj moral. Lexuesi e adhuron këtë krijesë impulsive kur sheh se si në çastin e afektit nuk përdor kurrfarë dredhishë veç i dorëzohet sinqeritetit të ndjenjës e shpirtit. Përkundër saj, Currin në të cilin ajo asht e dashunueme e shquen indiferenca. Prandej edhe duket miniatural në përqasje me te. Grisha nuk asht e rafinueme dhe s'posedon asgja nga djallëzitë dhe dredhitë e femnës. Ajo dashunon aq sinqerisht sa që duket naive, porse ky naivitet e imponon bukurinë e spontanitetit dhe natyrshmënisë. Ajo ballëçelë i afrohet Currit dhe pa ngurue fare ia hedh nji grusht borë gjoksit, i thot se dëshiron ta shohë, të jetë prore pranë tij, e mandej i tregon se e dashunon, ndërsa ky e përudh të shkojë tek shtëpija, tue fye kështu tanë at fisnikëri e potencial ndjenjash të kullueta e të buta. Pa kurrfarë djallëzije ajo ia pret: „Ti s'tek je Curri. I lik tek je. Ma i lik se gratë. Eh Curr. Ze'bra m'ka plasë sa her' t'ko pa e s'ko mujtë me t'folë. Sonte po ik p'ej meje!" Mbas kësaj skene që do të futte në dhe krenarinë e secilës femën ajo i afrohet edhe ma tepër „që ta shifte ma mirë, ashtu të pasigurtë dhe të shqetsuem. Që ta shifte, ashtu të ftoftë, të pashpirt dhe të paorë. Ta shifte dhe t'i neverisej, të mos e kujtonte ma. I qasej dhe dëneste". Në këtë mënyrë edhe ritmi

i senzualitetit të saj rrallohet, kurse përfytyrimet që i çfaqen tevona Currit janë disonancat e shpirtit të tij për shkak të padrejtësisë që i solli asaj. Porse, pendesa edhe n'ekzistoftë në këtë rasë, nuk mund ta arsyetojë gjakëftohtësinë e tij në momentin e pulsit të shtuem t'epsheve të saj. Vetë fakti që ai ndien se asht i goditun në sedrën e tij në çastin kur ndërdija ia formulon reagimin e saj të pezmatuem, tregon se Curri nuk brengoset aq për plagën që mund t'ia ketë sjellë Grishës sa për prestigjin e tij të mashkullit para syve të nji femne. Gjithësesi ai zbehet dhe rrudhet para saj dhe para vetes për dobësinë e tregueme, kurse ajo, edhepse me varrën e përuljes në zemër, ngritet lartë si krijesë e plotë njerëzore, si nji natyrë e bujshme dhe integrale.

Thuhet se njeriu asht i kompletuem vetëm kur dashunon; thuhet, gjithashtu, se njeriun e fisnikëron ma tepër se çdogja tjetër bash dashunija. Prandej edhe Grisha sublimon, në përpjekjet e saj për realizimin e dashunisë të gjitha virtytet për arrijtjen e nji harmonije të plotë. Edhe Grisha, edhe Tulja herë janë të vrullta, të rrëmbyeshme, e herë janë skofiare, mitare, sepse janë krijesa të kompletueme njerëzore.

SHËNIM PËR AUTORIN

Rexhep Qosaj lindi në katundin Vuthaj (Gusi) më 1936. Ka krye shkollën normale dhe fakultetin filozofik — letërsinë dhe gjuhën shqipe.

Ky asht libri i parë i tij.

MBRENDIA

Nji kuptim i të bukurës dhe dashunisë 5
Gjurmave të nji kritiku letrar 21
Poezija dhe frymzimi 43
Shkaqet dhe kuptimi i nji tragjedije 55
Poezija dhe përvoja 85
Portrete të vrullta dhe mitare 97
Shënim për autorin

REXHEP QOSJA: „EPIZODE LETRARE" * KOREKTOR: FEHMI SPAHIU
BOTON DHE SHTYP: SGB „RILINDJA" — PRISHTINË